
BULETIN INFORMATIV

Mars 2024

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Mars, 2024

Përmbajtje

U mbajt mbledhja e parë e komitetit shkencor për organizimin e Panairit III mbarëkombëtar të librit akademik e shkencor, që do të mbahet më 23-25 prill 2024	6
Takim protagonistësh të ngjarjeve të mëdha për Kosovën dhe shqiptarët	8
Promovohet në Tiranë, libri “Ora e Kosovës: pavarësia dhe shtetndërtimi” me autor ish presidentin Fatmir Sejdiu	11
Akademia e Shkencave e Shqipërisë organizoi workshop-in me temë: “Maksimizimi i veprimtarisë së komunitetit shkencor për t’iu përgjigjur sfidave të menaxhimit të integruar të ujërave në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut”	17
U mbajt workshop-i “Maksimizimi i veprimtarisë së komunitetit shkencor për t’iu përgjigjur sfidave të menaxhimit të integruar të ujërave në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut”	22
Prezantohen 5 projektet e Njësinë kërkimore “Pasuritë ujore” (pranë ASHSH) në sektorin e ujërave në Shqipëri	27
Science publikon zbulimin e një burimi të madh natyror të gazit të hidrogjenit që emetohet nga thellësia e minierës së kromit në Bulqizë.....	31
Vargu i kënduar i Eposit në librin “Një këngë kreshnikësh shqiptarë” e autorit Red Radoja	33
Redaksia e gjeologjisë e minierave dhe redaksia e inxhinierive dhe teknologjive në takim pune për përgatitjet e deritashme për fjalësin paraprak të “Enciklopedisë shqiptare”	38
Takim pune me specialistë të së drejtës së autorit dhe të pronësisë intelektuale.....	42
Instituti Alb-Shkenca dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë lidhin një marrëveshje bashkëpunimi	45
Takim pune në Institutin e Arkeologjisë Tiranë.....	51
Redaksia vendore e "Enciklopedisë shqiptare" bën vlerësimin e punës së saj dhe të redaksive të fushave	56
Lidhet marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) dhe Akademisë së Sigurisë (AS)	59
Akademia e të Rinjve drejt rithemelimit	65

Marrëdhëniet me shkencëtarët shqiptarë po forcohen.....	67
Qendra e Botimeve Enciklopedike e Albanologjike (QBEA) dhe Qendra për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor (QKPISH) - dy njësi të reja të përhershme pranë Akademisë së Shkencave.....	69
U mblodh Komisioni i fizikë – kimisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë	72
Redaksitë e historisë (të shek. XX dhe të historisë ushtarake), redaksia për religjionet dhe redaksia e arkeologjisë vlerësojnë përgatitjet e deritashme për "Enciklopedinë shqiptare"	75
“Naum Prifti, mjeshtër i prozës së shkurtër”	77
Ringrihet Akademia e të Rinjve të Shqipërisë	88
Për herë të dytë shkrimtari Ismail Kadare, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nominohet për çmimin "International Booker Prize 2024"	92
Redaksia e letërsisë dhe redaksia e gjuhësisë, me peshë në vëllim e në rëndësi për "Enciklopedinë shqiptare", takim e bashkëbisedim në përmbyllje të fazës së hartimit të fjalësit paraprak.....	94
Akad. Arben Merkoçi, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, pranohet anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave.....	97
Juria e çmimit të veçantë "Pilika" shpall kalendarin, kriteret dhe procedurat për zhvillimin e konkursit.	99
Takim informues i dy redaksive të fushës së letërsisë (përkatësisht të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës), në kuadër të projektit madhor të "Enciklopedisë shqiptare"	102
Mbledhje e Redaksisë Qendrore të "Enciklopedisë shqiptare" në resortin "Lakeside" (Vërmicë, Prizren)	105
Mbledhje Kryesie	112
Vendim i jurisë së çmimit të veçantë shkencor “Pilika” për kalendarin, kriteret e pjesëmarrjes dhe procedurat që ndiqen për zhvillimin e konkursit	113
Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi me kolegjin universitar "Reald" të Vlorës ...	115
Propozime të grupit të punës për disa ndryshime në rregulloren ekzistuese për periodikët shkencorë të Akademisë së Shkencave.....	119
Zhvillohet mbledhja e bordit të drejtorëve dhe kryetarëve të komisioneve të përhershme të instituteve të albanologjisë	122

Akademiku Nazim Gruda vlerësohet si hulumtues i shquar ("Investigador distinguido") nga Universiteti Politeknik i Kartagjenës, Spanjë	125
Organizimi i Panairit të 3-të Mbarëkombëtar të Librit Akademik dhe Shkencor është në rrugë të mbarë	127
Cilësia e ajrit si faktor themelor për jetëgjatësi, mirëqenie e shëndet publik	130
"Tirana ein kurzer Traum" / "Tirana, një ëndërr e shkurtër", roman i Stefan Çapalikut, paraqitet në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Leipzig	132
Akad. Aurela Anastasi - ligjëratë e hapur për reformën në drejtësi.....	134
(Në 25-vjetorin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë - 1998).....	134
Dita e Autorëve Europeanë - The Day of European Authors	136
U zhvillua mbledhja e redaksisë së trashëgimisë e identitetit në kuadër të hartimit të Enciklopedisë shqiptare	140
110-vjetori i Shqipërisë principatë (mars-shtator 1914).....	141
"Muzika si inteligjencë emocionale" e Eno Koços.....	148
Botime të reja	152
"Kulturë e shkrimit shqip me alfabet greqisht"	153
"Fjalë pa nota", libër i ri me artikuj e studime nga Vasil S. Tole, botim i Akademisë së Shkencave	155
"Wilhelm zu Wied dhe Shqipëria: mars-shtator 1914".....	158
"Shqipëria në dokumentet amerikane", vëll. I (viti 1945), përmbledhje dokumentesh përgatitur nga Marenglen Verli, Arbër Hadri e Ibrahim Gashi	162
"Studime ndërdisiplinare në albanologji", nga Roland Zisi.....	163
Promovohet në Prishtinë libri me dokumente "Shqipëria në dokumentet amerikane - viti 1945" (vëllimi I)	165
Nekrologji.....	168
Ndahet nga jeta dijetari austriak Heiner Eichner, indoeuropeist dhe albanolog	169
Ndahet nga jeta Jorgo Papingji.....	171
In memoriam.....	172
Kujtojmë Artan Boriçi, në trevjetorin e ndarjes nga jeta.....	173

U mbajt mbledhja e parë e komitetit shkencor për organizimin e Panairit III mbarëkombëtar të librit akademik e shkencor, që do të mbahet më 23-25 prill 2024

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

**PANAIRI MBARËKOMBËTAR
I BOTIMEVE AKADEMIKE E SHKENCORE
III**

Tiranë, 23 – 25 prill 2024

Në bashkëpunim me

**QENDRA KOMBËTARE
E LIBRIT DHE LEXIMIT**

Me pjesëmarrjen e institucioneve, universiteteve dhe subjekteve,
me veprimtari botuese shkencore

Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë në drejtimin e zëvendëskryetarit të këtij institucioni, akad. Vasil S. Tole, u mbajt mbledhja e parë e komitetit shkencor për organizimin e Panairit III mbarëkombëtar të librit akademik e shkencor, që do të mbahet më 23-25 prill 2024. Panairi mbahet nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë sëbashku me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Akad. Tole ndau detyrat për organizimin e panairit.

Kujtojmë se dy edicionet e mëhershme (i pari në Tiranë në vitin 2022 dhe i dyti në Prishtinë në vitin 2023), provuan se kjo nismë është në shërbim të promovimit të botimeve akademike dhe shkencore dhe lehtësimit të rrugës së vështirë të librit akademik dhe shkencor për të mbërritur te lexuesi.

Panairi synon që të bëjë të njohura arritjet më cilësore në botimet akademike, shkencore dhe universitare në të gjithë hapësirën shqiptare. Si i tillë, panairi synon një prani përfaqësuese sa më të gjerë, duke bërë bashkë autorët, botimet, institucionet e kërkimit dhe IAL-të që merren me librin akademik e shkencor dhe lexuesin e tyre.



Si promovues dhe manifestues, panairi ofron pjesëmarrje të hapur, duke mundësuar pranëvendosje në sasi dhe cilësi të botimeve shkencore dhe të autorëve të tyre nga gjithë hapësira shqiptare.

Shih linkun:

<https://www.facebook.com/share/wgEaG7V2RfG3mNWP/?mibextid=WC7FNe>

Takim protagonistësh të ngjarjeve të mëdha për Kosovën dhe shqiptarët



- Presidenti i mëparshëm i Republikës së Kosovës Fatmir Sejdiu takim me Kryetarin Gjinushi në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë

Në bashkëbisedimin e Presidentit Sejdiu me akad. Gjinushin, Kryetar i ASHSH, evokohen ngjarje dhe personalitete me rëndësi përcaktuese për historinë e Kosovës së pavarur, çlirimin e saj 25 vjet më parë, për veprimin e diplomacisë ndërkombëtare (takimet, bisedimet, projektet, zgjidhjet); për rrugën e përshkuar nga mbrojtja ndërkombëtare dhe bashkëqeverisja me institucionet kalimtare të caktuara nga OKB, SHBA e BE deri te pavarësia.



Dy bashkëbiseduesit, në këtë takim, të zhvilluar në ditën e përrurimit të librit “Ora e Kosovës” të z. Fatmir Sejdiu, organizuar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, theksuan rëndësinë e dëshmisë së protagonistëve për historiografinë e re të Kosovës, sidomos të memuarëve të atyre që kanë qenë të pranishëm atje ku pakkush mund të ishte. Rruga e vështirë e Kosovës drejt pavarësisë nuk mund të ndriçohet pa pjesën e pathënshme në kohën reale të zhvillimit të ngjarjeve, ndërsa sot, librat që mbështeten në përvojat jetësore të protagonistëve, të shkruar me ndershmëri e përgjegjësi para lexuesit dhe para së ardhmes, janë një burim shumë i rëndësishëm, nxitës për studiuesit, për të gjetur shtigjet si të shkojnë në burime dhe të verifikojnë të vërtetat me dokumente.

Kryetari Gjinushi dhe Presidenti Sejdiu rikujtuan takimet e tyre në periudhën e kapërcyellit, në “1913-ën e dytë”, kësaj here jo si padrejtësi por si vënie e së drejtës në vend. U këmbyen gjykime e vlerësime për ngjarje kyçe të mëvonshme, si hartimi i kornizës kushtetuese, shpallja e pavarësisë, ndërtimi i institucioneve, stabilizimi i raporteve juridike me organizmat e kontrollit ndërkombëtar, njohja diplomatike e Kosovës, zgjidhjet e krizave të brendshme, marrëdhëniet me fqinjët etj.

Në takim u fol edhe për çështje të sotme të Kosovës politike, për bashkëpunimin në përgjithësi dhe atë midis institucioneve akademike e universitare veçmas.

Të pranishëm në takim prof. Lulzim Tafa, rektor i kolegjit universitar AAB (Prishtinë); Ibrahim Berisha, redaktor i librit “Ora e Kosovës” (shtëpia botuese e librit

universitar AAB); Naim Jerliu, ish-këshilltar i z. Sejdiu; akad. Anastas Angjeli, President i Universitetit Mesdhetar të Tiranës.



Promovohet në Tiranë, libri “Ora e Kosovës: pavarësia dhe shtetndërtimi” me autor ish presidentin Fatmir Sejdiu



- Akad. Anastas Angjeli: Libri hedh dritë në historinë e lavdishme të popullit të Kosovës, në fitoren e pavarësisë dhe ndërtimin e institucioneve të shtetit të Kosovës.

- Prof. Paskal Milo: Një rol të rëndësishëm ka luajtur presidenti Sejdiu në njohjen ndërkombëtare të shtetit të pavarur të Kosovës. Në kohën e Presidencës së tij (2006 - 2010), Kosova u njoh nga 71 vende, gati dy të tretat e njohjes ndërkombëtare që ka sot pas 16 vite pavarësi.

- Akad. Adrian Civici: Ky libër është në vetvete një tregim dhe analizë e rëndësishme në optikën e shkencave politike e marrëdhënieve ndërkombëtare.

U promovua sot në Hotel Internacional, në Tiranë, libri “Ora e Kosovës: pavarësia dhe shtetndërtimi”, me autor ish presidentin Fatmir Sejdiu, botim i Universitetit AAB Prishtinë.

Promovimi u organizua nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë në bashkëpunim me shtëpinë botuese të universitetit AAB –Prishtinë, me pjesëmarrjen e akademikëve dhe personaliteteve të vendit, ish presidentët z. Afred Mosiu, z. Bamir Topi, Kryetare e Kuvendit znj. Lindita Nikolla, z. Gramoz Ruçi, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi dhe Kryesia e saj, akad. Vasil Tole, akad. Shaban Sinani, etj. Ishte i pranishëm edhe ambasadori i Republikës së Kosovës, z. Skënder Dyrmishi.



Akad. Anastas Angjeli çeli promovimin, duke e vlerësuar librin “Ora e Kosovës” si një vepër me vlera të jashtëzakonshme, që hedh dritë në historinë e lavdishme të popullit të Kosovës, në fitoren e pavarësisë dhe ndërtimin e institucioneve të shtetit të Kosovës.

Akad. Angjeli ia dha fjalën prof. Paskal Milos.

Prof. Milo kujtoi se 18 vite më parë kishte deklaruar ne media se presidenti Sejdiu përfaqëson denjësisht mendimin e pjekur, të ekuilibruar politik në Kosovë, që vjen nga Lidhja Demokratike...Vetë figura e Sejdiut është e pëlqyeshme, që rrezaton kujdes, ekuilibër dhe urtësi. Kjo ka shumë rëndësi në Kosovën post Rugovës.



Prof. Milo përmendi më tej kontributet e presidentit Sejdiu si anëtar i Komisionit për Hartimin e Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të Kosovës, që u krijua në vitin 2001, ku mori pjesë aktive në hartimin dhe redaktimin përfundimtar të Deklaratës së Pavarësisë dhe nën përgjegjësinë e tij si President i Republikës, kur u ngrit e përfundoi punën edhe Komisioni për hartimin dhe miratimin e Kushtetutës.

Presidenti Sejdiu ka një meritë shumë të madhe si drejtues i delegacionit shqiptar në bisedimet për statusin final të Kosovës të organizuar në Vjenë në vitet 2006-2007 me ndërmjetësinë e emisarit të posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, presidentit Martti Ahtisaari, si dhe në fazën 120- ditore po në vjeshtën e 2007-s me treshen përfaqësuese të Grupit të Kontaktit. Një rol të rëndësishëm ka luajtur presidenti Sejdiu në njohjen ndërkombëtare të shtetit të pavarur të Kosovës. Në kohën e Presidencës së tij (2006 - 2010), Kosova u njoh nga 71 vende, gati dy të tretat e njohjes ndërkombëtare që ka sot pas 16 vite pavarësi. -tha prof.Milo.

Ish presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Alfred Moisiu, e vlerësoi librin e ish presidentit Sejdiu si një vepër që i shërben të ardhmes. Pasi i bëri një përshkrim të shkurtës përmbajtjes së librit “Ora e Kosovës”, ish presidenti Moisiu tha se në këtë libër ka një përshkrim të saktë të rrugës së lavdishme të krijimit të shtetit të Kosovës, në atë periudhë tepër të vështirë për të ardhmen e saj.



Prof. Ksenofon Krisafi e çmoi ish presidentin Sejdiu për kontributin e tij në shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe theksoi se “Ora e Kosovës është një version original i historisë së Kosovës, kur nisi ringjallja dhe pavarësimi i shqiptarëve. Gjithashtu, prof. Kristafi e përgëzoi autorin edhe për stilin tërheqës të të shkruarit që përfshin gjithë gamën e gjerë të qasjeve, jo vetëm për studiuesit e historisë, por edhe për

lexuesit e thjeshtë.

Ish presidenti Bamir Topi përshëndeti pjesëmarrësit në promovim, duke i vlerësuar si një auditor cilësor dhe e vlerësoi librin për shtrirjen e gjerë të përmbajtjes me karakter të shumanshëm, politik, historik dhe për përshkrimin emocional të ngjarjeve. Në kuadër të emocioneve që ka ngjallur ky libër, ish presidenti Topi kujtoi takimet zyrtare dhe qëndrimin në Kosovë në pragun e shpalljes së pavarësisë.

Rektori i Universitetit Mesdhetar, akad. Adrian Civici, foli për vlerat e librit, duke e vlerësuar, së pari, si një dhuratë specifike që na njeh nga brenda me ngjarje e procese që shpesh mund të dalin nga vëmendja e historianëve.

“ Tradita e bukur e personaliteteve të rangut më të lartë për të shkruar kujtimet e tyre, por që nuk janë thjesht kujtime apo përshkrim historik të ngjarjeve – janë një reflektim në formë analize e punës dhe aktivitetit të tyre, e sukseseve, por dhe hezitimeve e pse jo edhe gabimeve” - tha akad. Civici.

Akad. Civici duke iu referuar kujtimeve të librit tha se president Sejdiu kishte një detyrë e rëndë për kohë të rënda. Ai vlerësoi faktet, ngjarjet, vendimet e efektet e rëndësishme që ekspozohen për herë të parë në mënyrë të drejtpërdrejtë e transparente....



“Mjaft interesante janë gjithë përpjekjet e jashtëzakonshme të presidentit Sejdiu për t’u përballur dhe çmontuar tezat dashakeqe e negative të armiqve të Kosovës ... por dhe dyshimet e hezitimet e miqve e partnerëve të saj : a do bëhet Kosova një shtet i qëndrueshëm që do t’i rezistojë kohës apo do jetë një vend problematik, një hall i vazhdueshëm për Ballkanin dhe Europën.... A ekziston rreziku që Kosova të bëhet vatër

dhe përhapëse e myslimanizmit radikal e konservator? ... A do shkaktojë probleme e konflikte rajonale në një rajon të trazuar si Ballkani perëndimor ... A është e aftë të vetëqeveriset apo do kërkojë gjithnjë një lloj protektorati nga jashtë?"-tha akad. Civici.

Akad. Civici theksoi se ky libër është në vetvete një tregim dhe analizë e rëndësishme në optikën e shkencave politike e marrëdhënieve ndërkombëtare. Aty gjejmë udhëtim të autorit në brendësi të doktrinae, teorive e debateve të lidhura me marrëdhëniet ndërkombëtare ... në teza e zhvillime moderne të debateve në shkencat politike e doktrinën qeverisëse.

Ndërkohë, Ibrahim Berisha, redaktor i veprës e vlerësoi për kontributin e madh në pasurimin e literaturës së Kosovës.

Akad. Anastas Angjeli tha se presidenti Sejdiu i jep lexuesit kosovar dhe shqiptar dhe më gjerë një libër thjesht me vlera shkencore tejet të arrira, hulumtuese, bazuar në ngjarje, informacione e shfrytëzimin e një literature të gjerë dhe dokumente autentike, analiza dhe kronika të kohës, por edhe për disa arsye dhe veçori që rrallë herë i kanë autorë.



Akad. Angjeli vuri në dukje konkretisht se Fatmir Sejdiu dëshmon në këtë botim se është një njohës i mirë i shtetit dhe institucioneve të tij, dhe si i tillë ai ka ditur që njohuritë e tij për shtetin dhe institucionet e krijuara historikisht (thua se në këta 200 vjet që shtetet janë krijuar) t'i përshtatë dhe t'i zbatojë në kushtet e modernitetit të sotëm, të evoluimit të institucioneve të shtetit për ndërtimin e tyre, të vetë shtetit të Kosovës, si shteti më i ri, si një aktor, personalitet, me rol real në këtë proces kaq të rëndësishëm dhe jetik për Kosovën.

Ai nuk është një autor që vjen me një botim të parë “nga jashtë”, me histori e kronika të lexuara, apo të dëgjuara, të cilat sipas vlerësimeve që u ka bërë dhe interesit të treguar ai i ka shfrytëzuar por ai është pjesë reale e kësaj historie, e ka jetuar atë, pjesë kryesore e vendimmarrjes, e ndërtimit, e rritjes dhe e zhvillimit të shtetit të Kosovës dhe institucioneve të tij.

Dëshmitë dhe vrojtimit paraqiten në mënyrë objektive, gjithmonë autentike ashtu siç i ka parë, ndjerë dhe përjetuar.

Libri është edhe një udhërrëfyes në rrugën e ndërtimit të shtetit të Kosovës, të institucioneve të tij, funksionimit dhe zhvillimit të tyre. Ai është një gur i çmuar në historinë e Kosovës, një dhuratë e vlefshme për gjeneratat e ardhshme të popullit të Kosovës, të Shqipërisë. –tha akad. Angjeli.

Në fund të veprimtarisë, ish presidenti i Kosovës Fatmir Sejdiu shprehu falënderime të përzemërta për organizmin e këtij promovim. Ai e mbylli përshëndetjen me këto fjalë: “Nëse e kemi orën e Kosovës një metaforë, atëherë ne duam ta kemi orën e shqiptareve që ta çojë shekullin edhe më tej.”.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë organizoi workshop-in me temë: “Maksimizimi i veprimtarisë së komunitetit shkencor për t'iu përgjigjur sfidave të menaxhimit të integruar të ujërave në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut”

- Akad. Skënder Gjinushi: Një nga fushat ku jemi më të prapambetur, në raport me Europën, ose ka më shumë probleme, janë problemet e mjedisit dhe problemet e trajtimit të ujërave. Vetë roli i njësive tona dhe qëllimi që ngrihen këto njësi është, së pari, ky komunikim e informim, për të pasur një panoramë të plotë mbi kërkimin shkencor në vendin tonë dhe për të luajtur një rol koordinues midis gjithë kapaciteteve që disponohen tek ne në këtë aspekt

- Dy drejtuesit e njësisë “Pasuritë ujore”, pranë ASHSH, dhe të kësaj veprimtarie, akad. Besnik Baraj dhe prof. Roza Allabashi paraqitën një analizë të plotë të situatës aktuale, për identifikimin e problemeve e mangësive në sektorin e ujërave në Shqipëri, me qëllim përfshirjen dhe forcimin e rolit të kërkimit shkencor në përpalljen e sfidave të këtij sektori



Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike, njësia “Pasuritë ujore” organizuan më 29 shkurt 2024 workshop-in me temë: “Maksimizimi i veprimtarisë së komunitetit shkencor për t'iu përgjigjur sfidave të menaxhimit të integruar të ujërave në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut”

Veprimtaria u mbajt në sallën “Aleks Buda” me pjesëmarrjen e rreth 40 kërkuesve, anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të njësisë kërkimore “Pasuritë ujore” pranë ASHSH, nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, përfaqësuesve të universiteteve publike

dhe jopublike dhe instituteve me status kërkimor, që zhvillojnë aktivitetin kërkimor në fushën e ujërave.

Kryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi, përshëndeti pjesëmarrësit.

Në fjalën përshëndetëse akad. Skënder Gjinushi theksoi se qëllimi i këtij wokshop-i është forcimi i bashkëpunimit midis grupeve dhe mundësimi i kërkimit shkencor, për t'iu përgjigjur sfidave reale të këtij sektori.



Ky takim është i veçantë, -theksoi ai, -sepse nuk është një konferencë shkencore standard, por është në thelb një takim pune, ku merret një informacion i plotë mbi aktivitetin e njësive të ndryshme për gjithkund që në Shqipëri trajton dhe merret me problemin e ujërave qoftë pranë universiteteve kryesore publike UT, UPT, UBT, universitetet e Prishtinës, e të tjerë, pra në mbarë trevat shqiptare.

Vetë roli i njësive tona dhe qëllimi që ngrihen këto njësi është, më së pari, ky koordinim, për të pasur një panoramë të plotë mbi kërkimin shkencor në vendin tonë dhe për të luajtur një rol koordinues midis gjithë kapaciteteve që disponohen në këtë aspekt. -tha akad. Gjinushi.

Është vështirë të bësh këtë lidhje dhe ta vendosësh gjithë këtë makineri që të funksionojë si një e tërë, por akoma më e vështirë është martesa me ekzekutivin, sepse vazhdimisht dialogu shkencë - politikë, është i komplikuar në aspektin që kush do ta marrë iniciativën i pari dhe veçanërisht se sa politika do të bëhet efektive për t'iu realizuar apo për t'iu hapur rrugë, projekteve e rekomandimeve të ndryshme, aq më shumë, për

sa iu takon problemeve të mjedisit dhe ujërave, ato të cilat janë edhe më komplekse, sepse janë edhe më të kushtueshme. Është kjo një nga arsyet pse nuk gjendet gjithmonë dera e hapur, por qëllimi ynë është që të bëjmë presion të vazhdueshëm, me propozime konkrete, sepse jemi para sfidave të reja, jo vetëm si komunitet shkencor, por edhe për faktin që Shqipëria tashmë është në prag të anëtarësimit në Bashkimin Europian dhe duhet të arrijë të gjitha standardet në të gjitha drejtimet.



Dhe me siguri që një nga fushat ku jemi më të prapambetur, në krahasim me Europën, ose ka më shumë probleme, janë problemet e mjedisit dhe problemet e trajtimit të ujërave, ndërkohë që për nga burimet jemi më të favorizuar.

Ky është dhe roli i njësisë “Pasuritë ujore”. që të jetë një oponente, të jetë një rekomanduese dhe koordinuese për përballimin e këtyre problemeve, duke nisur që nga ana formale e rregullimit të kuadrit ligjor, e formimit të specialistëve përkatës dhe më tej për realizuar projekte konkrete e për të përballuar probleme të ndryshme që lidhen me ujërat.

Akad. Gjinushi falënderoi veçanërisht drejtuesit e njësisë kërkimore “Pasuritë ujore” dhe të kësaj veprimtarie, akad. Besnik Baraj dhe prof. Roza Allabashin, që punon në Universitetin e Vjenës (BOKU).

Gjithashtu, akad. Gjinushi falënderoi dhe përgëzoi pjesëmarrësit në këtë veprimtari, që kanë pranuar të jenë pjesë e kësaj iniciative për të raportuar ose informuar më saktë për punën e tyre si përfaqësues e drejtues të njësive përkatëse, për të bashkëvepruar më mirë në të ardhmen.

Prof. Roza Allabashi prezantoi projektet shkencore e institucionale në sektorin e ujërave në Shqipëri dhe mundësitë konkrete të bashkëpunimit në këtë kuadër.

Akad. Besnik Baraj përshëndeti pjesëmarrësit dhe së bashku me prof. Roza Allabashin paraqitën drejtimin e punës në Njësinë kërkimore “Pasuritë ujore”, pranë Akademisë së Shkencave, vizionin e kësaj njësie, objektivat kryesore, synimet e rrugën për arritjen e tyre, rezultatet e raportit për rolin e kërkimit shkencor në përballimin e sfidave të sektorit të ujërave në Shqipëri, në të cilin përshkruhet strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, projektet ndërkombëtare në mbështetje të zhvillimit institucional në sektorin e ujërave në Shqipëri, strukturat organizative e institucionale për menaxhimin e burimeve ujore, e të tjerë.



Akad. Baraj falënderoi Kryetarin e ASHSH akad.Gjinushin për mbështetjen e jashtëzakonshme të iniciativës për të organizuar këtë workshop dhe kujtoi se kjo veprimtari përbën edhe sfidën e organizmit të njësisë “Pasuritë ujore”. Ai shprehu mirënjohjen për mbështetjen e menjëhershme të Kryetarit dhe Kryesisë së Akademisë së Shkencave.

Në seancën e dytë të workshop-it u bënë prezantime të grupeve kërkimore nga universitetet dhe institucionet e tjera shkencore nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, në lidhje me fokusin e punës së tyre shkencore, kapacitetet dhe interesat për të ardhmen nga kërkuesit shkencorë prof. Ariola Bacu, UT; prof. Aleko Miho, UT; prof. Alket Kumaraku, UPT; prof. Raimonda Totoni, UPT; prof. Ilir Malollari, UT; prof. Kledi

Xhaxhiu, UT; prof. Klodia Skrame, UPT; prof. Irena Duka, UBT; prof. Ariola Devolli, UBT; prof. Halil Ibrahim, Universiteti i Prishtinës; prof. Majlinda Vasjari, UT; prof. Romina Koto, UBT; prof. Anisa Myrtaj, Universiteti i Vlorës; prof. Erinda Lika, UBT; prof. Lavdim Osmanaj, Universiteti i Prishtinës; prof. Ylber Myrtaj, Maqedoni e Veriut; prof. Aurel Nuro, UT; prof. Magdalena Cara, UBT; prof. Uran Abazi, UBT.



Si konkluzion, në fund të veprimtarisë, u theksua se universitetet publike në Shqipëri mund të luajnë një rol të rëndësishëm për të mundësuar një transferim të integruar dhe të plotë të njohurive për studentët apo specialistët e ujit. Ata kanë potencialin në burimet njerëzore dhe laboratorike për të ofruar këtë njohuri dhe ekspertizë. Këshillohet me forcë një program i përbashkët master mbi "Menaxhimin e integruar të ujit", në përfshirjen e partnerëve kryesorë në arsimin e lartë mbi menaxhimin e ujit, universitetet publike PUT, AUT dhe UT.

U mbajt workshop-i “Maksimizimi i veprimtarisë së komunitetit shkencor për t’iu përgjigjur sfidave të menaxhimit të integruar të ujërave në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut”

- Akad. Besnik Baraj dhe prof. Roza Allabashi paraqitën objektivat e njësisë “Pasuritë ujore” pranë Akademisë së Shkencave dhe prezantuan rezultatet e raportit për rolin e kërkimit shkencor në përballimin e sfidave të sektorit të ujërave në Shqipëri

Në workshop-in me temë: “Maksimizimi i veprimtarisë së komunitetit shkencor për t’iu përgjigjur sfidave të menaxhimit të integruar të ujërave” që u mbajt në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë nga Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike dhe njësia “Pasuritë ujore”, më 29 shkurt 2024, akad. Besnik Baraj dhe prof. Roza Allabashi përcaktuan objektivat e kësaj njësie, synimet e rrugën për arritjen e tyre, rezultatet e raportit për rolin e kërkimit shkencor në përballimin e sfidave të sektorit të ujërave në Shqipëri, në të cilin përshkruhet strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, projektet ndërkombëtare në mbështetje të zhvillimit institucional në sektorin e ujërave në Shqipëri, strukturat organizative e institucionale për menaxhimin e burimeve ujore, e të tjerë.



Objektivat e njësisë “Pasuritë ujore” janë:

Koordinimi dhe bashkërendimi i punës ndërmjet grupeve kërkimore shkencore

ekzistuese të studiuesve të disiplinave të ndryshme, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve brenda secilës disiplinë dhe forcimi i punës ndërdisiplinore, me synim zgjidhjen e problemeve në sektorin e ujërave.

Fuqizimi i kapaciteteve studimore-shkencore për të përthithur mbështetje financiare për punë studimore në fushën e ujërave, duke nxitur dhe intensifikuar komunikimin e bashkëpunimin me institucionet financiare kombëtare e ndërkombëtare.

Krijimi i një platforme dialogu e bashkëpunimi ndërmjet institucioneve kërkimore shkencore dhe atyre politike e vendimmarrëse për menaxhimin e integruar e të qëndrueshëm të ujërave.

Prof. Roza Allabashi, më pas paraqiti rezultatet e raportit për rolin e kërkimit shkencor në përballimin e sfidave të sektorit të ujërave në Shqipëri, në të cilin përshkruhet strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të burimeve ujore (MIBU); 2017, projektet ndërkombëtare në mbështetje të zhvillimit institucional në sektorin e ujërave në Shqipëri, strukturat organizative e institucionale për menaxhimin e burimeve ujore dhe integrimi i katër “shtyllave” strategjike (Strategjia kombëtare e MIBU), situata aktuale në menaxhimin e integruar të burimeve ujore, etj.



Një vend të veçantë në këtë studim zuri edhe raporti për përmirësimin e infrastrukturës së laboratorëve të inxhinierisë kimike me sisteme kompjuterike për simulim dhe optimizimin e proceseve, si dhe për impiante pilot eksperimentale për

kërkimin shkencor.

Në fund të prezantimit, prof. Roza Allabashi theksoi se për realizimin e këtyre kriterëve nevojitet; bashkëpunim midis grupeve kërkimore; punë kërkimore ndërdisiplinore dhe bashkëpunim me institucionet.

Më pas akad. Baraj gjatë prezantimit të raportit “Roli i kërkimit shkencor në përballjen e sfidave të sektorit të ujërave në Shqipëri”, përgatitur nga Njësia kërkimore “Pasuritë ujore” (2023) tha se uji është një burim natyror strategjik, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe në nivel global.



Megjithëse një vend i pasur me burime ujore, -tha akad. Baraj, -Shqipëria po përballet e do të vijojë të përballet me ndryshimet klimatike, lëvizjet demografike dhe konkurrencën për burimet ujore, që do kenë ndikim të konsiderueshëm në zhvillimin e saj ekonomik dhe social. Është vënë re se aty ku natyra është treguar dorëlëshuar, njeriu i ka shpërdoruar vlerat natyrore: prerja e pyjeve, ndërtimet pa kriter, shkatërrimi i florës, betonizimi i sipërfaqeve të gjëra, shfrytëzimi inerteve, lëvizjet demografike e shpërdorimi i burimeve ujore.

Ai vuri në dukje se përballja e Shqipërisë me ndryshimet klimatike, ka ngritur pikëpyetje për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social. Pasojat: Mungesa të pazakonta të ujit, thatësira të tejjgjatura, shkretëtirëzimi i tokave, erozioni kritik dhe mungesa e ujit në hidrocentrale lokale, etj.



Akad. Baraj theksoi se identifikimi dhe prioritizimi i nevojave dhe sfidave të sektorit të ujërave, si edhe gjetja e rrugëve për përmbushjen e tyre, merr një rëndësi të veçantë. Një problem tjetër kritik është mungesa e standardeve kombëtare, për t'iu përgjigjur kërkesave të direktivës kuadër të ujit.

Akad. Besnik Baraj vuri në dukje se Shqipëria ka bërë një punë të lavdërueshme për adoptimin e legjislacionit europian në fushën e ujërave, por ka akoma shumë për të bërë për implementimin e tij, si dhe për hartimin e standardeve kombëtare me format ligjor:

Furnizimi me ujë dhe trajtimi i ujërave të ndotur: Një nga nevojat kryesore të sektorit të ujërave në Shqipëri është përmirësimi i aksesit në shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve, si dhe trajtimi i ujërave të ndotura.

Menaxhimi i cilësisë së ujit: Ndotja e ujërave është një nga problemet më shqetësuese në Shqipëri, që prek si burimet sipërfaqësore, ashtu edhe ato nëntokësore. Nevoja për të adresuar çështjet e cilësisë së ujit është parësore për të mbrojtur shëndetin publik dhe mjedisin.

Shfrytëzimi efektiv i ujit nga bujqësia: Bujqësia është një nga sektorët jetikë të ekonomisë shqiptare, e lidhur drejtpërdrejt me sigurimin e ushqimit. Menaxhimi efektiv i ujit në bujqësi kërkon përmirësimin e infrastrukturës së ujitjes dhe zbatimin e praktikave të kursimit të ujit.

Ruajtja e ekosistemeve ujore: Mbrojtja e ekosistemeve ujore është thelbësore për ruajtjen e burimeve ujore dhe sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë mjedisore.

Menaxhimi i burimeve ujore: Njësia kërkimore “Pasuritë ujore”, e krijuar pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në maj 2023, i ka vënë vetes qëllim të forcojë kontributin e kërkimit shkencor në përpalljen me këto sfida. Kjo analizë do të shërbejë së pari për të konkretizuar fokusin e punës dhe të aktiviteteve të njësisë për vitet në vazhdim, Akademia e Shkencave, nëpërmjet Njësies kërkimore “Pasuritë ujore” mund të luajë një rol të rëndësishëm në këtë kontekst. Duke vendosur fokusin tek shkencëtarët e rinj, duhet synuar në aplikimin e qasjeve inovative të mësimdhënies apo trajnimit në të gjitha nivelet, për ta bërë sektorin e ujit atraktiv për profesionistët e rinj.-tha akad. Besnik Baraj.

Qëllimi i wokshopit, -tha akad. Baraj, - është të kryejë një analizë sa më të plotë të situatës aktuale, për identifikimin e problemeve e mangësive në sektorin e ujërave në Shqipëri, me qëllim përfshirjen dhe forcimin e rolit të kërkimit shkencor në përpalljen e sfidave të këtij sektori. Për këtë qëllim janë shfrytëzuar, së pari, dokumentet kryesore strategjike të qeverisë shqiptare dhe materialet e përgatitura në kuadrin e projekteve të viteve të fundit. Veçantia e këtij wokshopi qëndron në përthithjen e mendimit të specialistëve të strukturave politike e administrative, që kanë detyrën dhe përgjegjësinë e menaxhimit të sektorëve të ndryshëm në fushën e ujërave, nëpërmjet takimeve personale.



Prezantohen 5 projektet e Njesisë kërkimore “Pasuritë ujore” (pranë ASHSH) në sektorin e ujërave në Shqipëri

- Workshop-i “Maksimizimi i veprimtarisë së komunitetit shkencor për t’iu përgjigjur sfidave të menaxhimit të integruar të ujërave në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut”

Në workshop-in me temë: “Maksimizimi i veprimtarisë së komunitetit shkencor për t’iu përgjigjur sfidave të menaxhimit të integruar të ujërave në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut”, që u mbajt më 29 shkurt 2024 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, me pjesëmarrjen e rreth 40 kërkuesve, anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të njësisë kërkimore “Pasuritë ujore” pranë ASHSH, nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, përfaqësuesve të universiteteve publike dhe jopublike dhe instituteve me status kërkimor, që zhvillojnë aktivitetin kërkimor në fushën e ujërave, u prezantuan ndër të tjera edhe 5 projektet e Njesisë kërkimore “Pasuritë ujore” pranë ASHSH, në sektorin e ujërave në Shqipëri.



Projektet që u prezantuan në seancën e parë të workshop-it nga organizatorët akad. Besnik Baraj dhe prof. Roza Allabashi (Njësia “Pasuritë ujore” pranë ASHSH) janë:
1-“Water Resources and Irrigation Project (WRIP)”

Ky projekt është përgatitur në kuadër të bashkëpunimit me qeverinë suedeze me mbështetjen e Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim [Swedish

International Development Agency (SIDA)] dhe bashkëfinancuar nga qeveria suedeze dhe Banka Botërore. Shtrirja kohore e projektit: prill 2018- nëntor 2020.



Qëllimi kryesor i këtij projekti ishte i fokusuar në ngritjen e një strategjie të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, planin e menaxhimit të dy baseneve lumore dhe përgatitjen e një kadastrë të Burimeve Ujore Kombëtare.

Rezultatet që priten të arrihen nga ky projekt janë ngritja e kadastrës së Burimeve Ujore Kombëtare, ku parashtrohet detyra e koordinimit të rreth 20 institucioneve që kanë objektiv burimet ujore; përgatitja e planeve të menaxhimit të baseneve të lumenjve Drin-Buna dhe Seman dhe hartimi i strategjisë kombëtare të burimeve ujore.

2-“Establishment of institutional and regulatory platform for governance and functioning of the national Water Resources Cadastre in Albania”

Ky projekt është përgatitur në kuadër të bashkëpunimit me qeverinë suedeze me mbështetjen e Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim [Swedish International Development Agency (SIDA)], në periudhën 2018-2019 dhe financuar nga qeveria suedeze dhe Banka Botërore, WB/SIDA në bashkëpunim me Agjencinë për Menaxhimin e Burimeve Ujore. Shtrirja kohore e projektit: maj 2018- maj 2019.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është të sigurojë mbështetje dhe shërbime konsultimi në sektorin e burimeve ujore në Shqipëri.

Rezultatet janë përcaktimi i një platforme rregulluese për të siguruar funksionimin e tri shtyllave kryesore të operimit të kadastrës së burimeve kombëtare ujore; gjenerimi i të dhënave; përpunim, analizim dhe vlerësim i të dhënave; aksesimi dhe publikimi i të

dhënave.

3-“Programme for Improving the National Early warning system and Flood Prevention in Albania - PRONEWS”.



Ky projekt është përgatitur në bashkëpunim me CIMA-Italian Institute for flooding Monitoring dhe financuar nga Bashkimi Europian. Shtrirja kohore e projektit: janar 2017- shtator 2021.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është t’u sigurojë mbështetje institucioneve shqiptare në menaxhimin e mbrojtjes ndaj përmbytjeve.

Rezultatet nga ky projekt janë hartimi i hartave të vlerësimit të rrezikut nga përmbytjet (në fazën e parë do të mbulohen gjashtë basenet lumore të Shqipërisë), ndërsa përgatitja e hartave të rrezikut nga përmbytjet do të realizohet për basene të caktuara lumore.

4-“SANE 27, Supporting Albanian Negotiations in Environment”

Ky projekt është implementuar nga SEPA (Swedish Environmental Protection Agency). Shtrirja kohore e projektit: janar 2018 e në vazhdim.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është të sigurojë mbështetje për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në procesin e negocimit të kapitullit 27 me BE, referuar legjislacionit aktual në lidhje me çështjet mjedisore dhe përafrimit të tij me legjislacionin e Bashkimit Europian.

Priten të zhvillohen përqasjet e Shqipërisë në përgatitjen e negociatave me BE, në lidhje me kapitullin 27-Mjedisori.

5-“Supporting the Albanian Water Sector on the Way to the European Union”

Ky projekt është përgatitur nga BOKU-University of Natural Resources and Life Sciences-Vienna, dhe financuar nga Agjensia Austriake për Edukimin dhe Internacionalizimin (OEAD) dhe Agjensia Shqiptare për Kërkimin, Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin (AKSHI). Shtrirja kohore e projektit: 2019-2022.

Qëllimi: Forcimi i bashkëpunimit me Universitetin Bujqësor të Tiranës për të trajtuar problematikën e formimit të specialistëve në sektorin e ujërave në Shqipëri: edukimin universitar e pasuniversitar dhe arsimimin e vazhdueshëm të personelit operativ.


Science publikon zbulimin e një burimi të madh natyror të gazit të hidrogjenit që emetohet nga thellësia e minierës së kromit në Bulqizë

Një rezervuar i thellë hidrogjeni ka nxitur daljen intensive të gazit në zonën në minierën e kromit në Bulqizë.

Truche et al. ka gjetur një burim të madh natyror të gazit hidrogjen që emetohet nga thellësia e minierës së kromit.

Fluksi i madh hidrogjenit ka të ngjarë të jetë krijuar nga akumulimi afatgjatë brenda një rezervuari të çarë. Vendet me gjeologji të ngjashme duhet të jenë objektiva të mira për gjetjen e burimeve të tjera natyrore të hidrogjenit.

Në Science shkruhet se prodhimi i kores së thellë të hidrogjenit (H₂) është një burim potencial i energjisë primare nëse akumulimet e rikuperueshme në formacionet gjeologjike janë mjaft të mëdha.



Bëhet fjalë për një nivel të lartë të shkarkimit në një vëllim prej 84% të H₂ nga miniera e thellë e kromit në Bulqizë në, Shqipëri.

Një minimum prej 200 ton H₂ nxirret çdo vit nga galeritë e minierës, duke e bërë atë një nga normat më të larta të fluksit të H₂ të regjistruar deri më sot.

Bëhet fjalë për një rezervuar të plasaritur herët në masivin ofiolitik Jurasik. Ky zbulim sugjeron se disa ofiolite mund të kenë akumulime ekonomikisht të dobishme të gazit H₂, që mund të përdoret për të prodhuar energji pa gjeneruar dioksid karboni si nënprodukt.

Megjithatë, burimet natyrore të hidrogjenit janë të rralla dhe prodhimi i tij kërkon energji intensive, shkruhet ndër të tjera në Science.

<https://www.science.org/doi/10.1126/science.adk9099>

Vargu i kënduar i Eposit në librin “Një këngë kreshnikësh shqiptarë” e autorit Red Radoja

- U mbajt sot kumtesa, ku u prezantua një pjesë e punës etnomuzikologjike të Red Radosë dhe tezat e tij për bërthamën muzikore dhe poetike të Eposit shqiptar

- Akad. Vasil Tole: Fusha e kompozimeve është një fushë inteligjente e veprimtarisë muzikore, ku Red Radoja e ka shprehur përmes krijimtarisë konkrete, duke bërë pjesë të repertorit të tij pianistik krijime muzikore si “Fuqia e Mujit”, “Kalërimi” dhe disa kompozime të tjera, të cilat ai i ka prezantuar njëherazi dhe për publikun shqiptar, dhe për publikun e huaj, dhe njëherazi ka shfaqur një qasje të re të tij drejt trashëgimisë muzikore të Shqipërisë, antike, mesjetare.

- Dr. Ermir Ballgjati: Puna e Red Radosë është dëshmi e një pasurimi që ka përfutur në këto vite ajo që mund të quhet etnomuzikologjia shqiptare. Deri në vitin 1990, hulumtimi etnomuzikologjik në Shqipëri zhvillohej në një kornizë të mbyllur, jo vetëm si epistemë e metodologji, por edhe në planin institucional dhe infrastrukturor. Puna e Redit, nga ana tjetër, është dëshmi e kapaciteteve dhe e kontributeve që janë zhvilluar ndërkohë nga diaspora e qenësishme muzikore shqiptare edhe në fushën e etnomuzikologjisë.



Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Studimit të arteve pranë saj,

organizoi, sot, më 4 mars 2024, një kumtesë ku u prezantua një pjesë e punës etnomuzikologjike e Red Radosë, si një nga aspektet më pak të njohura të punës së tij të shumanshme si muzikant.

Veprimtarinë e çeli zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Vasil Tole, i cili shprehu mirënjohjen për artistin që ka një jetë artistike shumë aktive, veçanërisht në fushën e kompozimeve, që, -siç iu shpreh ai, -është një fushë inteligjente e veprimtarisë muzikore, ku Redi e ka shprehur përmes krijimtarisë konkrete duke bërë pjesë të repertorit të tij pianistik krijime muzikore si “Fuqia e Mujit”, “Kalërimi” dhe disa kompozime të tjera, të cilat ai i ka prezantuar njëherazi dhe për publikun shqiptar, dhe për publikun e huaj, dhe njëherazi ka shfaqur një qasje të re të tij drejt trashëgimisë muzikore të Shqipërisë, antike, mesjetare.

Më tej, akad. Vasil Tole vuri në dukje interesin e veçantë të Red Radosë për subjektet antike mitologjike, që lidhen me mitologjinë shqiptare, me kodet e vjetra, dhe sigurisht edhe me ata tinguj bazë që lidhen me identitetin tonë në muzikë; me ato lloj trashëgimie që i kemi vetëm ne dhe nuk i gjen dot gjëkund tjetër.



Pasi përshkroi veprimtarinë me pianon dhe koncertet që kanë lënë mbresë në publikun e gjerë, akad. Tole kujtoi edhe edukimin e Red Radosë (djali i aktorit të njohur Guiljem Radoja), ku prej prindërve ka filluar lidhjet e ngushta me artin në disa debutime

që ka bërë në filmat shqiptarë kur ishte fëmijë.

Më pas akad. Tole ndali në interesat intelektuale për muzikën, ku u hapet drita kërkimeve muzikologjike dhe theksoi se për fat të mirë Shqipëria është një nga ato vendet që ka trashëgimi të mirë, kur bëhet fjalë për muzikën, gjuhën dhe dialektet, dhe është provuar që krijues shumë të zotë, por edhe më pak të zotë, sa herë i janë referuar tendencës krijuese që lidhet me zbulimin e teknikave kompozicionale dhe të formave dhe gjinive që lidhen me këtë traditë, gjithmonë kanë patur sukses.

Akad. Tole përmendi disa raste në traditën botërore që i kanë paraprirë këtij sukcesi të mbështetur në muzikën e traditës, ndërsa kujtoi edhe kompozitorët shqiptarë si prof. Çesk Zadeja, por edhe disa autorë të tjerë, të cilët gjithsesi kanë mbetur interesantë kur janë marrë me këtë orientim.



Do ta quaja shumë thelbësor që të gjenerosh muzikën prej rrënjëve të tua, -tha akad. Tole, - dhe sigurisht në këtë fazë të jetës së tij, Red Radoja është i fokusuar në Shqipërinë e veriut, drejt terreneve të virgjëra, siç është muzika e fshatit dhe sidomos malësitë e Shqipërisë së veriut me fokus të veçantë tek Eposi dhe kryesisht tek lahuta, që është instrumenti gjenuin që vë në lëvizje Eposin.

Akad. Tole theksoi se: Lahuta, ky instrument që është kaq i dashur për shqiptarët, është së fundi përsëri në vëmendje të qeverisë për ta regjistruar këtë instrument të veçantë, e veçanërisht këndimin me lahutë si pasuri shpirtërore botërore.

Akad. Tole kujtoi ndër të tjera edhe interesin e muzikantit Red Radoja për kulturën

shumëzërëshe polifonike.

Red Radoja dha një shpjegim të plotë mbi metodat e kërkimit të elementëve muzikorë në rrënjët e Eposit shqiptar. Duke e konceptuar si një simbiozë unike vargun dhe poezinë në eposin shqiptar, Radoja tha se vargu duhet marrë në tërësinë e tij, si një varg i koduar me veçoritë e të kënduarit, një varg që bëhet aktiv dhe i plotë vetëm kur këndohet në lahutë.

Radoja shpjegoi se ka punuar me variantet melodike duke studiuar disa variante të vogla në treva që janë të izoluara nga kultura orientale e mesjetës, dhe nga pushtimi turk. Ai iu është referuar këtyre zonave të pastra, për zbuluar muzikën dhe vargun e kënduar të Eposit, që e dallon atë nga variantet paralele në Ballkan.

Red Radoja ka bërë studime e vëzhgime të imëta, duke u futur edhe në detaje të psikikës së lahutarit si një talent i lindur për ta mbartur e përcjellë trashëgiminë.

Red Radoja bëri në fund një paraqitje audio/video të materialit që ka shërbyer si bazë e analizave, për të hapur në vijim diskutimin me pyetje nga auditori.

Ai argumentoi tezën se vargu i eposit përcaktohet më tepër nga muzika, sesa nga logjika poetike. Kjo shkon në të kundërt me qëndrimin mbizotërues, jo vetëm të etnomuzikologjisë, por edhe të albanologjisë shqiptare përgjithësisht.

Kjo tezë u la vend diskutimeve dhe debateve shkencore me akademikët dhe studiuesit e fushave të albanologjisë për të përqsur afërsitë kërkimore në kontekstin e kohës së krijimit të bërthamës së Eposit.



Dr. Edmir Ballgjati bëri një paraqitje të karrierës së muzikantit Red Radoja, i cili ka

studiuar për piano dhe dirigjim pranë Akademisë së Arteve në Tiranë.

Më tej ai i ka thelluar studimet e veta në këto dy fusha edhe në konservatorët e Strasburgut dhe të Dizhonit, por ka studiuar edhe muzikologji në universitetin e Strasburgut.

Dr. Ballgjati shprehu kënaqësinë që prezanton rezultatet e punës kërkimore të një muzikanti të çmuar dhe miku të vjetër siç është Redi Radoja, me të cilin e lidhin vitet kur studionte piano dhe dirigjim pranë Akademisë së Arteve në Tiranë.

Ai vuri në dukje se hulumtimi mbi elementin muzikor përbën një nga aspektet më pak të zhvilluara të studimeve mbi eposin në tërësi. Me përjashtim të dy konferencave të dedikuara si ajo e vitit 1983 në Tiranë dhe ajo e vitit 2014 në Prishtinë, nuk ka patur prurje të qëndrueshme e sistematike nga ana e etnomuzikologëve shqiptarë në këtë drejtim. Mjafton të vihet në dukje se, me përjashtim të punimit "Muzika e eposit heroik legjendar" (1989) të Ferial Dajës, ende sot nuk ka asnjë studim monografik kushtuar muzikës së Eposit legjendar shqiptar. Në këtë kuptim, çdo kontribut i ri është më se i mirëpritur.

Në radhë të dytë, -tha dr. Ballgjati- puna e Redit është dëshmi e një pasurimi që ka përfutur në këto vite ajo që mund të quhet etnomuzikologjia shqiptare. Deri në vitin 1990, hulumtimi etnomuzikologjik në Shqipëri zhvillohej në një kornizë të mbyllur jo vetëm si epistemë e metodologji, por edhe në planin institucional dhe infrastrukturor.

Puna e Redit, nga ana tjetër, është dëshmi e kapaciteteve dhe e kontributeve që janë zhvilluar ndërkohë nga diaspora e qenësishme muzikore shqiptare edhe në fushën e etnomuzikologjisë. Të formuar në shkolla e tradita të tjera studimore, këto kapacitete përbëjnë një aset për pasurimin dhe gjallërimin e mendimit e diskutimit etnomuzikologjik shqiptar në tërësi. Në këtë kontekst, nuk më duket krejt rastësi që një nga tezat, që Redi shtron, është paralelizmi modal i eposit me antifonat gregoriane mesjetare, ndonëse duhet theksuar se edhe Benjamin Kruta pati pohuar njëfarë paralelizmi në karakter me psallmodinë bizantine.

Edhe analiza e funksioneve modale të gradëve e pasuron punën e gjertanishme etnomuzikologjike, e cila shpesh është kufizuar në analizën e elementit melodik vetëm si shkallë.-tha dr. Ermir Ballgjati.

Redaksia e gjeologjisë e minierave dhe redaksia e inxhinierive dhe teknologjive në takim pune për përgatitjet e deritashme për fjalësin paraprak të “Enciklopedisë shqiptare”



Të pranishëm në linjë drejtuesit e redaksive gjegjëse të fushave në Kosovë

Takimi i drejtua nga akad. Ilirian Malollari, i ngarkuar nga redaksia vendore si përgjegjës e koordinues për redaksitë e këtyre grupfushave. Morën pjesë drejtuesit e redaksive të këtyre dy fushave akad. Jorgaq Kaçani dhe akad. asoc. Rrapo Ormeni. Pjesëmarrës nga redaksia vendore edhe akad. Shaban Sinani dhe drejtori i Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike prof. asoc. Marenglen Kasmi.

U vërejt se të dyja redaksitë janë në përmbyllje të punës për fjalësin paraprak të fushave dhe afati i caktuar, fundi i muajit mars, do të respektohet. Për të shmangur mbivendosjet dhe për të saktësuar përgjegjësitë redaksitë janë të gatshme të këmbëjnë listat e hartuara dhe që në vijim të diskutojnë me njëra-tjetrën për përsëritjet e mundshme dhe kufijtë e objektit të tyre të punës. Akad. Fetah Podvorica dhe pjesëmarrës të tjerë në diskutim nga redaksitë gjegjëse në Kosovë (profesorët Minir Dushi, Naser Sahiti, Kemajl Zeqiri, Mihone Kerolli) u shprehën se takime të tilla janë të frytshme dhe duhen zhvilluar më shpesh.

Më tej bashkëbisedimi u zhvillua në formën e pyetje-përgjigjeve në lidhje me

kriteret e përzgjedhjes së fjalëve-referencë për përfshirje në “Enciklopedinë shqiptare”. Prof. Spiro Drushku, akad. asoc. Rrapo Ormeni, akad. Jorgaq Kaçani, prof. Newton Kodhelaj, prof. Flamur Bidaj, prof. Thoma Korini dhe të tjerë paraqitën vështirësitë për identifikimin e personaliteteve dhe nevojën e kriterëve më të detajuar. Pyetje u bënë edhe për radhën e punëve deri në caktimin e autorëve realizues, për rastet kur individi i zgjedhur për të zënë vend në botim ka veç anëve pozitive dhe situata të kritikuar. Shpjegime për këtë u dhanë nga drejtuesit e takimit akad. Ilirian Malollari e prof. Marenglen Kasmi, si dhe nga i ftuari nga redaksia vendore akad. Shaban Sinani.



U riktheksua se kriteret plotësuese për mënyrën e zgjedhjes së personaliteteve që duhen promovuar në “Enciklopedinë shqiptare” mund të propozohen nga redaksitë e punës, redaksitë e fushave. Zgjidhje të zbatueshme në mënyrë uniforme nuk mund të ketë. Vendimet do të merren rast pas rast. Kryesor është kriteri i përfaqësimit. Do të ketë instruksione të nevojshme që dalin në punë e sipër, duke iu referuar grupeve të të ngjashmëve (profesorët, artistët, shkrimtarët, mjekët, inxhinierët etj.). Por puna mund të nisë me ata që i kanë dhënë shoqërisë shqiptare në atë shkallë sa të konsiderohen të padiskutueshëm, për të kaluar me hapin tjetër tek të krahasueshmit e në fund tek të diskutueshmit.

Akad. Sinani vuri në pah se “Enciklopedia shqiptare” mbështetet në lëndën e dy fjalorëve enciklopedikë, të Shqipërisë e të Kosovës; si dhe në botimet e tjera enciklopedike krahinore e tematike, por ndryshimet midis një fjalori dhe një enciklopedie janë të mëdha.

Kjo ka të bëjë para së gjithash me raportet e brendshme. Në fjalorët enciklopedikë albanologjia dhe shkencat shoqërore vetvetiu zënë një vend shumë më me peshë se lënda e ardhur nga shkencat e sakta.

Në ESH raporti do të jetë më i drejtpeshuar midis atyre që quhen albanizma dhe trashëgimive natyrore, pasurive të vendit, apo albaniteve, qofshin minerare, gjeografike, turistike; sido që, për arsye të njohura, shkencat shqiptare dhe ato shoqërore prapë do të jenë me më shumë vend. Në fjalorët enciklopedikë kanë sunduar personalitetet, në ESH do të rregullohen raportet në mënyrë të atillë që të ketë hapësirë për zhvillimet, për dukuritë, për ngjarjet.



Përveç renditjes alfabetike, botimet enciklopedike dhe ato leksikografike dallohen qartazi mes tyre, sepse fjala-referencë në ESH do të shtjellohet në mënyrë të gjithashme: gjuhësore, historike, kulturore.

Lidhur me përzgjedhjen e personaliteteve, pavarësisht nëse u takojnë periudhave të mëparshme apo janë në jetë, më e rëndësishmja është nëse vlerësohen si dukuri të kryera (për rastin e atyre që janë në jetë); dukuri të mbyllura, apo janë në proces e zhvillim.

Në ESH nuk do të bëhen shpikje, por do të paraqitet gjendja më cilësore e studimeve shqiptare deri sot. Karakteri i saj është konfirmues, stili polemik nuk pajtohet me shkrimin enciklopedik; për mospajtimet me çfarë është shkruar në mënyrë të gabuar, me apo pa qëllim, mjafton paraqitja e fakteve që provojnë të kundërtën.



Faza e tanishme u cilësua si periudhë e kalimit nga mbledhja e lëndës në zgjedhjen e saj, që nënkupton kalimin prej listave paraprake në lista të stabilizuara, që lejojnë shpërndarjen e punës dhe caktimin e autorëve. Përzgjedhja do të jetë më e vështirë se mbledhja, sepse, për të respektuar kuotimet e përcaktuara (10 mijë artikuj, 10 mijë njësi enciklopedike) do të duhet që të veçohen jo më shumë se 8 mijë njësi (nga rreth 14 mijë që kanë vetëm dy fjalorët, pa llogaritur enciklopeditë tematike dhe të krahinave), sepse duhen shtuar figurat dhe ngjarjet që kanë qenë të përjashtuara për shkak të kornizës politike të sistemit shoqëror, të kufizimeve ideologjike, fetare dhe kulturore; por edhe për shkak të harresës apo të mosnjohjes. Kështu ESH do të ndreqë çfarë është e padrejtë në botimet e deritashme.

Takim pune me specialistë të së drejtës së autorit dhe të pronësisë intelektuale

- Bashkëbisedim për mbrojtjen e autorësisë së punës krijuese akademike dhe shkencore; për rregullimin ligjor të trashëgimisë së të drejtave të autorit dhe për autorësinë në veprat kolektive



Në takim referuan ekspertë të drejtorisë së përgjithshme të pronësisë intelektuale, znj. Rudina Bollano, znj. Brunilda Çuko dhe znj. Borana Ajazi.

Folëset e ftuara paraqitën statusin juridik të patentave, të pronësisë intelektuale dhe të të drejtave të autorit në Shqipëri; infrastrukturën ligjore lidhur me këtë; sfidat për mbrojtjen e të drejtave të autorit nga përdorimi piratesk, vjedhja dhe tjetërsimi; detyrimet etike, intelektuale dhe pronësore për këto të drejta; rastet e përjashtimit nga këto detyrime (në ligje, në përdorim shkollor etj.); bartësit e së drejtës së patentave dhe të atyre të autorit dhe afatet ligjore të mbrojtjes së tyre; kalimin e përkohshëm të tyre nga subjekti privat në një subjekt juridik; rolin e drejtorisë së përgjithshme të pronësisë intelektuale për mbrojtjen e veprës shkencore / krijuese origjinale; rastet e lejuara nga ligji për përdorim vetjak të veprës së tjetrit; rrugët e arbitrimit dhe të marrjes së vendimeve për mbrojtje të autorësisë së grabitur etj.

Bashkëbisedimi u zhvillua në vijim me pjesëmarrjen ndërvepruese të të pranishmëve fizikisht dhe online: akademikë, profesorë, studiues - anëtarë të komisioneve të përhershme që funksionojnë pranë Akademisë së Shkencave. Interesim i

posaçëm u shpreh për përgjegjësitë ndaj autorësisë së trashëguar në veprat shumautorëshe, projekte madhore në albanologji, si “Fjalori i madh i shqipes”, “Enciklopedia shqiptare” dhe “Historia e shqiptarëve” (akad. Valter Memisha, dr. Brikena Liko); për ribotimin e paautorizuar dhe të pashpërblyer të veprave akademike (rasti i “Fjalorit të gjuhës shqipe”, 1981); për mënyrën e përdorimit publik në botime të veprave në dorëshkrim, të burimeve arkivore dhe të kartotekës (prof. asoc. dr. Olsi Lelaj); për mungesën e përfaqësimit institucional nga ministria përkatëse në grupin ndërinstitucional të të drejtave të autorit ngritur në kuadër të përafrimit ligjor dhe eurokodifikimit të ligjeve dhe për dhunimin e të drejtave të autorit në rastin e shtimit të tirazhit për nevoja të mësimdhënies si vepra të plota, në formën e riprodhimeve tërësore fototipike (akad. Aurela Anastasi).



Takimi u drejtua nga sekretari shkencor akad. Shaban Sinani dhe shërbeu si rast për shprehjen e shqetësimeve të të pranishmëve si autorë dhe në mënyrë të veçantë të atyre të Akademisë së Shkencave si institucion, si ent botues që publikon çdo vit 30-40 vepra; që trashëgon në pronësi intelektuale qindra botime të mëparshme, që prej themelimit të saj (1972); botime që janë realizuar nga studiues të punësuar pranë instituteve shkencore të rrjetit të saj, të shpërblyer për punën e kryer dhe të plotësuar me honorare modeste të asaj periudhe.



Ky bashkëpunim do të vazhdojë, në formën e këshillimit dhe të ekspertizës.

Instituti Alb-Shkenca dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë lidhin një marrëveshje bashkëpunimi

Instituti Alb-Shkenca dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë lidhën sot, ditën e martë, më 5 mars 2024, një marrëveshje bashkëpunimi në praninë e Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushit, zëvendëskryetarit akad. Vasil Toles, Kryetarit të Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike akad. Neki Frashërit, akad. Ilia Mikerezit, akad. Genc Sulçebeut, akad. Rrapo Ormënit, akad. Floran Vilës dhe sekretarit të përgjithshëm për Institutin Alb-Shkenca prof. dr. Fatos Yllit. Ishin të pranishëm gjithashtu Kryetari i degës së Tiranës prof. Ardian Maçi dhe sekretarja e degës së Tiranës prof. as. Shpresa Tafaj.



Në fillim të takimit mes palëve, Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi foli rreth nevojës për bashkëpunim, duke theksuar se komuniteti ynë shkencor është i vogël për të punuar i ndarë e secili më vete. Synimi është që të vendosim një lidhje midis mendjeve që janë jashtë dhe njërive tona, për të lehtësuar e mundësuar bashkëpunimin, deri edhe nëpërmjet drejtimit të njërive kërkimore pranë ASHSH a projekteve të përbashkëta.

Akad. Gjinushi foli për aktivizimin e deritanishëm të diasporës shkencore pranë ASHSH, gjë që ka nisur me ngritjen e komisioneve të përhershme me anëtarë të jashtëm nga diaspora dhe zgjedhjen si anëtarë të jashtëm të atyre që janë të suksesshëm.

Kemi një potencial të madh jashtë, - tha akad. Gjinushi, -por përmes teknologjive të reja të komunikimit është e mundur që ta frenojmë “rrjedhjen e trurit” e ta “risjellim” atë nëpërmjet bashkëpunimit në distancë.



Ndërsa foli për perspektivat e këtij bashkëpunimi me Institutin e Alb-shkencës, theksoi se kanë dy objektiva kryesore të përbashkëta: rritjen e investimit e financimit për shkencën, të paktën e fillimisht, në 1% të GDP dhe ngritjen e njësive të reja kërkimore elitare ne fushat kryesore e më me ndikim si ato të nanoteknologjisë e bio-gjnetikes. Së bashku i bëjmë më shumë presion qeverisë për të mbështetur realizimin e këtyre synimeve-theksoi ai.

Prof. dr. Fatos Ylli falënderoi akad. Gjinushin dhe Kryesinë e ASHSH dhe shprehu kënaqësinë që bashkëpunimi mes palëve po forcohet në rrugë zyrtare, duke e bërë më të qëndrueshëm.

Marrëveshja ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit Alb-Shkenca bëhet për bashkëpunimin në fushën e kërkim-zhvillimit dhe për forcimin e lidhjeve me diasporën shkencore shqiptare, me qëllim përfshirjen e saj në programet e zhvillimit kombëtar.

Një ndër synimet e kësaj marrëveshjeje është edhe për të dhënë kontribut për projektet madhore të drejtuara nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, si Fjalori i madh i shqipes, Historia e shqiptarëve dhe Enciklopedia shqiptare., etj.

Marrëveshja u nënshkrua nga Kryetari i Akademinë së Shkencave të Shqipërisë

akad. Skënder Gjinushi dhe sekretari i përgjithshëm për Institutin Alb-Shkenca prof. dr. Fatos Ylli.



Instituti Alb-Shkenca është një strukturë shkencore joqeveritare e jofitimprurëse që bashkon studiues të të gjitha disiplinave shkencore nga diaspora dhe nga mbarë trojet shqiptare në Ballkan.

Teksti i marrëveshjes:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit Alb-Shkenca

Për bashkëpunimin në fushën e kërkim-zhvillimit dhe për forcimin e lidhjeve me diasporën shkencore shqiptare

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH) dhe Instituti Alb-Shkenca (IASH), në vijim Palët, nxitur nga vullneti e dëshira për bashkëpunim shkencor, me qëllim përfshirjen e diasporës shkencore shqiptare në programet e zhvillimit kombëtar, bien dakord për sa vijon në këtë marrëveshje.

Neni 1

Parime të përgjithshme

1. Në bashkëpunimin mes tyre Palët respektojnë liritë akademike e autonominë në kërkim dhe mbështeten në parimin e barazisë e të respektit të ndërsjellë. Palët projektojnë dhe realizojnë veprimtari shkencore të përbashkëta në funksion të përfshirjes së diasporës shkencore shqiptare në sistemin kërkimor-shkencor brenda vendit e të rritjes së saj në kuadër të këtij sistemi; në funksion të rritjes së rolit të saj në zhvillimin

kombëtar dhe promovimin e përfaqësuesve të saj brenda dhe jashtë vendit.

Palët mbajnë qëndrim kritik dhe përjashtues ndaj çdo forme të plagjiaturës, manipulimit të të dhënave, diletantizmit dhe vullnetarizmit në shkencë.

Neni 2 Përparësitë

1. Palët bashkëpunojnë mes tyre për krijimin e një amze kombëtare të diasporës intelektuale shqiptare dhe lehtësimin e ndërveprimit të saj me institucionet kërkimore-shkencore të vendit; për fuqizimin e ndikimit të saj në zhvillimin e shkencës në Shqipëri; për përfaqësimin dinjitoz të dijes shqiptare në vend dhe në Botë; për promovimin e vlerave mendore kombëtare brenda dhe jashtë vendit; për përshpejtimin e procesve të eurointegritimit.

2. Për realizimin e objektit dhe të qëllimeve të kësaj marrëveshjeje Palët organizojnë veprimtari shkencore me interes të përbashkët dhe mundësojnë praninë e përfaqësuesve të njëra-tjetrës në veprimtaritë e veçanta. Ato përgatisin e realizojnë konferenca shkencore në fusha të albanologjisë dhe të shkencave të sakta; takime vjetore për diskutimin dhe marrjen e vendimeve për nisma e projekte të përbashkëta; forume e tryeza shkencore në linjë dhe me prani fizike për çështje të integritetit të intelektualëve në diasporë si kontribuues në strategjitë kombëtare të zhvillimit.

2. Palët bashkëveprojnë veçmas për çështje që lidhen me diasporën në përgjithësi: për gjuhën e njëzuar si pasuri kombëtare dhe ruajtjen e saj në brezat e rinj; për trashëgiminë kulturore dhe identitetin; për ruajtjen e lidhjeve me vendin e origjinës; për ndërsjellë në fushën e kërkimit shkencor, përdorimit të njëzuar të gjuhës dhe terminologjisë bashkëkohore të shkencës e teknikës, ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Për këtë qëllim ato ndikojnë bashkërisht për rritjen e ndikimit dhe të përgjegjësisë së institucioneve të arsimit shtetëror dhe të kërkimit shkencor ndaj shqiptarëve në diasporë, përmes botimeve didaktike dhe në forma të tjera. Botimet përfshijnë historinë e ngulimeve të vjetra dhe të diasporave të reja; vlerat dhe ndikimin e tyre në jetën kombëtare e shtetërore të Shqipërisë; hartëzimin dhe kronologjinë e shtresëzimeve në diasporë; identitetin dhe diversitetet e saj.

3. Palët marrin përsipër të mbështesin njëra-tjetrin për përfshirjen në rrjetet ndërkombëtare të kërkimit institucionalisht e përmes përfaqësuesve të tyre dhe për nxitjen e realizimit të nismave dhe projekteve me palë të treta.

4. Palët bashkëpunojnë për një terminologji të përbashkët shkencore në të gjitha disiplinat. Përfaqësues të diasporës intelektuale ftohen për të dhënë kontribut për projektet madhore të drejtuara nga ASHSH, si Fjalori i madh i shqipes, Historia e shqiptarëve dhe Enciklopedia shqiptare.

5. Palët nxisin rritjen e interesit për kërkim shkencor tek brezat e rinj.

Neni 3
Pronësia intelektuale

Palët ruajnë fshehtësinë e informacionit shkencor që shkëmbejnë mes tyre sipas njoftimit paraprak; si dhe të dhënat e njohuritë e ofruara gjatë vlefshmërisë dhe / ose zbatimit të kësaj marrëveshjeje. E drejta e pronësisë intelektuale të një pale mbetet në zotërim të plotë të saj, me përjashtim të rasteve kur ato merren vesh ndryshe.

Neni 4
Të dhënat personale

Palët lejojnë përpunimin e të dhënave në funksion të kësaj marrëveshjeje në përputhje me legjislacionin në fuqi; duke përfshirë të drejtën e disponimit në bazat e të dhënave, në skedarët kompjuterikë dhe sistemet telematike për qëllime që lidhen me këtë marrëveshjeje.

Neni 5
Palët e treta

Palët janë pajtuar që kjo marrëveshje nuk përjashton mundësinë e bashkëpunimit me subjekte të tjera, me kusht që bashkëpunimet me palët e treta të mos bien ndesh me qëllimin e kësaj marrëveshjeje. Palët nuk janë përgjegjëse për mosmarrëveshjet që mund të kenë me palë të treta më vete.

Neni 6
Komunikimi

Palët mbajnë komunikim të vazhdueshëm mes tyre dhe shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për realizimin e qëllimit të marrëveshjes. Komunikimi kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike. Në rast të paraqitjes së kërkesave, Palët japin përgjigje me përparësi.

Neni 7
Amendimet

Kësaj marrëveshjeje Palët mund t'i bëjnë në çdo kohë mendime dhe mbi bazën e

saj mund të hartohen, nënshkruhen e bashkëngjiten protokolle të veçanta, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të paraqitur me shkrim.

Neni 8
Paqartësitë

Paqartësitë dhe mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin e zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshje zgjidhen me mirëkuptim midis Palëve.

Neni 9
Vlefshmëria

1. Kjo marrëveshje nënshkruhet për një periudhë prej tre vjetësh. Afati i vlefshmërisë së saj mund të zgjatet edhe për tre vjet të tjera nëse asnjëra nga Palët nuk kërkon paraprakisht dhe me shkrim ndërprerjen e saj së paku gjashtë muaj përpara mbarimit të vlefshmërisë.

2. Palët mund të tërhiqen nga kjo marrëveshje duke ia komunikuar me shkrim këtë vendim Palës tjetër së paku 6 muaj përpara.

3. Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe, në dy kopje për secilën Palë dhe hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Takim pune në Institutin e Arkeologjisë Tiranë

Kryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi, realizoi një takim pune me punonjësit e Institutit të Arkeologjisë (05. 03. 2024)



- U diskutua plani i përgjithshëm i punës kërkimore shkencore dhe projekteve në terren për vitin 2024. Njëkohësisht u përvijuan edhe disa nga drejtimet kryesore të kërkimeve arkeologjike për të ardhmen

- Drejtori i Institutit të arkeologjisë, akad. Adem Bunguri, bëri një paraqitje të përgjithshme mbi planifikimin e punës shkencore të tri departamenteve të Institutit të arkeologjisë për vitin 2024

- Të gjithë punonjësit shkencorë të Institutit të Arkeologjisë folën konkretisht për punën shkencore dhe projektet individuale kërkimore për vitin 2024 dhe planet e përafërta për të ardhmen. Raportimet e tyre u shoqëruan edhe me diskutime për përmirësimet e mundshme

- Pas takimit, akad. Gjinushi bëri një vizitë në fondet e Institutit të Arkeologjisë dhe në Muzeun Arkeologjik

Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, i shoqëruar nga akad. asoc. Gëzim Hoxha, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, realizuan ditën e martë, më 5 mars 2024, një takim pune në Institutin e Arkeologjisë, i integruar tashmë institucionalisht në Akademinë e Shkencave të

Shqipërisë.

Në këtë takim ishin të pranishëm të gjithë punonjësit kërkimorë shkencorë, të kryesuar nga Drejtori i Institutit, akad. Adem Bunguri.

Takimi ishte organizuar për të diskutuar planin e përgjithshëm të punës dhe projekteve për vitin 2024.



Fillimisht, Drejtori i Institutit të Arkeologjisë, akad. Adem Bunguri, bëri me dije se Instituti i Arkeologjisë përbëhet nga 3 departamente: Prehistoria, Antikiteti ilir; Antikiteti i Vonë dhe Mesjeta. Punonjësit ndihmës-shkencorë janë të inkuadruar në departamente. Numri i punonjësve kërkimor-shkencorë dhe ndihmës shkencorë aktualisht është 29.

Më tej ai bëri një paraqitje të përgjithshme mbi planifikimin e punës shkencore të tri departamenteve të Institutit të Arkeologjisë për vitin 2024.

Kryetari i ASH, akad. Skënder Gjinushi i inkurajoi punonjësit shkencorë për realizimin e temave kërkimore- shkencore dhe projekteve për zbulimet arkeologjike në terren, në vazhden më të mirë të traditave kërkimore arkeologjike në Shqipëri.

Ai u shpreh se me inkuadrimin e ri institucional, nuk bëhet fjalë për reduktim projektsh, por për përqendrim të planifikuar të tematikave kërkimore, dhe madje një zgjerim të bashkëpunimeve të deritanishme.

Kjo gjë mund të realizohet duke shtuar bashkëpunëtorët, nëpërmjet vazhdimit të projekteve ekzistuese dhe bashkëpunimeve të mëtejshme me institucione analoge të

huaja dhe me kolegë të trevave shqiptare apo të diasporës, ku bashkëdrejtues do të jenë përherë punonjësit më me përvojë nga Instituti i Arkeologjisë. Ne kemi vërejtur se potencialet për kërkim shkencor bashkëkohor në Institutin e Arkeologjisë janë të pranishme, prandaj ato duhen vënë në punë në mënyrën më efektive, tha më tej akad. Gjinushi.

Më pas ai iu dha mundësinë për të bashkëbiseduar të gjithë punonjësve shkencorë të Institutit të Arkeologjisë:

- Rovena Kurti, Edlira Andoni, Adrian Anastasi nga departamenti i prehistorisë.
- Sabina Veseli, Eduard Shehi, Belisa Muka, Saimir Shpuza, Olgita Ceka, Jamarbër Buzo dhe Lavdosh Jaupaj, nga departamenti i antikitetit.
- Brikena Shkodra, Elio Hobdari, Elvana Metalla, Paulin Pushimaj, Nevila Molla dhe Melsi Labi nga departamenti i antikitetit të vonë dhe mesjetës.

Të gjithë punonjësit prezantuan sistematikisht temat individuale të kërkimeve shkencore dhe projekteve në terren për fushat përkatëse dhe sipas grupeve të punës.

Nga fushën prehistorisë u paraqitën projektet: Kontekstualizimi i Neolitit në fushën Korçës (vëzhgim sipërfaqësor; sondazh arkeologjik); Gërmime arkeologjike në vendbanimin e Neolitit të Hershëm në Pogradec; LIN 3; Gërmime në vendbanimin kodrinor të Barçit (Korçë); Harta arkeologjike nënujore (Gjiri i Vlorës, Durrësit, Liqeni i Ohrit, lumi i Dunavecit); Harta Arkeologjike Nënujore e Bregdetit Shqiptar në kuadër Mesdhetar. Paralele dhe veçanti; Gërmime me karakter sondazhi në fortifikimin prehistorik të Orenjës.



Nga punonjësit e departamentit të antikitetit, u paraqitën projektet:

Projekti shqiptaro-polak në Bushat; Projekti Nymphaion-i i Apolonisë; Kaonia bregdetare - Phoinike dhe Butrinti; Apolonia e Ilirisë; Kërkime arkeologjike në zonën Vagalat/Dobra, fusha e Livadhjasë dhe lugina e mesme e Pavllës; Kërkime të reja në Çukën e Ajtoit; Projekt studimor (The coinage between Greeks and non-Greeks: the case of the Illyrians compared to the Thracians and the Celts.); Projekti Bylis Instituti i Arkeologjisë dhe ASHSH; Projekti Gurëzeza (Eugenium) ; Lugina e Drinosit: Antigonea, Hadrianopolis dhe vendbanime të tjera, kërkime arkeologjike; Lugina e Shushicës, qyteza, tempuj, kisha; Arkeologji e peizazhit në zonën Memaliaj-Tepelenë; Sistemi i Fortifikimeve antiko-mesjetare të Durrësit; Kështjella e Beratit -dokumentimi grafik digjital dhe evolucioni historik; Peisazhe të fortifikimeve antike të Shqipërisë Lindore, (FLEAP): syrvey dhe studimi i zonës midis Elbasanit dhe Korçës; Projekti Iliria Dixhitale; Varret shkëmbore të Matit; Projekti kërkimor - shkencor "Amantia"; Identifikimi dhe inventarizimi i objekteve dhe strukturave antike të në fshatin Klos pranë qytetit antik.

Nga antikiteti i vonë dhe mesjeta u paraqitën projektet: Dyrachium dhe prapatoka e tij; Zgërdheshi : Transformimi i një qyteti ilir gjatë antikitetit të vonë dhe mesjetës; Durrësi mesjetar. Amfiteatri i Durrësit; Lugina e poshtme e Drinit në Mesjetë (Koman-Sardë); Topografia Urbane e Butrintit gjatë Antikitetit të Vonë dhe Mesjetës; Dyrachium në antikitetin e vonë; Lagja romake-bizantine jashtë mureve të Castrum Scampis; Manastiri i Shën Mërisë, Ballsh; Sërvej Arkeologjik i vendbanimit të Trajanit në rrethin Korçës; Drivastum – Drishti nga Antikiteti në Mesjetë.



Gjatë paraqitjeve individuale të çdo punonjësi, pati edhe diskutime të ndryshme, veçanërisht për ekonomizimin dhe shpërndarjen sa më të mirë të projekteve kërkimore, përqendrimin e punës në tematikat themelore historike për Shqipërinë, rritjen e efektivitetit të palës shqiptare në projektet në bashkëpunim me institucionet e huaja dhe angazhimin sa më efektiv të forcave të reja shkencore dhe studentëve në projektet kërkimore-shkencore arkeologjike.

Në fund, drejtori, akad. Adem Bunguri falënderoi Kryetarin e Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushin, për praninë në këtë takim të rëndësishëm pune, për fjalët inkurajuese ndaj punonjësve shkencorë, dhe për qartësinë e vështrimit të perspektivës së kërkimeve arkeologjike.



Më pas, ai e ftoi Kryetarin Gjinushi për të vizituar Fondet e Institutit të Arkeologjisë dhe Muzeun Arkeologjik, për të cilat është menduar të riorganizohen, me synimin për ngritjen e një Muzeu Arkeologjik me parametra bashkëkohorë dhe me perspektivë vizitueshmërie shumë të lartë.

Pasi u kryen këto vizita, Kryetari Gjinushi u shpreh i kënaqur me potencialet ekzistuese dhe pasurinë shumë të madhe të fondeve të arkeologjisë.

Redaksia vendore e "Enciklopedisë shqiptare" bën vlerësimin e punës së saj dhe të redaksive të fushave

- Synimi kryesor: hartimi e dorëzimi i fjalësit paraparak të "Enciklopedisë shqiptare" brenda muajit mars

- Synime të tjera për punën në vijim: njohja e ndërsjellë e listave / fjalësve të përgatitur prej redaksive gjegjëse në Tiranë e në Prishtinë; kalimi në fazën e përzgjedhjes; krijimi i bazës së përbashkët të të dhënave për të mundësuar më tej ndarjen e artikujve në madhësinë që e kërkon niveli i përfaqësimit



Mbledhja u drejtua nga akad. Skënder Gjinushi, kryetar i ASHSH dhe kryeredaktor i "Enciklopedisë shqiptare".

Fillimisht ai njoftoi të pranishmit për ngritjen e Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike si strukturë e përhershme pranë ASHSH, me dy sektorë: një për botimet enciklopedike dhe një për ato albanologjike. Anëtarët e redaksive të të tre niveleve do të kenë tashmë një mjedis të posaçëm takimesh e pune.

Në vijim akad. Gjinushi tha se hartimi i "Enciklopedisë shqiptare" përfaqëson nismën me përgjegjësinë më të madhe shkencore që është ndërmarrë ndonjëherë nga ASHSH. Volumi i punës është i pakrahasueshëm me atë për fjalorët enciklopedikë. Përzgjedhja e fjalësit është çështje delikate dhe redaksitë e fushave duhet të gjejnë kritere praktike plotësuese, kryesisht përmes krahasimit të të ngjashmëve dhe shembujve. Nga

pikëpamja pragmatike në përzgjedhje hapat duhet të hidhen nga njësitë e sigurta (personalitete, ngjarje) tek të diskutueshmit. Në diskutimet me redaksitë përkatëse në Kosovë ka shumë rëndësi që vija ndarëse midis lëndës enciklopedike dhe vlerave të tjera që nuk e kanë cilësinë e pranimi në ESH të jetë e njëjtë (për figura të përveçme, emërtime, dukuri). Redaksitë e së njëjtës fushë të zbatojnë të njëjtat nivele pranimi e shkallëzimi.

Fjalorët enciklopedikë dhe botime të tjera të të njëjtit karakter janë burim me rëndësi të dhënash, janë një bazë e vlerësueshme, por redaksitë të mos mendojnë se u duhet qendruar robërisht atyre, vijoi akad. Gjinushi. Dallimet midis fjalorëve dhe enciklopedive janë jo vetëm në vëllim, por dhe në strukturë e përmbajtje. Enciklopedia nuk është një bashkim fjalorësh. E njëjta njësi enciklopedike ndryshe paraqitet në kategorinë "zë" e ndryshe në atë "artikull". Kujdes shkencor duhet në ndarjen e lëndës sipas rëndësisë për artikuj të vegjël, të mesëm, përmbledhës e të mëdhenj. Artikujt monografikë propozohen nga redaksitë e fushës dhe miratohen nga redaksia qendrore.



Në vijim anëtarët e redaksisë informuan për gjendjen e punëve dhe respektimin e kalendarëve. Shumica e redaksive funksionojnë në grup, sipas afërsisë së fushave. Anëtarët e redaksisë vendore po plotësojnë detyrat e kujdestarisë organizative ndaj redaksive të grup-fushave; një pjesë e tyre kanë organizuar mbledhje të përbashkëta me redaksitë e Kosovës (A. Angjeli, I. Malollari); shumica e redaksive të fushave e kanë përfunduar fjalësin paraprak dhe po ndërveprojnë me redaksitë e afërme për të shmangur dyfishimet e mbivendosjet (A. Leka, A. Bunguri, P. Qirjazi); disa nga redaksitë

kanë hartuar modele instruktivë, nisur nga mendimi se kriteret kuptohen më qartë kur ilustrohen.

Gjatë bashkëbisedimit u shtruan probleme që kërkojnë mbështetje institucionale, si nevoja për ekspedita në terren dhe për porositjen e të dhënave të sigurta statistikore nga institucionet e specializuara (P. Qirjazi); mundësia e rigrupimit të redaksive të fushave sipas një nënndarjeje alternative (A. Xhuvani); nevoja e njësimi të terminologjisë me redaksitë në Kosovë (A. Civici); rëndësia e burimeve parësore jashtë fjalorëve enciklopedikë (A. Leka); nxitja e vetëveprimit në disa redaksi me prapambetje relative dhe nevoja për ndonjë plotësim a zëvendësim në ndonjë prej tyre (Sh. Sinani, A. Hoda); mundësia e formulimit të rregulloreve të veçanta për qëllime praktike për çdo redaksi fushe etj.



Ky takim zhvillohet në kuadër të përgatitjeve për mbledhjen e redaksisë qendrore që do të mbahet në Vërmicë (Prizren) më 17-18 mars.

Kryetari Gjinushi falënderoi të pranishmit për informimin dhe diskutimet e dobishme.

Lidhet marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) dhe Akademisë së Sigurisë (AS)

Sot, më 6 mars 2024, u lidh një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) dhe Akademisë së Sigurisë (AS).

Në nënshkrimin e marrëveshjes morën pjesë Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi; zëvendëskryetari i ASHSH, akad. Vasil Tole; sekretari shkencor i ASHSH, akad. Shaban Sinani dhe Kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike në ASHSH, akad. Neki Frashëri.



Nga Akademia e Sigurisë morën pjesë Rektori i Akademisë së Sigurisë, prof. Ilirjan Mandro; dekani i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, drejtues i parë, Xhevahir Karaj; drejtori i Kolegjit Profesional të Formimit Policor, drejtues, Mithat Tola, dhe shefi i Sektorit të Kërkimit Shkencor të Projekteve dhe Inovacionit, prof. asoc. dr. Zaho Golemi.

Prof. Ilirjan Mandro informoi për ecurinë e zhvillimit të arsimit të lartë policor, për akreditimin institucional 5-vjeçar të AS-së, akreditimin e programeve bachelor dhe hapat drejt nivelit master e doktoraturë.

Më tej, ai foli për hapat që janë hedhur, që ndikojnë në zhvillimin e policisë së

shtetit, por edhe të vendit, siç është bashkëpunimi me policinë italiane dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet akademike, që në rastin e kësaj marrëveshjeje do të konkretizohet me konferenca shkencore në nivel ekspertësh, mbështetje të Akademisë së Sigurisë me publikime të Akademisë së Shkencave dhe strukturave të Instituteve kërkimore Shkencore, etj.

Akad. Skënder Gjinushi falënderoi prof. Ilirjan Mandron dhe drejtuesit e Akademisë e Sigurisë për ftesën për marrëveshjen me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe tha se propozimi për këtë marrëveshje është mirëpritur.



Akad. Gjinushi kujtoi se bashkëpunimi ka nisur më herët me praktikën e dhurimit të librave nga ASHSH dhe kjo praktikë do të vijojë me dhurimin e librave që hyjnë edhe në kulturën e përgjithshme të shkollimit të lartë.

Akad. Gjinushi përgëzoi faktin që Akademia e Sigurisë po shkon drejt objektivave për një shkollim të mirë dhe premtoi mbështetjen me bashkëpunime në kërkime shkencore.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi nga pala përfaqësuese e Akademisë së Sigurisë u propozua edhe bashkëpunimi për ndihmë nga arkeologët, në rastin e gjetjes së veprave arkeologjike apo veprave të artit që janë vjedhur, e më gjerë.

Akad. Gjinushi foli rreth pikëtakimeve institucionale, ku palët do të bashkëpunojnë me përparësi për çështje kërkimore që lidhen me sigurinë dhe paqen

shoqërore, me projekte dhe me veprimtari të tjera të përbashkëta.

Akademia e Shkencave në bazë të kësaj marrëveshjeje do të inkurajojë kërkimet ndërdisiplinore në funksion të shkencave të sigurisë dhe të atyre të përfaqësuara me to; duke siguruar ndërsjelltas praninë e ekspertëve në kërkim dhe në formimin e kërkuesve të rinj në ciklin e doktoratës e të postdoktoratës për fushën e sigurisë.



Përfaqësues të AS do të përfshihen sipas fushave në komisionet e përhershme që funksionojnë pranë ASHSH, në përputhje me kriteret e përfaqësimit referuar gradave shkencore dhe titujve akademikë. ASHSH nxit krijimin e një komisioni të përkohshëm për çështje të sigurisë dhe kriminologjisë.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, ASHSH fton ekspertë të AS të kontribuojnë në projektet shkencore të saj, si Enciklopedia shqiptare dhe Historia e shqiptarëve dhe për projekte të tjera, kryesisht të atyre që lidhen me sigurinë, hetimin e kriminologjinë.

Palët do të përfshihen në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve shkencore, ku Akademia e Shkencave do të inkurajojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tyre në to dhe do t'u mundësojnë studiuesve të tyre hapësira botimi në periodikët e tyre, në përputhje me kërkesat për origjinalitet e cilësi.

Marrëveshja u nënshkrua nga Kryetari i Akademinë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, dhe Rektori i Akademisë së Sigurisë, prof. Ilirjan Mandro. Kjo marrëveshje nënshkruhet për një periudhë katërvjeçare.



Teksti i marrëveshjes:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) dhe Akademisë së Sigurisë (AS)

Neni 1

Përcaktimi i Palëve

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej ASHSH), me qendër në Tiranë, sheshi Fan Noli 1001, e përfaqësuar nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar; dhe Akademia e Sigurisë (më tej AS), me qendër në Tiranë (Sauk), e përfaqësuar nga prof. dr. Ilirjan Mandro (Drejtuës i lartë), Rektor; bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në interesin e përbashkët, bien dakord për të bashkëpunuar mes tyre në përputhje me këtë marrëveshje.

Neni 2

Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim përcaktimin e drejtimeve kryesore të bashkëpunimit midis Palëve dhe të formave të realizimit të tij.

Neni 3

Parime bazë

Palët respektojnë në bashkëpunim autonominë akademike e universitare dhe Kodin europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor. Ato refuzojnë çdo formë të plagjiaturës dhe manipulimit të të dhënave.

Neni 4

Drejtimit kryesore të bashkëpunimit

Palët bashkëpunojnë me përparësi për çështje kërkimore që lidhen me sigurinë dhe paqen shoqërore, me projekte dhe me veprimtari të tjera të përbashkëta. Palët bashkëpunojnë për përsosjen e programeve akademike në këto fusha dhe inkurajojnë kërkimet ndërdisiplinare në funksion të shkencave të sigurisë dhe të atyre të përafërta me to; duke siguruar ndërsjelltas praninë e ekspertëve në kërkim dhe në formimin e kërkuesve të rinj në ciklin e doktoratës e të postdoktoratës për fushën e sigurisë.

Neni 5

Bashkëpunime të veçanta

Përfaqësues të AS përfshihen sipas fushave në komisionet e përhershme që funksionojnë pranë ASHSH, në përputhje me kriteret e përfaqësimit referuar gradave shkencore dhe titujve akademikë. ASHSH nxit krijimin e një komisioni të përkohshëm për çështje të sigurisë dhe kriminologjisë.

ASHSH fton ekspertë të AS të kontribuojnë në projektet shkencore të saj, si Enciklopedia shqiptare dhe Historia e shqiptarëve dhe për projekte të tjera, kryesisht të atyre që lidhen me sigurinë, hetimin e kriminologjinë.

Palët ftojnë përfaqësues të njëra-tjetrës të marrin pjesë si anëtarë jurie, vlerësues të jashtëm, recensues e oponentë në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve shkencore.

Palët i bëjnë të njohur njëra-tjetrës programet vjetore të zhvillimit, në veçanti kalendarin e konferencave e të veprimtarive të tjera kërkimore, me qëllim inkurajimin e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të tyre në to.

Neni 6

Shkëmbimi i botimeve dhe i informacionit

Palët shkëmbejnë rregullisht informacionin shkencor që lidhet me botimet e tyre: bibliografitë, katalogët dhe udhërrëfyesit e botimeve.

ASHSH lehtëson marrjen e informacionit të numerizuar prej AS në kuadër të rrjetëzimeve rajonale të informacionit shkencor, nëpërmjet qendrës së koordinimit dhe përhapjes së informacionit shkencor që funksionon pranë saj.

ASHSH i dhuron rregullisht AS koleksionin e botimeve të saj: monografi, përmbledhje aktesh e dokumentesh, periodikë e buletine.

Palët u mundësojnë studiuesve të tyre hapësira botimi në periodikët e tyre, në përputhje me kërkesat për origjinalitet e cilësi.

Palët informojnë rregullisht njëra-tjetrën për marrëveshjet dy ose shumëpalëshe me interes të përbashkët.

Neni 7

Protokollet e bashkëpunimit

Në frymën e kësaj marrëveshjeje Palët nënshkruajnë protokolle dhe akte të tjera dakordësie për realizimin e nismave të veçanta shkencore.

Neni 8

Zbatimi dhe kohëzgjatja

Kjo marrëveshje nënshkruhet për një periudhë katërvjeçare. Palët takohen dy herë në vit për të vlerësuar ecurinë e saj. Ajo ndërpritet në rastet kur: a). Ndryshon statusi ligjor i institucioneve dhe ky ndryshim prek funksionet themelore të tyre, me efekt në Palën tjetër; b). Njëra nga Palët shpreh me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar shqetësimin për cënimin e interesave bazë të saj në procesin e zbatimit.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Paqartësitë e mundshme Palët i zgjidhin me diskutim e mirëkuptim mes tyre. Në rast të mospajtimit për një periudhë gjashtëmujore për çështjet në diskutim, kjo marrëveshje e humbet fuqinë e saj. Palët mund të kërkojnë njëanshmërisht ndërprerjen e marrëveshjes duke i paraqitur kërkesë me shkrim Palës tjetër jo më pak se tre muaj para.

Neni 10

Të fundme

Kjo marrëveshje nënshkruhet në dy kopje, në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën Palë.

Akademia e të Rinjve drejt rithemelimit

- Mbledhje e komisionit të ngritur nga Akademia e Shkencave për konkursin e pranimit të anëtarëve të rinj të Akademisë së të Rinjve, në përputhje me kriteret bazë të Statutit dhe "Kartës themelore të ALLEA-s"



Komisioni, me praninë e gjithë anëtarëve, nën drejtimin e akad. asoc. Adrian Civici, kryetar; bazuar në vendimet nr. 63, 64 dhe 65 të Asamblesë; bëri vlerësimin e përputhshmërisë së të dhënave të kandidatëve të regjistruar sipas dokumenteve depozituar në dosjet e tyre.

U vërejt se thirrjes së Akademisë së Shkencave për pjesëmarrje në konkurs i janë përgjigjur 13 kandidatë. Kërkesat me karakter shkencor (mbrojtja e doktoratës, veprimtaria botuese, vlerësimi nga njësia e kërkimit shkencor/ universitar) janë plotësuar nga të gjithë. Shumica e kandidatëve kanë artikuj të indeksuar në platforma e baza ndërkombëtare të dhënash (Research Gate, Google Scholar, duke përfshirë platformën Scopus etj.). Profili i tyre intelektual është mbresëlënës.

Lidhur me kriterin moshor, që është i njësuar në të gjitha akademitë e ngjashme në Europë, tre prej tyre e kanë kaluar moshën 40 vjeç.

Në mbledhje u çmua lart veprimtaria e anëtarësisë së deritashme të Akademisë së të Rinjve, anëtare e Global Young Academies. Tre nga anëtarët e saj janë në moshën nën 40 vjeç dhe do të rikonfirmohen nga komisioni në përbërjen e akademisë së rithemeluar. Anëtarësia e mëparshme do të ftohet të vazhdojë bashkëpunimin me Akademinë e

Shkencave në kuadër të komisioneve të përhershme dhe të strukturave të tjera të saj. ASHSH do të kryejë ndaj tyre detyrën e kujdesit në karrierë me të njëjtat përgjegjësi si zyrat e Alumnit në universitete.



Së shpejti komisioni do të shpallë vendimin e tij dhe pas kësaj do të organizohet ceremonia e konstituimit të Akademisë së ringritur të të Rinjve. Ajo do të ketë statusin e një komisioni të përhershëm, mbështetje morale dhe intelektuale nga ASHSH, një tribunë botimesh shkencore (anuar), si dhe një buxhet të arsyeshëm për veprimtari shkencore dhe pjesëmarrje në evente të rëndësishme.

Një nga dy sesionet e Asamblesë së Përgjithshme të ALLEA-s, që do të mbahet në muajin maj 2024 në Berlin-Brandenburg, do t'i kushtohet veprimtarisë së akademive të të rinjve.

Marrëdhëniet me shkencëtarët shqiptarë po forcohen

- Njoftim i Akademisë së Shkencave të Lituanisë për veprimtarinë e përbashkët "Përparimi i teknologjive të reja dhe seleksionimi i bimësisë në serra dhe kopshtari"

Në vitin 2023, më 26 shtator, u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi midis Akademisë së Shkencave të Lituanisë dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Pak kohë më parë, më 26 shkurt, Instituti i Hortikulturës i Qendrës Bujqësore dhe Pylltarisë i Lituanisë (AMMC) organizoi një seminar me temë "Përparimi i teknologjive të reja dhe seleksionimi i bimëve mjekësore në kopshtari".



Në këtë veprimtari z. Alban Ibraliu, pjesëmarrës nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, profesor në Universitetin Bujqësor të Tiranës, prezantoi në mënyrë të detajuar situatën bujqësore në Shqipëri, duke theksuar rëndësinë e kultivimit të bimëve medicinale.

Shqipëria është një nga prodhuesit më të mëdhenj në botë të sherebelës, trëndafilin të egër dhe bimëve të tjera mjekësore dhe aromatike. Eksporti vjetor i saj në terma monetarë është 50-60 milionë euro. Kjo favorizohet nga pozicioni gjeografik i vendit, terreni, larmia e bimësisë lokale dhe bollëku i saj.

I ftuari prezantoi teknologjitë e rritjes dhe të përpunimit parësor të zarzavateve, diskutoi për llojshmërinë e tyre dhe për drejtimit e përshtatjes, si dhe për përbërësit

organikë të bimësisë në mjedise të izoluar. Ai gjithashtu diskutoi për përzgjedhjen në këtë bimësi në Shqipëri dhe për rëndësinë që ka bimësia mjekësore shqiptare për Lituaninë dhe për eksportet në përgjithësi.



Dr. Danguolė Juškevič paraqiti koleksionet e kopshtarëve lituanezë dhe arritjet e mbarështuesve të tyre. Dr. Akvilė Viršilė prezantoi problemet dhe sfidat e hulumtimit shkencor për arritjen e rezultateve të synuara me ndihmën e kontrollit të saktë gjatë përzgjedhjes në hortikulturë. U dëshmuua se serrat e nivelit më të lartë teknologjik dhe bujqësia vertikale bëjnë të mundur kontrollin studimor të proceseve fiziologjike dhe metabolike të bimëve duke ndryshuar metodën e kultivimit.

Metodat e gjenotipizimit dhe riprodhimit janë studiuar për vetitë morfologjike dhe biokimike të ekzosomeve dhe aplikimet e tyre në kozmetikë dhe farmaceutikë, si dhe për sintezën e një spektri të gjerë metabolitësh dytësorë në bimët e kultivuara dhe të egra.

Dr. Birutė Frercks tërhoqi vëmendjen ndaj eksperimentimeve të ndryshme për përzgjedhjen në këto fusha.

Më pas, të ftuarit u njohën me punimet laboratorike dhe infrastrukturën e fiziologjisë së bimëve, gjenetikës dhe bioteknologjisë së plantacioneve të tyre, veçmas të Institutit të Biokimisë dhe Teknologjisë së Hortikulturës.

Akad. Vidmantas Stanys
Seksioni i shkencave bujqësore e pyjore

Qendra e Botimeve Enciklopedike e Albanologjike (QBEA) dhe Qendra për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor (QKPISH) - dy njësi të reja të përhershme pranë Akademisë së Shkencave

- Takime të Kryetarit të ASHSH akad. Skënder Gjinushi me drejtuesit dhe punonjësit e dy qendrave



Në bashkëbisedimin me QBEA kryetari Gjinushi theksoi se me statusin e ri të saj si njësi e përhershme roli dhe përgjegjësitë janë shtuar. Tashmë QBEA ka jo vetëm rol koordinues e burokratik-administrativ, por dhe është pjesëmarrës në procesin e realizimit shkencor të projekteve. Ky rol do të vazhdojë me mirëmbajtjen dhe përditësimin e bazës së të dhënave; me propozimet për nisma e ide të reja. Së shpejti dy sektorët e QBEA do të kenë përgjegjësitë e tyre, specialistë nga më të zotët. Një mjedis të posaçëm do të kenë redaksitë dhe bashkëpunëtorët e tyre jo vetëm për takime pune, por dhe për komunikim me programet dhe me bazën e të dhënave.

Drejtori i QBEA-së prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi informoi se qendra tani ka personel të plotë dhe mjedise pune të përshtatshme. Sa u takon projekteve shkencore, dy vëllimet e para të "Historisë së shqiptarëve" janë në proces redaktimi. Një problem në proces është njësimi i sistemit të referencave, që do të bëhet nga redaktorët e qendrës. Lënda e "Fjalorit të madh të shqipes" është depozituar në server dhe ka filluar redaktimi.

Janë krijuar kushte që, sipas rastit, për ndërhyrje të fundme në tekst, të punojnë autorët vetë, të asistuar nga redaktorët ose thjesht duke dorëzuar tekstin të shtypur me ndreqjet. Një bazë të dhënash është krijuar edhe për "Enciklopedinë shqiptare". Gjithashtu është përshtatur programi standard për shtypjen digjitale të artikujve të saj.



Nga të pranishmit u kërkua që, në bashkëpunim me bibliotekën shkencore të ASHSH, të krijohet këndi i botimeve enciklopedike që ndihmojnë punën, me disa modele, si "Encyclopedia Britannica", enciklopedia italiane "Treccani"; si dhe me enciklopedi të popujve të ngjashëm me shqiptarët në madhësi e histori, enciklopedi krahinore e tematike, fjalorë terminologjikë, leksikonë të profesioneve etj. Kryetari Gjinushi konfirmoi se këto kërkesa, pasi të qartësohen, do të mbështeten e realizohen.

Në takimin me drejtues e punonjës të QPKISH akad. Gjinushi u informua nga përgjegjësjë e qendrës dr. Mirlona Buzo për ndryshimet në strukturë, personel dhe mjedise pune të saj pas nënshkrimit të marrëveshjes me IZUM-in (Slloveni), mbi bazën e së cilës ajo ngrihet në shkallën e një qendre rajonale koordinuese për informacionin shkencor dhe për administrimin e programit Cobiss.al të katalogimit të librit shkencor.

Roli i QPKISH është rritur shumë jo vetëm ndaj bibliotekave universitare, por ndaj jetës shkencore në përgjithësi. Së shpejti një rrjet kompjuterash do të jetë i instaluar në rrjet dhe do të ofrojë akses të lirë për bazat e të dhënave Cobiss.al, Ecris.al dhe Unpayall. Vendosja e një terminali të vogël në sallën e komunikimit do të lehtësojë edhe më shumë kërkimin.

Me bashkimin e instituteve të albanologjisë me ASHSH, bibliotekat shkencore të tyre duhet t'i katalogojnë fondet e tyre sipas programit Cobiss.al, para së gjithash sepse

skedimi i deritashëm është pa mundësi shfrytëzimi, i pakonvertueshëm dhe me pasaktësi. Është e nevojshme që regjistrimi në Cobiss të jetë me dy ndarje: biblioteka shkencore e ASHSH më vete dhe bibliotekat e instituteve të albanologjisë në një nëndarje tjetër. Rreth 80 për qind e fondit libror të ASHSH është i kataloguar. Shërbimi online për revistat ka mundësuar komunikimin e tyre me baza të dhënash europiane.



Akad. Gjinushi theksoi se dy qendrat dhe bibliotekat duhet të bashkëpunojnë, të paraqesin projekte të përbashkëta. Një projekt i përbashkët duhet të përgatitet për arkivat e trashëgimisë, gjendjen e burimeve, arkivat e pashfrytëzuara etj. Përfshirja edhe më tej e bibliotekave universitare në programin Cobiss kërkon nënshkrimin e një protokollit me universitetet mbi bazën e marrëveshjeve që kemi. Puna e njësisë duhet të bëhet më e dukshme, me tregues sasiorë të qartë. Sot është më problem shfrytëzimi i informacionit, se disponimi i tij në baza të dhënash. Prandaj duhen hartuar manuale praktike për të lehtësuar teknikisht marrjen e shërbimit. Për të shpejtuar punën me katalogimin dhe procese të tjera digjitalizuese mund të merren edhe forca ndihmëse me kontratë. Synimi është që brenda dy vjetëve kjo fazë të ketë përfunduar dhe të kalohet nga përshkrimet bibliografike në shërbim me botime të plota digjitale.

U mbledh Komisioni i fizikë – kimisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

- Mbledhja u mbajt për të diskutuar rreth synimeve themelore të vitit (2024) të fazës së dytë të reformës (2024-2027), si dhe programin shkencor dhe objektivat e njësisë “Pasuritë ujore”

Sot më 11 mars 2024, u mbledh Komisioni i fizikë - kimisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Mbledhja u drejtua nga akad. emeritus Florian Vila, Kryetar i këtij komisioni.



Në mbledhje morën pjesë akad. emeritus Dhimitër Haxhimihali, prof. dr. Elida Bylyku, prof. dr. Partizan Malkaj, akad. Besnik Baraj, akad. Rexhep Mejdani, akad. Ilirjan Malollari, prof. dr. Rozana Troja, prof. dr. Mimoza Hafizi, prof. dr. Elda Marku, prof. dr. Fatos Ylli, dr. Shaniko Allajbeu.

Mbledhja u mbajt për të diskutuar rreth synimeve themelore të vitit (2024) të fazës së dytë të reformës (2024-2027), si dhe programin shkencor dhe objektivat e njësisë “Pasuritë ujore”.

Mbledhjen e hap Kryetari i Komisionit fizikë –kimi, akad. emeritus Florian Vila, i cili vuri në dukje se ky është viti i parë që shënon fillimin e fazës së dytë të reformës, që

përfshin periudhën (2024-2027). Kjo reformë përcaktoi synimet themelore që kanë të bëjnë me komisionet dhe njësitë e kërkim studimit afatshkurtra, si dhe institutet virtuale, meqenëse me këto ka lidhje komisioni i fizikës dhe kimisë. Komisioni duhet të forcojë më shumë rolin e tij si dhe funksionimin, duke ripërtërirë përbërjen e tij në bazë të shkallës së aktivizimit të anëtarëve të tij, duke parë dhe mundësinë e një përfaqësimi sa më të mirë nga institucionet e tjera, sidomos duke pasur programe më të qarta pune në nivel komisioni (duke orientuar punën dhe në drejtimet e reja që mund të kenë anëtarët e rinj dhe duke respektuar karakterin e tyre kolegial.

Akad. emeritus Floran Vila tha se komisionet janë struktura që mundësojnë drejtpërsëdrejti bashkëpunimin midis anëtarëve të Asamblesë e të seksioneve me ata të njëjsteve, si dhe njësiteve e shkollave të larta, bashkëpunim që është i domosdoshëm për organizimin e programeve të ciklit të dytë dhe të tretë. Komisioni shërben dhe si këshill shkencor. Aktualisht janë 14 anëtarë të komisionit, ku 7 prej tyre janë anëtarë të Asamblesë.



Do ishte me vlerë, - theksoi akad. Vila, - që të kishim dhe anëtarë që kanë lidhje me tema të tilla si: klima, atmosfera dhe mjedisi.

Akad. Vila tha se do të forcohet bashkëpunimi i Asamblesë dhe Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike në ASHSH me njësitë.

Realizimi i kësaj lidhje është themelore, ku komisioni bën opinionen dhe raporte

për Kryesinë nën drejtimin e Kryetarit të ASHSH akad. Skënder Gjinushit dhe Seksionin e Shkencave Natyrore dhe Teknike. Gjithashtu, do të forcohet edhe bashkëpunimi njësi-shkolla të larta, ku si fokus kryesor është organizimi i programeve të ciklit të dytë dhe tretë.

Pika e dytë e mbledhjes u mbajt për njësinë "Pasuritë Ujore", ku u prezantua mënyra e funksionimit, programi shkencor i saj, anëtarët e saj.

Akad. Besnik Baraj foli për koordinimin dhe bashkërendimin e punës ndërmjet grupeve kërkimore shkencore ekzistuese të studiuesve të disiplinave të ndryshme, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve brenda secilës disiplinë dhe forcimin e punës ndërdisiplinore, me synim zgjidhjen e problemeve në sektorin e ujërave.

Diskutimi u bë në bazë të rezultateve të raportit për rolin e kërkimit shkencor në përballimin e sfidave të sektorit të ujërave në Shqipëri.

Në fund të fjalës së tij, akad. Bare tha se hapësirat për koordinimin dhe bashkëpunimin janë, por problemi qëndron tek mungesa e standardeve kombëtare, për t'iu përgjigjur kërkesave të direktivës kuadër të ujit. Është bërë një punë e lavdërueshme për adoptimin e legjislacionit europian në fushën e ujërave, por ka akoma shumë për të bërë për implementimin e tij, si dhe për hartimin e standardeve kombëtare me format ligjor.

Pas diskutimeve, mbledhja u mbyll me përcaktimin e temave më të rëndësishme që do trajtohen në mbledhjet e tjera të këtij viti.

Redaksitë e historisë (të shek. XX dhe të historisë ushtarake), redaksia për religjionet dhe redaksia e arkeologjisë vlerësojnë përgatitjet e deritashme për "Enciklopedinë shqiptare"

- Akad. Adem Bunguri, anëtar i redaksisë vendore të ESH, drejtues i bashkëbisedimit si koordinator përgjegjës për këtë grup-fushë redaksish

- Njoftuan për rezultatet dhe problemet akad. Beqir Meta (drejtues i redaksisë së historisë bashkëkohore); prof. asoc. dr. Albert Nikolla (drejtues i redaksisë për religjionet); prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi (drejtues i redaksisë së historisë ushtarake); akad. asoc. Gëzim Hoxha (drejtues i redaksisë së arkeologjisë)



Të katra këto redaksi janë në përfundim të fjalësit paraprak të fushës. Rezulton se, veç fjalëve-referencë që gjenden në FESH dhe në FEK, janë evidencuar një shumicë personalitetesh e ngjarjesh që nuk janë përfshirë në asnjë botim enciklopedik të deritashëm. Në këtë fazë, leksikonët e fushës përmbajnë më shumë njësi se sa mund të parashihej. Por, pas 31 marsit, nis një fazë e re, ajo e zgjedhjes dhe përzgjedhjes sipas vlerës përfaqësuese.

U rekomandua që tani për tani e rëndësishme është të mos harrohen vlerat e trashëgimisë shqiptare, veçmas ato që i ka lënë jashtë dukuria e përjashtimit. Seleksionimi do të bëhet me një disiplinë të përbashkët, me të njëjtat kritere e hierarki. Një nismë kaq e rëndësishme si "Enciklopedia shqiptare", që do të angazhojë qindra studiues, pa disiplinën shkencore nuk mund të realizohet.

Periodha prill-qershor, u theksua gjatë takimit, do të jetë e mjaftueshme për përzgjedhjen, për diskutimet midis redaksive për përkatësinë e artikujve në kufij të

objektit të tyre, për bashkautorësitë ndër-redaksionale, për dyfishimet e mundshme të artikujve me redaksitë gjegjëse në Kosovë dhe shmangien e tyre; për identifikimin e artikujve monografikë dhe propozimin e tyre redaksive vendore e asaj qendrore.



Shqetësim për këtë fazë është shumësia e personaliteteve dhe presionet që veprojnë për shkak të barazisë formale të tyre në funksion, titull, detyrë etj. Për të zgjidhur këtë problem do të bëhen krahasime dhe kërkim për gjetje burimesh referenciale. Ky problem u parashtrua pak ditë më parë edhe nga redaksia e mjekësisë, e cila po mendon që raporti ngjarje-personalitate të ruhet duke i përfshirë këta të fundit në artikujt për institucionet, shërbimet, klinikat etj. Një zgjidhje tjetër është grupimi i personaliteteve të ngjashëm në kohë e kontribute në zëra përmbledhës.

Drejtori i QBEA z. Marenglen Kasmi bëri të ditur se tashmë ka një bazë digjitale të dhënash për ESH. Drejtuesit e redaksive mund të autorizohen përmes fjalë-kalimeve për të hyrë lirisht në "tunelin" që të shpie tek të dhënat. Një manual praktik për përdorimin e kësaj baze dhe për punë të drejtpërdrejtë në memorien e projektit është gati dhe do të qarkullohet për redaksitë e fushave.

“Naum Prifti, mjeshtër i prozës së shkurtër”



Akademia e Shkencave e Shqipërisë mban një veprimtari të zgjeruar shkencore për jetën dhe veprën e shkrimtarit

- Akad. Gëzim Hoxha e vlerësoi Naum Priftin si mjeshtër të prozës së shkurtër dhe që përfaqëson një figurë shumëdimensionale të artit dhe letërsisë shqipe si novelist, tregimtar, dramaturg, skenarist, kritik letrar, fabulist, qëmtues i folklorit, shkrimtar i dashur i letërsisë për fëmijë dhe mjeshtër i shqipërimit.

- Prof. Ymer Çiraku e vlerësoi Naum Priftin si tregimtarin e kapërcimeve estetike zhanrore. Naum Prifti (1932-2023) mbetet tregimtari sui generis në letërsinë shqipe, jo vetëm për qëndrimin besnik të këtij zhanri letrar, por edhe se e përfaqësoi atë në nivele të larta.

- Akad. Shaban Sinani dhe prof. Tomor Plangarica e vlerësuan Naum Priftin si një personalitet që i përket letërsisë si institucion, me kontribute të shumanshme në trashëgiminë letrare të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar e më pas; mjeshtër i prozës së shkurtër; po aq i shquar në llojet e dramatikës, me vend të shënjuar për skenarë të filmit artistik, dokumentar e vizatimor; përkthyes a shqipëruer i disa kryeveprave të letërsisë botërore për fëmijë e të rinj; autor jetëshkrimesh, monografish dhe krijimesh didaktike; etj.

- Administratori i minibashkisë nr. 8, z. Erjon Xhafa u dorëzoi Julka dhe Rafaela Priftit, në emër të kryetarit të bashkisë, z. Erjon Veliaj, “Certifikatën e mirënjohjes” për shkrimtarin Naum Prifti.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike kanë mbajtur sot, më 12 mars 2024, konferencën shkencore "Naum Prifti, mjeshtër i prozës së shkurtër".



Morën pjesë Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, dhe anëtarë të Kryesisë së ASHSH-së, punonjësit kërkimorë-shkencorë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, të departamenteve të letërsisë në universitete, kineastë, miq të autorit, studiues e studentë.

Ishte i pranishëm edhe administratori i bashkisë nr. 8, z. Erjon Xhafa.

Të pranishme ishin edhe vajzat e Naum Priftit, Julka dhe Rafaela.

Akad. Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike në Akademinë e Shkencave, çeli veprimtarinë dhe mbajti fjalën përshëndetëse.

Akad. Hoxha e vlerësoi Naum Priftin si mjeshtër të prozës së shkurtër dhe që përfaqëson një figurë shumëdimensionale të artit dhe letërsisë shqipe si novelist, tregimtar, dramaturg, skenarist, kritik letrar, fabulist, qëmtues i folklorit, shkrimtar i dashur i letërsisë për fëmijë dhe mjeshtër i shqipërimit.

Akad. Hoxha përmendi disa nga veprat e shkrimtarit Naum Prifti dhe më pas foli edhe për dashurinë e Naum Priftit për fjalën shqipe, që mund të vërehet më së miri edhe në përkthimet mjeshtërore të dy veprave poetike të Roald Dahl-it "Gjiganti i madh i

mirë”, (1990), dhe “Çarli dhe ashensori i madh prej xhami” (2018). Nga frëngjishtja, ai ka përkthyer “Princin e vogël” të Exupéry-së, kurse nga gjuha italiane ka përkthyer vëllimin me përralla “Katër stinët”.



Akad. Hoxha kujtoi më tej edhe kontributin në letërsinë për fëmijë. Duke e mbyllur fjalën e tij me një profil shumëdimensional të shkrimtarit Naum Prifti, ai theksoi, ndër të tjera, se me tërësinë e veprës së tij Naum Prifti e konfirmoi veten si një ndër vazhduesit më besnikë të traditës së rrëfimit, të krijuar në Shqipërinë Juglindore me përfaqësues të tillë si Milto Guri, Sotir Andoni etj.

Kjo traditë rrëfimi shumë e koncentruar, e realizuar me cilësi shumë të lartë në veprat e tij, ka çuar në vlerësimin objektiv të Naum Priftit nga kritika letrare, si prijësi i shkrimtarëve shqiptarë në gjininë e prozës së shkurtër, me mesazhe të ngjeshura dhe shumë domethënëse. –tha akad. Hoxha.

Akad Hoxha ia dha fjalën prof. Ymer Çirakut.

Prof. Çiraku e vlerësoi Naum Priftin si tregimtarin e kapërcimeve estetike zhanrore. Ai theksoi se Naum Prifti (1932-2023) mbetet tregimtari sui generis në letërsinë shqipe, jo vetëm për qëndrimin besnik ndaj këtij zhanri letrar, por edhe se e përfaqësoi atë në nivele të larta.

Prof. Çiraku e vlerësoi shkrimtarin për një regjistër ligjërimi të veçantë, origjinal, në letërsinë shqipe, duke e radhitur përkrah tregimtarëve të suksesshëm të kohës si Mitrush Kuteli, Dhimitër S. Shuteriqi, Sotir Andoni, Jakov Xoxa, Vath Koreshi, Teodor Laço, Faik Ballanca etj.

Më tej, prof. Çiraku bëri një analizë estetike të tregimeve dhe të galerisë së personazheve në krijimtarinë letrare të Naum Priftit. Ai i vlerësoi tregimet për intensitet

të dukshëm nga aspekti rrëfimtar, si dhe për galerinë e pasur të personazheve me karaktere të përkundërt e shfaqje të befta.

“Tejkalimi” estetik i kufijve të poetikave të zhanreve, është një nga tiparet e dallueshme të këtij tregimtari, - tha prof. Çiraku.



Prof. Çiraku e vlerësoi Naum Priftin edhe për intensitetin emocional, ritmin e brendshëm të rrëfimit, si dhe për teknikat e shtjellimit kompozicional në nivel të sigurt intuitiv, për dialogun ekspresiv dhe dukshëm të pranishëm, veçori që tërhoqën vëmendjen e regjisorëve kineastë apo atyre të teatrit, si te filmat “Pylli i lirisë” dhe “Tokë e përgjakur”, që janë mbështetur në tregimet mjaft të njohura si “Ndjekësi i kuajve”, “Litar i zjarrtë” apo edhe skenarët e filmave të tjerë si: “Kush vdes në këmbë”, “Fejesa e Blertës”, “Pika e ujit” (film vizatimor), të mbështetura po në tregimet e këtij autori dhe ku ai shpesh është dhe bashkëskenarist.

Prof. Çiraku bëri një analizë të mëtejshme për vëllimin “Tregime të zgjedhura”, botuar më 1972 (botimet “Naim Frashëri”).

Për vlerat artistike që ka përcjellë, proza tregimtare e N. Priftit ka tërhequr jo pak vëmendjen e kritikës letrare, duke përfshirë edhe atë që lëvrohej në Kosovë, – theksoi prof. Çiraku. Ai kujtoi se kanë shkruar mes të tjerëve për të, kritikë e studiuës të njohur si Rexhep Qosja (te libri “Kritika letrare”, 1969), Hasan Mekuli (rev. “Jeta e re”, 1967), Mensur Raifi (gaz. “Rilindja”, 1972), Rifat Ismaili (gaz. “Fjala”, 1980) etj.

Prof. Çiraku tha se shkrimtari nuk reshti së krijuari e së angazhuari plot përkushtim me veprimtari letrare e atdhetare, edhe në periudhën e dekadave të fundit, kur ai u vendos që të jetojë familjarisht në SHBA, ku qëndroi deri sa u nda nga jeta, këtu e një vit më parë.

Akad. Shaban Sinani, sekretar shkencor në Akademinë Shkencave, paraqiti një kumtesë të përgatitur së bashku me prof. Tomor Plangaricën, “Memuaristika dhe eseistika, si dy profile të vlerata të shkrimësisë së Naum Priftit”.



Një personalitet si Naum Prifti i përket letërsisë si institucion, me kontribute të shumanshme në trashëgiminë letrare të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar e më pas: prozator në shumicën e llojeve e nënlojeve letrare, por veçmas mjeshtër i prozës së shkurtër; me 16 vëllime me tregime e 40 të tjera me novela e përralla; po aq i shquar në llojet e dramatikës, me 15 drama, komedi e dramatizime; me vend të shënuar për skenarë të filmit artistik, dokumentar e vizatimor (jo pak, por 12 skenarë të tillë); përkthyes a shqipëruës i disa kryeveprave të letërsisë botërore për fëmijë e të rinj; autor jetëshkrimesh, monografish dhe krijimesh didaktike; me disa vepra të përkthyer në gjuhët anglisht, frëngjisht, rusisht, italisht, gjermanisht, arabisht, bullgarisht, greqisht; zë vend natyrshëm në hapësirat qendrore të saj, -tha akad. Sinani.

Përmes kumtesës së akad. Sinanit dhe prof. Plangaricës u paraqit angazhimi në publicistikë, eseistikë e memuaristikë i Naum Priftit, angazhim i nxitur fillimisht si plotësim i kërkesave të përditshmërisë e më pas bëhet pjesë e përmbushjes së misionit që shkrimtari duhet të luajë në shoqëri. Kjo trashëgimi është një anë e panjohur ose jo aq e

përmendur e Naum Priftit si krijues. Ajo është produkt kulturor i përftuar kryesisht përgjatë viteve të para nëntëdhjetës; që mbeti i pabotuar, sepse ishte jashtë konteksteve kufizuese ideologjike të asaj periudhe; një produkt i përftuar me pengun e pamundësisë së botimit, por njëherazi me entuziazmin e përmbushjes së misionit të intelektualit.

Kjo pjesë e krijimtarisë që shkrimtari e heshti në raftet doli nga dhuntia krijuese e tij kur shkrimtari po vetëdijësohej që “duhej t’u ngjante sivëllezërve të tij të vetzgjedhur në institucionin letrar”; të ishte i denjë për familjen që mëtonte t’i përkiste. Dhe dihet tashmë se në atë institucion letrar ekzistojnë edhe disa “familje të padukshme”, që luajnë rol në skakierën letrare, “pa pasur nevojën e formësimit të një grupi të shpallur”; sepse çdo shkrimtar bën pjesë “në një familje të parazgjedhur prej tij”, të shkrimtarëve të së shkuarës a bashkëkohës, me njohje vetjake ose jo, që ai “i vendos në panteonin vetjak”, sepse me ta “e bashkon mënyra e jetës” dhe veprat i mundësojnë atij “të legjitimojë vetë procesin e tij të të thënit”, - tha akad Sinani.

Akad. Sinani e prof. Plangarica u ndalën te vitet 1970-1980, kur Naum Prifti udhëton e shkruan pa fund për mbresat e atyre udhëtimeve.

Asaj periudhe i përket vëllimi me ese e recensione “Teatri në kohën e krizës”; mbresat e udhëtimit, esetë dhe reportazhet e vëllimit me titullin simbolik “Midis dy kohësh” dhe një sërë tregimesh të tjera jashtë disiplinës ideologjike.

Shënimet e udhëtimit, esetë a portretet, mbetur sirtarëve të Naum Priftit, patën fatin ta dëshmojnë atë “kohë të parë” në një “kohë të dytë” që erdhi shumë më shpejt, madje qysh në gjallje të autorit. Vepra e tij “Midis dy kohësh” doli në dritë në vitin 2005, ndërsa autori vetë mund t’i këqyrte me entuziazëm të botuara ato krijesa të tij, madje t’u shtonte të tjera, simotra të tyre “në një kohë të dytë”, dhe ta emëronte edhe vetë vëllimin me titullin simbolik “Midis dy kohësh”, - tha akad. Sinani.

Eseistika e memuaristika e Naum Priftit, që për fat të keq pak e pranishme në tavolinën e punës së studiuesve të tanishëm, bart vlera të veçanta në disa drejtime:

- Janë dëshmi pa filtra ideologjikë të një mentaliteti që bart veçantitë e epokës, por edhe të vendeve e shtresave të caktuara sociale;

- Janë dëshmi të sektorëve të caktuar të jetës, jo shumë të vëzhguar nga brenda, siç është institucioni letrar;

- Janë dëshmi të një pasurie të dhënash që vijnë nga përballja vetjake e individit a qenies biografike, si dhe e shkrimtarit; por, më së shumti, edhe e përvojave të sivëllezërve të tij;

- Janë dëshmi të procesit shqyrtues të vlerave letrare e kulturore, që i qëndrojnë trysnisë për mpakje në periudha diktature, -tha akad. Sinani.

Akad. Sinani dhe prof. Plangarica kanë vlerësuar në kumtesën e tyre edhe përdorimet e dialekteve e të folmeve të caktuara në veprën e Naum Priftit.

Znj. Eleni Karamitri mbajti një kumtesë, ku spikati modernitetin e veprës së Naum

Priftit.



Ajo vuri në dukje se letërsia e Naum Priftit vjen moderne edhe në kohën e sotme, novatore dhe e pandashme nga letërsia bashkëkohore shqiptare dhe ajo e diasporës.

Më tej, znj. Karamitri foli për shpirtin e madh dhe mendjen e kthjellët të Naum Priftit, i cili dha kontribute deri në fund të jetës.

Edhe jetën në emigrim e kaloi në gjirin e komunitetit shqiptar të Amerikës, ku punoi si sekretar i shoqërisë patriotike “Vatra” dhe kryeredaktor i gazetës “Dielli”. Naum Prifti si shkrimtar bën një epokë të historisë moderne intelektualisht dhe estetikisht, – tha znj.Karamitri.

Dr. Kastriot Gjika përgëzoi Akademinë e Shkencave dhe kryesinë e saj për rivlerësimin e shkrimtarit, dramaturgut dhe kineastit Naum Prifti.

Ai u ndal te kontributet në letërsinë për fëmijë, të cilat sipas tij janë të nënçmuara.

Naum Prifti është angazhuar në disa zhanre të letërsisë për fëmijë, - tha Gjika, - dhe e vlerësoi shkrimtarin si një zë origjinal, mjeshtër të prozës shqipe. Dr. Gjika kujtoi veprën “Legjenda dhe rrëfime për Skënderbeun” dhe “Erë mali, erë fushe”, ku ndër cilësitë mjeshtërore të rrëfimit përmendi rrëfimin në vetën e parë dhe zgjerimin e tematikës së tregimeve të lidhura me problemet e zhvillimit psikologjik të moshës fëmimore.

Ai vuri në dukje se novelat si “Cikoja dhe Beni” e tregime të tjera që lidheshin me Luftën Nacionalçlirimtare janë shprehje e mjeshtërisë së rrëfimit, ku më shumë se tema lë gjurmë niveli artistik.

Në përrallat për fëmijë, ai e quajti Naum Priftin ideator të krijimit të përrallave të

kultivuara me karakter njohës dhe shkencor, si vëllimi “Përralla për një muaj”, “Pika e ujit”, që u bë film i animuar, por edhe “19 rrëfime për Skënderbeun”.

Dr. Gjika tha se kontributi në letërsisë për fëmijë i Naum Priftit zgjerohet edhe me përkthimin e disa kryeveprave të letërsisë botërore për fëmijë.

Znj. Ermira Alija paraqiti një këndvështrim të veçantë të veprës në fokusin e perceptimit të lëvizjeve dhe veprimeve në veprën e Naum Priftit, ku sintetizohen raportet psikologjike me ato emocionale, të cilat e rrisin intensitetin e tërheqjes së vëmendjes së lexuesit në shkrimet e tij.

Dr. Anxhela Çikopano mbajti kumtesën “Naum Prifti: Teatri në kohën e krizës”, të cilën e prezantoi me materiale dhe foto ilustruese nga arkivat.



Dr. Çikopano vuri në dukje se Naum Prifti në librin “Teatri në kohën e krizës” shpreh shqetësimin për zhbërjen nga të rinjtë të letërsisë së realizmit socialist, ose siç e quante ndryshe ai, të mungesës së realizmit kritik ose të realizmit afermativ. Por, nëse ka një autor puna e të cilit nuk mund të zhbëhet, tha Çikopano, edhe pse cilësohet si i autor i brezit të realizimit socialist, është pikërisht zoti Prifti. Dramaturgjia e tij është e pakohë, me vepra që mund të vihen edhe sot në skenë, gjë që nuk haset shpesh mes veprave të asaj kohe, qoftë edhe të ndaluara.

Ajo kujtoi pjesën e parë dramaturgjike “Rrethimi i bardhë”, me të cilën u çel teatri i Elbasanit, po vetë autori sado entuziast që ishte, kur e pa veprën e tij të parë të mishërohej nga aktorët në provat e tavolinës, na tregon se premiera e saj nuk e kishte ngrohur, pasi temporitmi që i ulët dhe kërkonte shumë kohë ndërrimi i skenave.

Më tej ajo kujtoi se si shfaqja e Korçës do të sillte fatin e keq të dramës, pasi drejtuesit e partisë së qytetit do t'ia sugjeronin me entuziazëm Enver Hoxhës që gjendej aty për punë të tjera, i cili nuk e pëlqeu shfaqjen dhe e mori si kritikë për partinë e qeverinë, ndaj pas një jave ajo u ndalua. Ndërkohë, regjisori dhe pedagogu Kujtim Spahivogli e kishte zgjedhur si punë diplome me studentët e tij dhe nuk mund të mos shfaqej. Shfaqja u bë me dyer të mbyllura në Teatrin Kombëtar, ku ishte e pranishme dhe Nexhmije Hoxha. Drama u cilësua si “shtrembëruese e realitetit”.

Më pas dr. Çikopano foli për dy këndvështrimet, si ishte parë nga censura e kohës dhe si perceptohet sot si vepër dramaturgjike, si “Dasmë pa nuse”, e shkruar në vitin 1969, e ngjitur në skenë me regji të Drita Agollit e Miho Gjinit, etj.

Duke iu referuar veprës “Teatri në kohën e Krizës”, dr. Çikopano theksoi se: Me një stil narrativ plot detaje e të rrjedhshëm, librin duhet ta lexosh disa herë për të rrokur gjithë informacionin e sjellë nga autori, që është jo vetëm material teknik për teatrin, por edhe copëza nga jeta e nga marrëdhëniet me të, nga prapaskenat ku armiqtë e ku të ngrohta të komunitetit teatror, pa pasur nevojë që ne t'i imagjinojmë, se vijnë me zërin e një njeriu që i ka jetuar në vetën e parë. Sikur të kishim pasur më shumë zëra të tillë, do të kishim panorama më të qarta mbi atë që ndodhte në teatrin e asaj kohe, përtej fasadës e idhujtarisë që ushqehet shpesh. Për mua si studiuese, “Teatri në kohën e krizës” është një libër i rrallë, në mes të një morie narrativash të ngjashme, që i duhet dhënë vlera dhe zëri që i takon.

Prof. dr. Evalda Paci mbajti kumtesën “Receptimi në dy kohë i një autori të letërsisë për fëmijë”, ku trajtoi çështjen e imazheve e përfytyrimeve rreth një habitati që autori i letërsisë për fëmijë Naum Prifti e kishte përndarë në sa përskrime e rrëfime të disa dimensioneve.



Si autor i prozës së shkurtër, Naum Prifti ka transmetuar në gjallërinë përkatëse përvoja të një veçanësie të rrallë, të rezervuar nga vetë përjetimet e tij, të risjella në vite në botime e ribotime, fakt që ka pasuruar së tepërmi bibliotekën e letërsisë për fëmijë e të rinj, - tha prof. dr. Paci.

Ajo e vlerësoi Naum Priftin si një autor që i kushtohet letërsisë për fëmijë, që bëhet vetiu transmetuesi i një bote të veçantë për lexues të një moshe gjithashtu të veçantë, të pajisur e të karakterizuar nga një kureshtje e natyrshme, gjithnjë me pikëpyetjet rreth çështjesh themelore që më tej do të përkthehen në të tjera sfida e dëshira për të ditur më shumë e më qartë.

Prof. dr. Paci theksoi më tej se Naum Prifti ka krijuar duke e pasuruar kësisoj vetë krijimtarinë e vet me misionin e ruajtësit të pasurisë gjuhësore, leksikore e letrare, të cilën ai duket se e njihte natyrshëm.

Gjuha do të jetë në të vërtetë një medium që autorit i shërben për të sjellë më afër profile njerëzore, ngjyra të stinëve që ai vetë i jeton me një ndjeshmëri të rrallë, elemente të një përditshmërie të dashur e të shkallëzuar ndër vite, asnjëherë të lënë pas dore në kujtesën e tij të fortë.

Emri i Naum Priftit, i pajisur si me dhuntinë e artit të të shkruarit, si me një kulturë që e brendëson që në fazat më të hershme të formimit të tij është pjesë e natyrshme e një historiku të përvijimit të letërsisë për fëmijë në gjuhën shqipe, me fillesa që në skica më të mëhershme në letërsinë e Rilindjes, por dhe me qasje të reja në çdo periudhë të zhvillimit të kulturës letrare dhe të kultivimit të leximit në gjuhën amtare, - tha prof. dr. Evalada Paci.

Në fund të veprimtarisë përshëndetën dy vajzat e shkrimtarit Julka dhe Rafaela, të cilat shprehën mirënjohjen dhe falënderuan veçanërisht Kryetarin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushin, akad. Shaban Sinanin dhe akad. Gëzim Hoxhën për organizimin e veprimtarisë.



Vajzat e shkrimtarit falënderuan përzemërsisht akademikët dhe studiuesit që mbajtën kumtesat.

Veprimtarinë e mbylli administratori i minibashkisë nr. 8, z. Erjon Xhafa, me një surprizë të veçantë. Ai iu dorëzoi Julka dhe Rafaela Priftit, në emër të Kryetarit të bashkisë, z. Erjon Veliaj, “Certifikatën e mirënjohjes” për shkrimtarin Naum Prifti.

Ringrihet Akademia e të Rinjve të Shqipërisë

E themeluar me një vendim të Kryesisë në vitin 2017, Akademia e të Rinjve të Shqipërisë u bë një faktor shumë i rëndësishëm hapjeje ndaj studiuesve të rinj dhe ndërlidhjeje mes brezash.

Anëtarët e saj bënë më të mirën për të promovuar një grupim studiuesish të shkencave humane e të sakta; për të rritur ndjeshmëritë dhe interesin për bashkëpunim me Akademinë e Shkencave; për të afruar bashkëpunëtorë me tregues cilësorë vlerësimi e indeksimi të punimeve të tyre. ASHSH, megjithëse në kushte të vështira në ato vite të fillimit, e vlerësoi si përparësi fuqizimin dhe afirmimin e brendshëm dhe të jashtëm të Akademisë së të Rinjve, e cila, me punën e saj, u bë anëtare e Global Young Academies dhe vendosi lidhje bashkëpunimi me ALLEA-n.



Po pse Akademia e të Rinjve të Shqipërisë po ringrihet? Së pari, sepse është detyrim ndaj Ligjit nr. 53/2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë" dhe ndaj Statutit të saj që të funksionojë sipas kornizës së re juridike. Në ligj dhe në statut ka parashikime detyruese si duhet të ndërtohet dhe funksionojë Akademia e të Rinjve.

Së dyti, sepse ALLEA ka miratuar një "Kartë të re themelore" si rregullatore njësuese e mënyrës së ngritjes dhe funksionimit të akademive të të rinjve, e cila, me disa përshtatje, është miratuar nga Asambleja e ASHSH si statut i saj.



Së treti, sepse, në respekt të kufirit moshor (deri në 40 vjeç), vetëm tre nga anëtarët themelues të Akademisë së të Rinjve mund të vazhdonin më tej anëtarësinë, duke mos pasur juridikisht mundësi për të marrë vendime.

Asambleja e ASHSH, pas miratimit të "Kartës themelore" dhe kthimit të saj në statut; shpalli kriteret për pranime të reja dhe ngriti komisionin e pranimeve, të kryesuar nga akad. asoc. Adrian Civici.

Pas më shumë se katër muajsh nga data e fillimit, konkursi u mbyll dhe komisioni i pranimit shqyrtoi dosjet e kandidatëve të regjistruar; bëri pikëzimin e meritave të tyre shkencore dhe renditjen; verifikoi përputhshmërinë me kriteret dhe, në mbledhjen e sotme, shpalli nëntë fitues, si dhe rikonfirmoi tre nga anëtarët e mëparshëm nën moshën 40 vjeç. Me përbërjen e re Akademia e të Rinjve ka quorum-in e nevojshëm për të funksionuar sipas ligjit e statutit.

ASHSH falënderon më së pari anëtarët e mëparshëm të Akademisë së të Rinjve, që udhëtuan bashkë me të në kohë të këqija e të mira. Sipas "Kartës themelore", ata janë edhe më tej "alumni i ASHSH".

ASHSH falënderon gjithashtu gjithë kandidatët konkurrentë për pjesëmarrjen e denjë në garë dhe bën të ditur se në vitet e ardhshme do të ketë tjetër konkurs pranimesh të reja.

Përgëzime anëtarëve të rinj të Akademisë së të Rinjve, mirë se erdhët në bashkësinë shkencore të saj.

Shumë shpejt, më 8 prill, do të zhvillohet ceremonia e dorëzimit të diplomave dhe mbledhja e konstituimit të Akademisë së të Rinjve.

Vendimi për pranimet e reja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Komisioni i pranimit

Nr. 351/ prot

Tiranë, 12.3.2024

Vendim, datë 8.3.2024

Për pranimet e reja në Akademinë e të Rinjve

Në mbështetje të neneve 5, 20 dhe 25 (pikat 3 dhe 4) të Ligjit nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë* (i ndryshuar);

Në pajtim me nenin 46 të *Statutit të Akademisë së Shkencave* (i ndryshuar);

Në përputhje me pikat 3 dhe 4 të *Kartës themelore për akademitë e të rinjve* miratuar nga ALLEA;

Në zbatim të vendimeve të datës 16.11.2023 të Asamblesë së Akademisë së Shkencave *Për miratimin e Kartës themelore për Akademinë e të Rinjve të Shqipërisë* (VA nr. 63) e *Për shpalljen e konkursit për ringritjen e Akademisë së të Rinjve dhe për pranimet e reja sipas Ligjit e Statutit* (VA nr. 64);

Referuar vendimit të Asamblesë nr. 65 datë 16.11.2023 *Për komisionin për konkursin e pranimit të anëtarëve të rinj në Akademinë e të Rinjve*;

Komisioni i pranimeve të reja në Akademinë e të Rinjve të Shqipërisë, pasi shqyrtoi dosjet e kandidatëve të regjistruar dhe vlerësoi përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit,

Vendosi:

1. Të pranohen si anëtarë të rinj të Akademisë së të Rinjve kandidatët konkurrues Aulon Shabani (elektroteknikë), Erald Sino (financë), Joniada Barjaba (sociologji), Jonilda Llupa (kimi), Klaudio Peqini (fizikë),

Ledia Vasjari (biologji), Redion Luli (drejtësi), Resul Telaj (gjuhësi) dhe Romina Muka (informatikë).

2. T'i rekomandojë Kryesisë së Akademisë së Shkencave që kandidatët konkurrues me arritje shkencore cilësore, por jashtë kriterit moshor, të ftohen prej saj për bashkëpunim në kuadër të komisioneve të përhershme.


3. Anëtarët e mëparshëm të Akademisë së të Rinjve: Belfjore Qose (letërsi), Shaniko Allajbeu (kimi), Xhaklina Cani (kimi), që plotësojnë kriterin moshor sipas Kartës themelore, të rikonfirmohen.

Kryetar i komisionit të pranimit

Akad. asoc. Adrian Civici



Për herë të dytë shkrimtari Ismail Kadare, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nominohet për çmimin "International Booker Prize 2024"



- Në vitin 2005 Ismail Kadare ishte fitues i këtij çmimi, i njohur ndryshe si "Nobeli tjetër", me novelën "Ditë kafenesh"

- Sivjet nominimi bëhet për veprën "A Dictator Call", titulli në anglisht i veprës

"Kur sunduesit grinden", përkthyer nga John Hodgson -

- Njoftimi u bë nga vetë "The International Booker Prize". Në podcastin e tij është bërë paraqitja e parë informuese për këtë vepër, me tekstin vijues:



I. Kadare, "A Dictator call", A fascinating meditation on Soviet Russia, authoritarianism, power structures and a period of great writers, translated from Albanian by John Hodgson.

In June 1934, Joseph Stalin allegedly telephoned the famous novelist and poet Boris Pasternak to discuss the arrest of fellow Soviet poet Osip Mandelstam. In a fascinating combination of dreams and dossier facts, Ismail Kadare, winner of the inaugural International Booker Prize, reconstructs the three minutes they spoke and the aftershocks of this tense, mysterious moment in modern history. Weaving together the accounts of witnesses, reporters and writers such as Isaiah Berlin and Anna Akhmatova, Kadare tells a gripping story of power and political structures, of the relationship between writers and tyranny.

A Dictator Calls was longlisted for the International Booker Prize 2024, announced on March 11 2024.

Urimet më të përzemërta shkrimtarit Ismail Kadare, një rast i rrallë që propozohet dy herë për këtë çmim për "më të mëdhenjtë prej të mëdhenjve".

Redaksia e letërsisë dhe redaksia e gjuhësisë, me peshë në vëllim e në rëndësi për "Enciklopedinë shqiptare", takim e bashkëbisedim në përmbyllje të fazës së hartimit të fjalësit paraparak



Dr. Arian Leka, anëtar i redaksisë vendore, njëherësh koordinator përgjegjës i caktuar prej saj për dy redaksitë e afërta (redaksi të një grup-fushe) drejton këtë takim

Drejtuesit e dy redaksive, të gjuhësisë dhe të letërsisë, gjegjësisht prof. dr. Anila Omari dhe prof. asoc. dr. Evalda Paci, informuan se fjalësi paraparak për këto dy fusha është thuajse i përfunduar. Si bazë kanë shërbyer FESH dhe FEK, leksikonët e shkrimtarëve, botimet enciklopedike për gjuhëtarët dhe burime të tjera. Por shihet e nevojshme të blihen edhe tituj të tjerë, cilësorë në informacion e saktësi, si "Dizionario bio-bibliografico degli italo-albanesi" dhe botime të tjera. Si burim plotësues kanë shërbyer edhe regjistrat e emërtimeve të zgjedhura vite më parë në kuadër të një nisme për një enciklopedi albanologjike (E. Paci, A. Omari).

U shtrua problemi i përdorimit të pseudonimeve dhe hetetonimeve si informacion plotësues pa shtuar artificialisht artikujt (A. Leka, E. Paci) dhe u rekomandua që të këshillohen, përveç fjalorit të P. Dakës, edhe disa fjalorë të pabotuar, si ai i pseudonimeve të personaliteteve me fonde dokumentare në AQSH, fjalori i pseudonimeve të intelektualëve dhe veprimtarëve shqiptarë në INCOMKA (arkiv i Kominternit). Pseudonimet dhe heteronimet mund të jenë rubrikë shtesë në strukturën e artikullit për

personalitete shqiptare të gjysmës së parë të shek. XX, dukuri e rikthyer edhe në tri dekadat e fundme.



Problem më vete është ai i mënyrës së shkrimit të emrave të përveçëm, sipas autorit apo sipas shqiptimit (A. Omari); problem që ndërlikohet për shkak të dy përvojave: tradicionalja, sipas shqiptimit (Skiroi, Konica, Çekrezi) dhe prirjes së sotme, sipas një norme ende të pakonfirmuar (Schirò, Konitza, Chekrezi). Më i zgjidhshëm është problemi i emrave të të huajve me lidhje historike e kulturore me shqiptarët (fillimisht si në burim dhe midis kllapash sipas shqiptimit).



Përfshirja e përkthyesve të letërsisë shqipe në gjuhë të huaja dhe e përkthyesve nga letërsia botërore në shqip u vlerësua si pjesë e përgjegjësisë së redaksisë së letërsisë. Këtu do të kërkojnë vëmendje edhe letërsia dy- e shumëgjuhëshe (që nga De Rada deri tek Luan Starova) dhe autopërkthimi si specifikë e letërsisë shqipe.

Në mënyrë të veçantë kërkon vëmendje përfshirja me artikuj më vete ose përmbledhës e albanologëve të huaj, si fjalë-referencë në ESH; jo vetëm e klasikëve, por edhe e një breznie të re indoeuropeistësh-albanologë, që janë në rritje, për shkak të rritjes së rëndësisë së vetë shqipes (A. Omari).

Bota arbëreshe, me protagonistë të mendimit shqiptar në shek. XVIII (pararilindja), që nuk është e përfaqësuar plotësisht në FESH, për shkak të njohjes së kufizuar, për të fituar vendin që meriton, përveç anëtarëve të redaksisë dhe bashkëpunëtorëve nga "Njësia e kërkim-studimit për arbëreshët, arvanitët dhe arbneshët", kërkon edhe kontakte shtesë informimi në disa nivele.

Nga të dhënat e deritashme të redaksive, del se raporti midis emrave të përveçëm (të personaliteteve) dhe atyre të përgjithshëm (ngjarje, zhvillime, terma) është gati dy me një dhe ky raport duhet rregulluar duke grupuar individët me veprimtari të ngjashme në artikuj përmbledhës.

U rekomandua që, për të shfrytëzuar mundësitë e krijuara nga komunikimi në distancë përmes internetit, të shihet mundësia e një marrëveshjeje me ndonjë nga enciklopeditë shumëgjuhëshe online, që ofrojnë burime informuese dhe në të ardhmen mund të përdorin lëndën e ESH si bazë të dhënash; dmth mund të publikojnë si artikuj të konfirmuar zyrtarisht artikujt që do të botohen në ESH (A. Leka).

Tashmë dy redaksitë janë të gatshme të ofrojnë për kolegët e redaksive gjegjëse në Kosovë fjalësat paraprakë.

Prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi, drejtor i QBEA, theksoi se në këtë periudhë të shkurtër që ka mbetur deri më 31 mars përparësore është të verifikohet rishtas fjalësi i secilës redaksi, për të mos harruar asnjë njësi nga lënda enciklopedike e konsideruar me vlerë përfaqësimi. Përzgjedhja kritike i takon tremujorit tjetër e do të vazhdojë në proces.

Akad. Arben Merkoçi, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, pranohet anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave

Motivuar shkurt: "Në mbështetje të përsosmërisë në shkencë dhe teknologji"

"Jemi të entuziazmuar që kemi tashmë si pjesë të komunitetit tonë të nderuar prof. Merkoçin dhe presim me padurim kontributet e tij të vazhdueshme në avancimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit"

(Nga njoftimi i Akademisë Europiane të Shkencave - AESH)



Në vijim në njoftimin e AESH thuhet:

Arben Merkoçi, anëtar i EurASc në Divizionin e Shkencave të Materialeve, ka sjellë një pasurim të ekspertizës dhe përvojës në komunitetin tonë. Ai është profesor kërkimi i ICREA - "Institució Catalana de Recerca i Estudis Avançats" dhe drejton grupin e nanobioelektronikës dhe biosensorëve në "Institut Català de Nanociència" i nanoteknologjisë (ICN2).

Rrugëtimi i tij në karrierën akademike filloi me një doktoraturë për elektrodë selektive jonike në Universitetin e Tiranës, vijuar me formime të mëpasme përmes qëndrimeve kërkimore postdoktorale në institucione të njohura për ndikimin e tyre në dije: në Hungari, Greqi, Itali, Spanjë dhe SHBA.

Anëtar i shquar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, prof. Merkoçi është i njohur për punën e tij pioniere në fushën e biosensorëve dhe bioelektronikës. Ai është kryeredaktor i revistës së njohur "Biosensors and Bioelectronics", një revistë kryesore ndërkombëtare në këtë fushë dhe është pjesë e bordit editorial të revistave të tjera

prestigjioze, si “Electroanalysis dhe Microchimica Acta”.

Me një rekord mbresëlënës publikimesh shkencore, që përfshin 343 artikuj, si dhe mbikëqyrjen e 45 tezave të doktoratës, kontributet e akad. Merkoçit në nanoshkencë dhe nanoteknologji janë të njohura gjerësisht. Ai luan një rol vendimtar edhe si një vlerësues shkencor për agjenci të ndryshme ndërkombëtare dhe shpesh ftohet të ndajë njohuritë e tij në konferenca dhe seminare në mbarë botën. Për më tepër, prof. Merkoçi është bashkëthemelues i dy kompanive novatore "spin-off": “Graphenicalab s.l.”, e fokusuar në modelimin e grafenit, dhe “Paperdrop Diagnostics”, e dedikuar për diagnostikimin klinikë.

Jemi të entuziazmuar që kemi tashmë si pjesë e komunitetit tonë të nderuar prof. Merkoçin dhe presim me padurim kontributin e tij të vazhdueshëm në avancimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit!

Akademia e Shkencave e Shqipërisë uron për zemërsisht anëtarin e saj, mikun dhe kolegun Arben Merkoçi për këtë arritje cilësore vetjake.

Juria e çmimit të veçantë "Pilika" shpall kalendarin, kriteret dhe procedurat për zhvillimin e konkursit.

Mbledhja e jurisë u bë sot, më 15 mars 2024, me pjesëmarrje në linjë të gjithë anëtarëve të saj.



Në përfundim juria vendosi që kalendari për pjesëmarrjen në konkurs dhe zhvillimin e detyrave të jurisë (vlerësimi i plotësimit të kushteve teknike dhe të dokumenteve të nevojshme, kualifikimi, nominimi, shpallja e fituesve) të jetë:

1. Afati për të aplikuar deri më 15 prill 2024. Mund të aplikohet individualisht ose me iniciativë të njësisë bazë ku ushtron veprimtarinë kandidati.

2. Vlerësimi i përputhshmërisë me kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm, shpallja e listës së kandidatëve të kualifikuar dhe përzgjedhja e shpallja e të nominuarve nga juria të bëhet deri më 15 maj 2024;

Kërkesat për dokumentacion dhe procedura:

1. Kërkesë për pjesëmarrje nga aplikanti, nga njësia bazë e veprimtarisë së kandidatit ose nga dy profesorë të fushës së matematikës;

2. Disertacioni i doktoratës (versioni elektronik), sipas variantit të publikuar në faqen zyrtare të institucionit ku është mbrojtur, si dhe linku. Konkurruesi për çmimin për disertacionin më të mirë duhet të paraqesë edhe artikujt e botuar që lidhen me temën (në version elektronik dhe me separatet);

3. Konkurruesi për studimin më të mirë duhet të paraqesë edhe deri tre artikuj mbi të njëjtën temë (versionet elektronike dhe separatet);



Juria do të bëjë vlerësimin fillestar kualifikues dhe më tej gjatë gjithë procedurës me kritere të njësuara pikëzimi të vlerave që kërkohen nga një studim në konkurrim, që përfshijnë cilësinë shkencore, ndikimin në mjedisin shkencor, impaktin, citueshmërinë etj. Për impaktin juria do të mbështetet në të dhëna publike që raportohen në platformat ndërkombëtare dhe bazat e tyre të të dhënave: Scopus, Tempus, Web of Science, Research Gate, Google Scholar). Në pikëzim do të respektohet hierarkia e vetë këtyre platformave ndërkombëtare të indeksimit. Hollësira për pikëzimin do të jepen së afërmi.

Juria vendosi të vlerësojë se kanë përparësi punimet nga një autor i vetëm (aplikanti). Kur artikujt janë me disa bashkautorë, aplikant mund të jetë autori i parë ose të gjithë autorët së bashku.



Për shmangien e konfliktit të interesit juria vendosi:

1. Kur një aplikant është mentoruar nga një prej anëtarëve të jurisë (udhëheqje doktrate, drejtues projekti shkencor), anëtari i jurisë nuk merr pjesë në vlerësim e vendimmarrje për rastin. Në këtë rast vlerësimi i pikëzuar i aplikantit bëhet duke shumëzuar mesataren e pikëve të votuesve me numrin e plotë të anëtarëve të jurisë.

Juria u bën thirrje departamenteve të matematikës në universitete e institucione të tjera të arsimit të lartë e të kërkimit shkencor të bëhen nxitës dhe/ose nismëtarë të propozimit të kandidatëve me studime cilësore konkurruese.

Takim informues i dy redaksive të fushës së letërsisë (përkatësisht të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës), në kuadër të projektit madhor të "Enciklopedisë shqiptare"

Me pëlqimin e drejtuesve dhe anëtarëve të dy redaksive për letërsinë, ngritur në Tiranë e në Prishtinë, u zhvillua sot takimi i përbashkët informues për punën e deritashme.

Të pranishëm në mbledhje ishin drejtuesit e redaksive gjegjëse nga të dyja akademitë, anëtarët e redaksive dhe koordinatori i redaksive të fushave të gjuhësisë dhe të letërsisë, anëtar i redaksisë vendore të "Enciklopedisë shqiptare" dr. Arian Leka.

Në këtë mbledhje, në cilësinë e redaktores përgjegjëse për fushën e letërsisë, prof. asoc. dr. Evalda Paci informoi kolegët e redaksisë gjegjëse të Kosovës për ecurinë e punës gjatë muajve të fundit, duke filluar nga mbledhjet e mbajtura që nga themelimi i redaksisë së letërsisë dhe hapat vijues në lidhje me fjalësin e artikujve të kësaj fushe, bashkë me specifikime që kanë të bëjnë me autorë, rryma, periodikë letrarë e shkencorë, orientime kronologjike që më tej do të klasifikohen në të quajturit artikuj përmbledhës.



Anëtarë të redaksisë së fushës së letërsisë, prof. dr. Ymer Çiraku, prof. asoc. dr. Eldon Gjika, akad. asoc. Stefan Çapaliku morën fjalën duke u shprehur gjithashtu për çështjet e sipërpërmendura. Përfaqësuesi i redaksisë vendore dr. Arian Leka nënvizoi rëndësinë e bashkërendimit të punës së dy redaksive dhe vënien në dijeni hap pas hapi

të arritjeve të tyre në pikëpamje të konsolidimit të fjalësve dhe zërave përkatës.

Në këtë mbledhje u paraqitën nga të pranishmit aspekte të punës së deritanishme me fjalësin e letërsisë, duke nënvizuar prirjet dhe orientimet e mbajtura parasysh në proces të kësaj pune, bazat dhe burimet më të rëndësishme referenciale, përfshirë fjalorë, enciklopedi pararendëse, korpuse dhe leksikonë të tematikave të përfaqësuara në fushë të studimeve letrare dhe socioletrare.



Për redaksinë e Kosovës referuan përkatësisht akad. korresp. Nysret Krasniqi (drejtues i redaksisë së fushës së letërsisë), prof. dr. Muhamet Hamiti (anëtar i redaksisë së Kosovës për fushën e letërsisë), prof. dr. Lindita Tahiri (anëtare e redaksisë së Kosovës për fushën e letërsisë).



Prof. dr. Nysret Krasniqi bëri një analizë të zgjeruar mbi hapat e kryer deri më tashti në pikëpamje të qëmtimit të zërave më të rëndësishëm në fjalësin e letërsisë, bashkë me sqarimin e konsiderimit të madhësisë dhe vendit të zërave të veçantë në këtë të fundit. Në mbështetje të këtij informimi morën fjalën dhe kolegët Muhamet Hamiti dhe Lindita Tahiri, duke u shprehur në të njëjtën kohë dhe për mendimet e dhëna nga ana e redaksisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në këtë veprimtari të sotme u vlerësua fort jo vetëm mbajtja e këtij takimi, por dhe mundësia e mbledhjeve të afërta në prani të plotë fizike, duke u konsideruar dhe vlerësuar këto të fundit si mjaft të frytshme për bashkëndarje dhe diskutime mbi autorë, dukuri dhe periudha letrare.

Mbledhje e Redaksisë Qendrore të "Enciklopedisë shqiptare" në resortin "Lakeside" (Vërmicë, Prizren)



- Drejtuesit e dy redaksive vendore informojnë për veprimtarinë e tyre dhe të redaksive të ngritura sipas fushave për periudhën janar-mars

- Miratohen objektivat dhe detyrat kryesore për redaksitë e të tri shkallëve dhe kalendari i tyre: në përputhje me to dhe afatet për mbledhjet e redaksive

Nën drejtimin e akad. Skënder Gjinushit, kryeredaktor i "Enciklopedisë shqiptare", në resortin "Lakeside" (Vërmicë, Prizren) u zhvillua mbledhja e parë e Redaksisë Qendrore të "Enciklopedisë shqiptare" për këtë vit, me rend dite informimin e ndërsjellë për ecurinë e punës deri më tani; përcaktimin e detyrave në vijim për redaksitë e fushave; miratimin e një kalendari të sinkronizuar të punëve për vitin 2024 dhe koordinimin e takimeve në mes të redaksive të fushave.

Kryeredaktori Gjinushi, pasi falënderoi mikpritësit për kushtet e krijuara për këtë mbledhje dhe konfirmoi praninë e plotë të anëtarëve, ftoi zëvendëskryeredaktorin akad. M. Kraja të vijojë drejtimin e mbledhjes sipas rendit të ditës.

Akad. Kraja informoi për veprimtarinë e redaksisë vendore të Prishtinës që ai drejton dhe për ecurinë e punëve në redaksitë e fushave. Është e qartë për të gjithë, tha ai, duke përfshirë redaksitë e fushave, se çfarë duhet bërë këtë vit e më tej. Gjatë

periudhës tremujore është punuar nga secila prej tyre për përfundimin e fjalësit preliminar, që do të dorëzohet në afatin e parashikuar, deri me 31 mars.

U përshëndet fakti që shumë nga redaksitë e fushave me iniciativë kanë zhvilluar takime të përbashkëta, kanë këmbyer listat dhe po ndërveprojnë me vullnet pozitiv. Vështirësi ka pasur në përzgjedhjen e personaliteteve. Listat preliminare do të mbeten të hapura edhe më tej për raste të veçanta, u shpreh akad. Kraja.

Në vijim, në emër të redaksisë vendore të Tiranës akad. Shaban Sinani paraqiti një relacion me shkrim për të informuar RQ për ecurinë e veprimtarisë që nga mbledhja e fundme, për të propozuar fazat e punëve të pritshme për vitin 2024 dhe mbi këtë bazë për të miratuar kalendarin e detyrimeve dhe të mbledhjeve e takimeve ndër-redaksionale.



U theksua se zhvillim pozitiv është ndryshimi i statusit të Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike nga strukturë e përkohshme në strukturë të përhershme, me personel dhe mjedise të përshtatshme, një mbështetje e rëndësishme administrative dhe koordinuese për projektin e "Enciklopedisë shqiptare" dhe projekte të tjera.

Në fund të vitit të kaluar u mbyll faza e hartimit dhe miratimit të akteve-bazë të kornizës ligjore dhe profesionale, u plotësua vertikalisht rrjeti i redaksive në të tre nivelet dhe redaksitë e fushave nisën nga puna për kryerjen e detyrës që iu ngarkua: përgatitja e fjalësit paraprak të "Enciklopedisë shqiptare", thuhet në këtë relacion.

Në këtë fazë, që e kemi quajtur "faza mbledhëse", pra deri më 31 mars, që është

caktuar si afat dorëzimi për listat akumulative, është punuar kryesisht për të vjelë njësitë enciklopedike sipas fushave nga dy fjalorët e mëdhenj, FESH dhe FEK, që janë burime parësore, por dhe nga burime të tjera: fjalorë tematikë e terminologjikë, leksikonë, botime enciklopedike. Vëmendje kryesore për këtë fazë ka qenë koleksionimi i njësive enciklopedike, kujdesi për të mos harruar vlera të trashëgimisë shqiptare në fjalorët enciklopedikë e jashtë tyre. Kjo do të vazhdojë gjatë gjithë procesit.

Tashmë është e qartë se "Enciklopedia shqiptare", megjithëse mbështetet në një bazë të dhënash të mëparshme (fjalorët e botimet e tjera enciklopedike), nuk është e mundur të jetë bashkim a shumatore e tyre, sepse dallimi midis fjalorëve dhe enciklopedive është tipologjik.



Është bërë kujdes sidomos për personalitete e ngjarje të mënjanuara nga botime të mëparshme për shkak të kufizimeve ideologjike dhe fetare. Dukuria e përjashtimit ka vepruar edhe në shkrimet enciklopedike dhe tani është koha për të ndryshuar.

U tha në vijim se tashmë në serverin e QBEA ekziston një kujtesë digjitale shërbyese, e cila, duke e pasuruar vazhdimisht memorien me botime enciklopedike krahinore e tematike, me modele enciklopedish, e ka lehtësuar kërkimin automatik dhe punën për të këshilluar të dhënat. Çdo redaktor përgjegjës mund të autorizohet me fjalëkalim për të naviguar në këtë bazë të dhënash.

Nga vetë drejtuesit dhe anëtarët e redaksive të fushave është ndjerë e nevojshme që, për të mos harruar, baza e të dhënave të zgjerohet, duke krijuar një bibliotekë selektive

në shërbim të projektit, duke porositur disa modele enciklopedish dhe sidomos botime të enciklopedive tematike dhe krahinore, që përmbajnë kujtesa të nevojshme. Këto kërkesa i janë paraqitur kryeredaktorit, akad. Gjinushit, dhe do të plotësohen në kuadër të projektit.



Për tremujorin e parë detyrë tjetër ishte gjetja dhe shmangia e dyfishimeve dhe e mbivendosjeve dhe qartësimi i kufijve midis objektivit të një redaksie fushe me më të afërtat. Ky proces nuk ka përfunduar, por është në rrugë të mbarë. Vendimi i redaksisë vendore për t'i grupuar redaksitë e punës sipas afërsisë së fushave dhe caktimi i një anëtari të redaksisë vendore për koordinim mes tyre rezultoi një zgjidhje e suksesshme. Nën kujdesin e koordinatorëve përgjegjës, redaksitë e grup-fushave janë mbledhur edhe bashkërisht dhe po gjejnë zgjidhje për problemet e diskutueshme.

Caktimi i anëtarëve-kujdestarë për redaksitë e grup-fushave pati ndikim pozitiv edhe për komunikimin midis redaksive gjegjëse në Tiranë e në Prishtinë. Një pjesë e mirë e redaksive janë mbledhur në takime të përbashkëta me prani fizike a në linjë, sidomos ato të shkencave të sakta, të inxhinierive e teknologjive; redaksitë e ekonomisë, së fundi dhe redaksitë e letërsisë. Komunikime në forma të tjera ka pasur nga të gjitha redaksitë e fushave.

Kanë dalë si probleme prej redaksive të fushave:

1. Raporti numerik midis personaliteteve (përgjithësisht emrave të përveçëm) dhe ngjarjeve, dukurive, termave; raport që nuk mund të jetë si në fjalorët enciklopedikë, në këtë fazë rezulton shproporcional. Është i kuptueshëm presioni për të hyrë në enciklopedi, sidomos prej të gjallëve. Kriteret që janë miratuar orientojnë drejt, por

redaksitë e fushave janë nxitur të propozojnë e miratojnë kritere ndihmëse. Për shembull, në radhët e studiuesve dhe të profesoratit m titulli është kusht, por nuk mjafton; dallimi do të bëhet rast pas rasti me kritere pune nga redaksitë e fushave.

Formati i enciklopedisë kërkon kufizim relativ të emrave të përveçëm, shtim të ngjarjeve dhe trashëgimive, të institucioneve, krijim hapësire për termat e albanizuar (për atë pjesë të termave që janë mjete pune e komunikimi jo vetëm për specialistin, por për përdoruesin e gjerë të saj).

Një rekomandim do të ishte përfshirja e një grupi personalitetesh me kontribute të përfaqësuara në artikujt përmbledhës. Për shembull, një ministër i jashtëm që ka luajtur rol kyç në një moment vendimmarrës mund të përfaqësohet me artikull më vete, por të tjerët i bashkon fjala-referencë “ministria e punëve të jashtme”.

2. Ka dalë nevoja për të njëzuar pragjet e pranimit, vijat ndarëse, deri ku do të zbresë vëmendja e hartuesve të “Enciklopedisë” për të gjitha kategoritë: shkrimtarë, shkencëtarë, artistë, politikanë, mjekë; më tej: krahina e zona, fshatra e rrugë; që pragjet të jenë të njëzuar në Tiranë e në Prishtinë. E vetmja rrugë për të realizuar cilësisht projektin tonë të përbashkët, me ndoshta deri njëmijë bashkëpunëtorë, secili me përvojat e ndjeshmëritë e veta, është zbatimi i një disipline të mirëpranuar në kalendar, në kritere dhe në standarde, duke përfshirë pragjet minimale të vetëkufizimit.

3. Disa nga redaksitë e fushave (gjeografia sociale dhe gjeografia fizike p.sh.) kanë përgatitur artikuj instruktivë specifikisht për pjesën e tyre dhe duke ndjekur shembujt e miratuar nga Redaksia Qendrore për të ndihmuar autorët, dhe këta artikuj mund të jenë me dobi edhe për redaksitë gjegjëse në Kosovë e mund të përgatiten dhe nga redaksi të tjera.

4. Nga punonjësja e QBEA-së, e specializuar cilësisht për gjuhësi kompjuterike, analogjikisht me strukturën e artikullit enciklopedik miratuar nga Redaksia Qendrore, është formatuar moduli digjital (software, template) për të punuar nga autorët dhe redaktorët drejtpërdrejt në program, në kompjuter. Megjithëse jo i përfunduar, do të ishte mirë të përdorej edhe nga redaksitë në Kosovë, nga ajo pjesë që ka njohuri përdorimi, sepse shpejton e lehtëson shumë punën. Formatu digjital mund të bëhet më cilësor, por kjo që është arritur mbetet funksionale.

5. Nga redaksitë e shkencave teknike, por dhe nga ajo e ekonomisë, ka dalë problemi i përdorimit uniform e univok i termave të fushës. Dhe ky është problem për t'u zgjidhur edhe për shkak të detyrimeve që kemi për një shqipe të vetme në përdorim juridik-terminologjik në kuadër të procesit të detyrueshëm ndaj “acquis communautaire” për çdo vend që rrugëton drejt BE-së.

6. Periudha në vijim, prill-qershor ka si prioritet përzgjedhjen, që është proces i vështirë, por i pashmangshëm. Nga rreth 16 mijë njësi, që mendohet të ketë arritur numri i njësive të gjetura në dy fjalorët e mëdhenj dhe në burimet e tjera, duhet të mbeten jo më

shumë se 8 mijë, ndoshta dhe më pak, me qëllim para së gjithash që të rritet cilësia e përfaqësimit dhe pastaj edhe që të hapet vend për pjesën e munguar deri tani. Kriteri i vendosur, që nuk mund të ketë artikuj, as të vegjël, pa tri njësi bibliografike, do të ndihmojë.

7. Periudha korrik-shtator do të jetë për të përfunduar shkallëzimin hierarkik të përfaqësimit në madhësi artikujsh: përmbledhës, të vegjël, të mesëm dhe të mëdhenj. Nga redaksitë e fushave priten propozime për listën e artikujve monografikë, që miratohet nga Redaksia Qendrore. Kjo do parë si prioritet, sepse artikujt monografikë kërkojnë kohë të gjatë pune.

8. Ky vit përmbillet me caktimin e autorëve realizues për çdo artikull dhe lidhjen e kontratave me ta për kushtet, madhësinë, teknikën e të shkruarit, afatet e dorëzimit etj. Kjo për gjithë fjalësin e miratuar.

Kryeredaktori i "Enciklopedisë shqiptare" akad. Gjinushi theksoi nevojën e kriterëve ndihmëse nga çdo redaksi fushe. Përzgjedhja do të lehtësohej shumë duke përgatitur shembuj ilustrues, që shërbejnë jo vetëm për orientim, por edhe si cak, qoftë për krahasim, qoftë për të shërbyer si kufi, sepse jo çdo vlerë e trashëguar do të hyjë në enciklopedi. Ai rekomandoi që redaksitë të veçojnë fillimisht të padiskutueshmit, të vijojnë me të krahasueshmit dhe në fund mund të diskutohet për të mundshmit apo rastet përjashtimorë.

Akad. Gjinushi theksoi dallimet midis fjalorëve dhe enciklopedive dhe u ndal sidomos tek struktura e "Enciklopedisë", e cila duhet të ketë personalitetet, por duke lënë hapësirë për ngjarjet historike, trashëgimitë kulturore, dukuritë shqiptare dhe doemos edhe për terminologjinë e përgjithshme, së paku deri 10 për qind e së tërës, sepse "ESH" nuk është një vepër e mbyllur.

U bënë diskutime për referencat e domosdoshme si kusht për pranimin e njërive enciklopedike në vepër dhe për shkallëzimet e mundshme të besueshmërisë objektive të tyre (S. Hamiti, F. Krasniqi, M. Kraja, Dh. Haxhimihali); për mundësinë e të punuarit drejtpërdrejt në template-in e realizuar, avantazhet dhe vështirësitë (pas demonstrimit në faqen e dedikuar nga prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi, drejtor i QBAE), për çka u shprehën qendrime të ndryshme (S. Hamiti, M. Kraja, M. Verli); për raportet autor-redaktor, për periodicitetin e takimeve dhe mbledhjeve; si dhe për çështje të tjera.

Në këtë mbledhje u vendos që:

1. Deri në fund të muajit qershor redaksitë e fushave të kenë përfunduar përzgjedhjen me kritere të rrepta shkencore njësitë enciklopedike, duke ua dorëzuar listat redaksive vendore dhe më tej asaj qendrore, që ka tagrin e miratimit të tyre;

2. Deri në muajin shtator të jetë bërë ndarja e tyre sipas rëndësisë dhe shkallës së përfaqësimit në artikuj përmbledhës, të vegjël, të mesëm dhe të mëdhenj. Lista e artikujve monografikë miratohet nga RQ bashkë me autorët realizues;

3. Deri në fund të vitit të jenë propozuar nga redaksitë e punës, të jenë dakordësuar dhe miratuar autorët realizues;

4. Redaksitë e fushës të takohen dy herë në vit, një herë në Tiranë e një herë në Prishtinë;

5. U miratua në tërësi kalendari i takimeve dhe mbledhjeve të redaksive.

Mbledhje Kryesie

Sot më 19 mars 2024, ora 10.00 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, në zyrën e Kryetarit akad. Skënder Gjinushi u mbajt mbledhja e Kryesisë.

Mbledhjen e drejtoi zëvendëskryetari akad. Vasil Tole në praninë e sekretarit shkencor akad. Shaban Sinani, Kryetarit të Shkencave Natyrore dhe Teknike akad. Neki Frashëri dhe Kryetarit të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike akad. Gëzim Hoxha.



Mbledhja e Kryesisë u mbajt me këtë rend dite:

1. Për zbatimin e marrëveshjes me IZUM-in.
2. Për listën e botimeve 2024, përgatitur nga sektori i botimeve, bazuar në listën paraprake të paraqitur në Asamble.
3. Njohja me urdhrin Për përdorimin e vulave të njëjësive kërkimore të përhershme, si dhe njësimin e qarkullimit të dokumentacionit administrativ në Akademinë e Shkencave.
4. Rishikimi i përfaqësuesve të ASh-së në komisionet e vlerësimit teknik të projekteve, pranë AKKSHI-së.
5. Për përbërjen e komisioneve të përhershme të ASh-së.
6. Për rishikimin e përbërjes së anëtarëve të këshillit të botimeve.
7. Propozime për kandidatë për anëtarë të jashtëm të ASH.

Vendim i jurisë së çmimit të veçantë shkencor “Pilika” për kalendarin, kriteret e pjesëmarrjes dhe procedurat që ndiqen për zhvillimin e konkursit

Në mbledhjen e saj të datës 15 mars 2024, pasi diskutoi për detyrat dhe përgjegjësitë e saj për përgatitjen dhe zhvillimin e suksesshëm të konkursit kombëtar për çmimin e veçantë “Pilika”, juria, e ngritur me vendimin nr. 29 datë 8.3.2024 të Kryesisë së Akademisë së Shkencave, vendosi:

I. Kalendar:

1. Afati për regjistrim në konkurs të jetë deri më 15 prill 2024.

Kandidatët duhet të dorëzojnë brenda këtij afati në protokoll-arkivin e institucionit dokumentacionin përkatës (sipas përshkrimit në rregulloren për çmimet), në CD dhe në letër. Komunikimet me jurinë mbahen në adresën elektronike eljorasema@gmail.com

2. Lista e kandidatëve që kualifikohen pas shqyrtimit të dokumentacionit në dosje bëhet e njohur përmes medieve sociale deri më 5 maj 2024;

3. Zgjedhja dhe shpallja e të nominuarve të përfundojë deri më 15 maj 2024;

4. Shpallja e fituesve të bëhet në konferencën kombëtare të matematikës, që do të zhvillohet më 3 qershor 2024.



II. Procedurat që ndiqen dhe dokumentacioni i nevojshëm:

1. Kërkesa për regjistrim në konkurs mund të bëhet nga: a). autori; b). njësia bazë ku ai ushtron veprimtarinë shkencore-universitare; c). Propozime për regjistrim në konkurs të një doktorate/punimi mund të bëhen edhe nga dy specialistë në fushën e matematikës me titull “profesor”;

2. Kandidati duhet të dorëzojë në protokoll-arkivin e institucionit punimin e doktoratës (disertacionin), në version elektronik dhe me internet-link-un përkatës, sipas publikimit në faqen zyrtare të institucionit ku është mbrojtur;

3. Kandidatët që konkurrojnë për doktoratën më të vlerësuar duhet të dorëzojnë, veç saj, edhe deri tre artikuj që lidhen me temën e disertacionit (në version elektronik dhe të shtypur);

4. Kandidatët që konkurrojnë për punimin më cilësor duhet të dorëzojnë, veç tij, edhe deri tre artikuj për të njëjtën temë (në version elektronik dhe të shtypur);

5. Për punimet shkencore të realizuara nga grup autorësh regjistrimi në konkurs bëhet nga: a). autori i parë; b). autori i dytë (shoqëruar me rekomandimin e njësisë-bazë) ose c). gjithë bashkautorët (shoqëruar me rekomandimin nga dy studiues me titullin “profesor” në matematikë).

Në çdo rast çmimi jepet për bashkautorët në tërësi.

III. Kriteret e vlerësimit, shprehur në dy matës numerikë:

1. Vlerësimi i parë, për doktoratën/disertacionin dhe për punimet në konkurrim, bëhet me pikë nga çdo anëtar më vete, nga 10 deri në 1 pikë. Vlerësimi përfundimtar i pikëzuar del si shumë e tyre.

2. Vlerësimi i dytë, për artikujt, bëhet mbi bazën e citimeve në platforma/ baza të dhënash të njohura për indeksim ndërkombëtar, përlllogaritur sipas faktorëve përkatës si në vijim: citimet në “Scopus” - me faktor 3; citimet në “MathSciNet” - me faktor 2. Në mungesë të dhënash prej tyre: citimet në “Researchgate” - me faktor 2 dhe në “Google Scholar” - me faktor 1.

Vlerësimi tërësor i disertacionit/punimit përlllogaritet duke shumëzuar citimet me faktorin përkatës për të dy rastet si më sipër dhe në fund duke mbledhur rezultatin e tyre.

3. Vlerësimi i punimeve bëhet veçmas për secilin nga kandidatët. Çdonjëri prej anëtarëve të jurisë bën vlerësimin e vet. Më tej këto shumëzohen me faktorin përkatës për të dhënë vlerësimin përfundimtar për çdo kandidat.

IV. Shmangia e konfliktit të interesit:

1. Kur një aplikant ka qenë nën udhëheqjen e një anëtari jurie (ose ka lidhje tjetër që përbën konflikt interesi), anëtari i jurisë nuk merr pjesë në vlerësimin e atij aplikanti.

2. Në rastin e mospjesëmarrjes në vlerësim të një a më shumë anëtarëve për shkakun e mësipërm, rezultati del duke pjesëtuar shumën e pikëve me numrin e anëtarëve pjesëmarrës në vlerësim dhe duke e shumëzuar atë me numrin e plotë të anëtarëve të jurisë.

Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi me kolegjin universitar "Reald" të Vlorës



- Marrëveshja u nënshkrua nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave, dhe prof. Spiro Çausi, Rektor i kolegjit universitar "Reald"

- Të pranishëm anëtarë të Asamblesë, përfaqësues të kolegjit universitar "Reald", drejtues të institucioneve publike e jopublike të arsimit të lartë

Akad. Gjinushi theksoi se Akademia e Shkencave, në bashkëpunimin me institucionet akademike-universitare, nuk kufizohet vetëm me universitetet publike, por gjen hapësira bashkëpunimi edhe me ato jopublike.

Në rastin konkret, tha ai, bashkëpunimi përfshin tri fusha prioritare: mjekësinë, ekonominë dhe biologjinë. Komisionet e përhershme të këtyre fushave në ASHSH dhe fakultetet gjegjës në "Reald" mund të bashkëpunojnë drejtpërsëdrejti, në kuadër të projekteve dhe nismave të tjera dypalëshe, për çështje të karakterit rajonal e kombëtar, si shëndeti publik, mjedisi, turizmi, shkencat e jetës.

Nga të pranishmit u theksua veçmas rëndësia e një projekti të përbashkët për vlerësimin e rrezikut të pranisë së merkurit në ujërat bregdetare në zonën industriale të Vlorës, të ndotura në nivele të larta pas shkatërrimit të industrive të vjetra të sodës etj.

Një traditë bashkëpunimi për këtë ekziston. Por tani mund të kalohet në fazën e rekomandimit të masave të dezaktivizimit të mbetjeve të tij në vijën bregdetare.



Drejtuesit e dy institucioneve paraqitën misionin dhe strukturat e tyre dhe mundësitë konkrete për bashkëpunim, që përfshin: pjesëmarrje në veprimtari të shkencore të njëra-tjetrës, shkëmbim botimesh dhe informacioni shkencor, lehtësim aplikimesh për projekte, së bashku dhe me palë të treta; pjesëmarrje të akademikëve në hartimin e programeve universitare dhe mbajtjen e ligjëratave të hapura prej tyre.



Marrëveshja e nënshkruar



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË



KOLEGJI UNIVERSITAR REALD

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Kolegjit Universitar *Reald*

Nisur nga vullneti i mirë për bashkëpunim të dyanshëm në kërkimin shkencor e në formimin universitar të brezave të rinj në fushën e mjekësisë, farmaceutikës, stomatologjisë, veterinarisë dhe ekonomisë;

Në përputhje me strategjinë e hapjes ndaj bashkësive shkencore-universitare që ndiqet nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej ASHSH) dhe me politikat bashkëpunuese të Kolegjit Universitar *Reald* (më tej *Reald*);

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Kolegji Universitar *Reald* - Vlorë (më tej të quajtura *Palë*), nënshkruajnë këtë

Marrëveshje bashkëpunimi

1.1. *Palët* bashkëpunojnë në kërkim e formim universitar në fushat e interesit të përbashkët, në përputhje me mundësitë dhe specifikat e tyre.

1.2. *Palët* inkurajojnë kontaktet dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë midis strukturave përbërëse të tyre: fakulteteve e departamenteve (në *Reald*) dhe komisioneve të përhershme, posaçërisht të komisionit të mjekësisë; të komisionit të biologjisë, bujqësisë e veterinarisë; si dhe të komisionit të ekonomisë dhe çështjeve sociale e juridike (pranë ASHSH).

2. Fushat konkrete përparësore të bashkëpunimit mes dy institucioneve janë:

2.1. Shkëmbimi falas i botimeve shkencore, në përputhje me profilin dhe nevojat e bibliotekave të dy institucioneve, pa kushtëzim pariteti;

2.2. Shkëmbimi i programeve vjetore të veprimtarisë shkencore, gjegjësisht të mësimdhënies universitare, për të lehtësuar pjesëmarrjen e kërkuesve të dy institucioneve në aktivitetet me interes për njëra-tjetrën;

2.3. Shkëmbimi i informacionit shkencor (katalogë, udhërrëfyes, bibliografi) dhe i botimeve të digjitalizuara; ASHSH mundëson gjithashtu pajisjen me kartë digjitale të profesoratit të *Reald* për kërkim të lirë në bazat e të dhënave të administruara prej saj si *Cobiss.al* dhe *Ecris.al*; duke vendosur lidhje të drejtpërdrejta bashkëpunimi me *qendrën kombëtare për koordinimin dhe përhapjen e informacionit shkencor* që funksionon pranë saj;

2.4. Mbështetja reciproke për aplikime në projektet kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit (PKZH, PIKZH, administruar nga AKKSHI); aplikime të përbashkëta për projekte lokale në fushë të mjekësisë, veterinarisë, ekonomisë, teknologjisë së informacionit, shtetit të së drejtës, mirëqeverisjes dhe problemeve sociale;

2.5. Pjesëmarrja e profesoratit të *Reald* si kontribuues në veprimtaritë e ASHSH, gjegjësisht e specialistëve prej trupës akademike të ASHSH në mësimdhënie universitare për programe të studimeve të shkallës *master* dhe *doktoratë*;

2.6. Organizimi i së paku një veprimtarie të përbashkët shkencore në vit (seminar, workshop), duke përfshirë ligjërata akademike dhe universitare (edhe nëpërmjet platformave të mësimin në distancë);

2.7. Pjesëmarrja e profesoratit dhe studentëve të *Reald* në veprimtaritë që organizon ASHSH në kuadër të politikës *Shkenca dhe edukimi*;

3.1. Kjo marrëveshje nuk parashikon detyrime financiare për *Palët*. Ndarja e përgjegjësisë në buxhet për veprimtaritë e përbashkëta bëhet rast pas rasti;

3.2. *Palët* favorizojnë përfshirjen e njëra-tjetrës në bashkëpunime të tjera dypalëshe, në përputhje me përparësitë që caktohen në këtë marrëveshje;

3.3. Kjo marrëveshje nënshkruhet për 4 (katër) vjet, në gjuhën shqipe, në dy kopje, një për secilën *Palë*. Me mbarimin e këtij afati ajo mund të përsëritet edhe për dy vjet të tjera, përveç rastit kur njëra nga *Palët* njofton me shkrim mungesën e interesit jo më vonë se gjashtë muaj para mbarimit të afatit të vlefshmërisë.

3.4. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga përfaqësuesit e autorizuar të dy *Palëve*.

Për:

Akademinë e Shkencave të Shqipërisë

Akad. Skënder Gjinushi, Kryetar

Për Kolegjin Universitar

Prof. Spiro Caushi, Re.



Propozime të grupit të punës për disa ndryshime në rregulloren ekzistuese për periodikët shkencorë të Akademisë së Shkencave

Ky takim kishte karakter informues për ecurinë e punëve referuar kalendarit të miratuar për masat që duhet të ndërmerren për rritjen e cilësisë së revistave shkencore të ASHSH dhe për plotësimin e kërkesave dhe standardeve për indeksim ndërkombëtar.

Në takimin e sotëm, të thirrur nga Kryetari i ASHSH akad. Skënder Gjinushi, anëtarët e grupit të punës, të ngarkuar me vlerësimin e gjendjes dhe propozimin e ndryshimeve në politikën editoriale dhe kërkesat shkencore që duhen plotësuar për indeksim të brendshëm e ndërkombëtar: akad. Anila Hoda, akad. asoc. Adrian Civici dhe prof. asoc. dr. Gjon Boriçi, raportuan sipas detyrave përkatëse.



Prof. asoc. dr. Gjon Boriçi parashtrroi kërkesat që kanë dalë për disa ndryshime në rregulloren ekzistuese të periodikëve shkencorë pas bashkimit të instituteve të albanologjisë dhe pas miratimit të rregullores së regjistrimit të revistave shkencore në Shqipëri, në përputhje me shkallën e plotësimit të kriterëve për indeksim dhe me kategoritë e tyre. Sipas z. Gjon Boriçi, tri nga revistat e ASHSH ("Studia albanica",

"Albanian studies" dhe "AJNTS"), vetëvlerësuar sipas kritereve të përmendura, do të regjistroheshin në gjendjen e tanishme në Listën B, kurse gjashtë të tjerat në Listën C. Hapi i parë dhe i menjëhershëm është fillimi i procedurës për regjistrim në listat e indeksimit të brendshëm miratuar nga Ministria e Arsimit.

Për të avancuar në kategorizim për një shkallë më lart, në rregulloren në fuqi duhet saktësuar rreptësisht periodiciteti i daljes në qarkullim online, me muaj e datë, sepse ndryshe e drejta për regjistrim nuk ekziston edhe për dy vjet në vijim. Prandaj revistat duhet të dalin në datat e paralajmëruara, qoftë dhe me vëllim të vogël. Numri i artikujve mund të jetë sipas gjendjes, nga 6-10 për numër. Së dyti, duhet ndryshuar struktura e tanishme e revistave, të cilat, sipas kritereve për indeksim, nuk duhet të kenë asnjë rubrikë tjetër veç shkrimeve shkencore (recensione, kronikë, jetë shkencore). Për lëndën që përmbajnë këto rubrika mund të dalë "Vjetari" informativ i ASHSH, praktikë e njohur në akademitë e ngjashme. Ndryshimi i tretë ka të bëjë me procedurat transparente të recensionimit dhe me funksionimin e këshillave botues e të redaksive shkencore, duke përfshirë përbërjen e anëtarësisë së tyre. Së fundmi, kalimi i gjithë lëndës që botohet në një platformë antiplagjiaturë është detyrim.



Akad. Anila Hoda njohu të pranishmit me kërkesat që duhen plotësuar për

kalimin nga indeksimi sipas rregullores së Ministrisë së Arsimit në indeksim ndërkombëtar në platformat / bazat e të dhënave që bëjnë vlerësim të tillë, si Scopus, Web of Science etj. Kusht themelor është që çdo revistë të ketë faqen e vet elektronike të dedikuar. Dalja në anglisht është favorizuese kurse pajisja me abstrakt anglisht e domosdoshme. Akad. Hoda paraqiti gjithashtu konceptin e një faqeje elektronike, me rubrikat e domosdoshme, që shpallin kërkesat për autorët, kërkesat për recensuesit, për redaktorët dhe redaksitë. E domosdoshme është gjithashtu pajisja e artikujve me doi (digital object identified) dhe i revistave me e-ISSN.

Akad. asoc. Adrian Civici bëri të njohura standardet ndërkombëtare për konceptet "revistë", "periodik" dhe "anuar" dhe më tej specifikoi strukturën e disiplinuar të një artikulli shkencor sipas kriterëve ndërkombëtare, shkencore e teknike (titull, abstrakt, fjalë-çelësa, parashtrim e zhvillim, përfundime e rekomandime, sistem referencash, bibliografi etj.).

Të tre studiuesit këto rekomandime i paraqitën edhe me shkrim.

Në përfundim u vendos që ndryshimet në rregulloren ekzistuese të bëhen nga akad. Shaban Sinani dhe prof. asoc. dr. Gjon Boriçi; kurse për ndryshimet e tjera, edhe këto të domosdoshme për regjistrim e avancim në indeksim ndërkombëtar, u vendos që kolegët Anila Hoda e Adrian Civici të hartojnë një manual praktik për gjithë redaksitë dhe këshillat botues. Manuali do të përfshijë dhe një template të propozuar nga hartuesit për njësimin teknik të punës së autorëve të artikujve shkencorë.

Zhvillohet mbledhja e bordit të drejtorëve dhe kryetarëve të komisioneve të përhershme të instituteve të albanologjisë

Në përputhje me rendin e ditës, të njoftuar më parë, drejtorët e instituteve raportuan për titujt e veprave të miratuara për botim vitin e kaluar nga këshillat shkencorë në institute, që barten për këtë vit, si detyrim i trashëguar, për shkak të vonesave në prokurim. Në këtë listë janë 32 tituj. Akad. Gjinushi kërkoi nga drejtorët freskim të dhënash për këtë listë, nëse mbetet siç është apo ka ndryshime.



Përfundimisht, 32 veprat e parashikuara për botim për vitin 2023 i kalojnë programit të veprimtarisë botuese të këtij viti.

Në lidhje me listat e propozuara nga institutet për këtë vit, pas raportimit të drejtorëve (Bunguri, Kaba, Memisha, Lelaj, Çapaliku), vetëm tre tituj janë gati për të kaluar në këshillin e botimeve të ASHSH.

Akad. Skënder Gjinushi shtroi për diskutim çështjen e ngjashmërive dhe dallimeve eventuale të procedurave që ndiqen për recensionimin dhe marrjen e vendimeve për botim në këshillat shkencorë të instituteve krahasuar me ato të këshillit të botimeve të ASHSH.

Për të mos përsëritur procedurat, mbështetur në raportimet e drejtuesve të instituteve, u vlerësua se këshillat shkencorë mund të jenë edhe më tej organizma vendimmarrës për botimet e punonjësve të tyre, duke qenë se procedurat janë strikte dhe përbërja e këshillave është me anëtarë të brendshëm e të jashtëm. Listat e veprave të miratuara në këshillat shkencorë detyrimisht do të kalojnë dhe në këshillin botues të

Akademisë, e cila është ent botues unik për gjithë rrejtin e njësive shkencore pranë saj.

Ndërkaq, prurjet nga akademikët dhe bashkëpunëtorët i nënshtrohen procedurës sipas rregullore së veprimtarisë botuese. Këshilli botues merr vendimin përfundimtar për listën e botimeve, duke ruajtur përpjesëtimet dhe ekuilibrat e duke zbatuar përparësitë e politikës editoriale.



Kryetari Gjinushi kërkoi që drejtuesit e instituteve dhe kryetarët e komisioneve të përhershme të bëjnë propozime për shtimin e 4-5 anëtarëve në këshillin e botimeve, për t'iu përgjigjur raporteve të reja ndërfaqshore pas bashkimit të instituteve të albanologjisë me ASHSH.



U kërkua që drejtuesit e instituteve të paraqesin kopje të marrëveshjeve të nënshkruara në fuqi, me qëllim që institucionet palë të njoftohen për trashëgimin e përgjegjësisë dhe detyrimeve në ASHSH.



Po ashtu u vendos që të ngrihet një grup pune për shqyrtimin dhe relatimin në Kryesi apo Asamble për çështje që lidhen me riorganizimin e instituteve; aktet statutore; rregulloret; ristrukturimin etj. Priten propozime nga drejtorët e instituteve dhe kryetarët e komisioneve për 4 anëtarë të këtij grupi pune.

Në pikën e fundme të rendit të ditë u diskutua për riorganizimin e bibliotekave dhe arkivave të ASHSH. Akad. Vasil S. Tole paraqiti një paraprojekt për riorganizimin e arkivave të trashëgimisë të rrjetit të institucioneve të Akademisë.

Akademiku Nazim Gruda vlerësohet si hulumtues i shquar ("Investigador distinguido") nga Universiteti Politeknik i Kartagjenës, Spanjë

Gjatë pjesëmarrjes në një konferencë shkencore ndërkombëtare të organizuar nga Universiteti Politeknik i Kartagjenës (La Universidad Politécnica de Cartagena - UPCT, Spanjë), në të cilën ai referoi për temën "Bujqësia inteligjente e përshtatur ndaj ndryshimeve të klimës në prodhimin intensiv të perimeve" akad. Nazim Gruda vlerësohet nga organizatorët si "hulumtues i shquar" ("investigador distinguido").



Përzgjedhja e tij për këtë vlerësim u bë bazuar në përfshirjen e tij të suksesshme në veprimtari universitare-akademike sipas thirrjes së ministrisë së universiteteve të Spanjës për pjesëmarrjen e shkencëtarëve të shquar nga Europa në këtë proces, përmes projektit të titulluar "Modernizimi dhe digjitalizimi i sistemit arsimor", në kuadër të planit të rimëkëmbjes, transformimit dhe reziliencës të shkencës dhe arsimit të lartë.

Kjo përzgjedhje i jep atij mundësinë të vijojë studimet dhe bashkëpunimin me UPCT, bashkëpunim ky me një histori disa-vjeçare, që përfshin disa projekte kërkimore dhe botime të përbashkëta.

Akad. Gruda është ftuar të luajë një rol parësor në projektin për zhvillimin e hortikulturës urbane dhe "vertical farming". Hulumtimet e tij janë përqendruar në risitë e prodhimit të qëndrueshëm të ushqimit hortikulturor. Ai ka shkruar e botuar mbi 300

publikime shkencore, ku më shumë se 100 prej tyre listohen në Scopus. Disa nga punimet e tij njihen si pararendëse në diskutimet bashkëkohore shkencore, si p.sh. ato për cilësinë e prodhimeve hortikulturore dhe të ushqyerit apo të ndryshimeve të klimës, duke u renditur si punime me një indeks citimi shumë të lartë.



Nazim Gruda është aktualisht zëvendëskryetar i seksionit të perimeve, bimëve rrënjore e zhardhokore dhe kryetar i grupit të punës për Europën Juglindore të Shoqatës Ndërkombëtare të Shkencave të Hortikulturës. Në fund vitit që shkoi, Organizata Botërore e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO) e nominoi atë si ekspert i “Green agriculture” për Europën dhe Azinë Qendrore.

Organizimi i Panairit të 3-të Mbarëkombëtar të Librit Akademik dhe Shkencor është në rrugë të mbarë

- Konfirmojnë pjesëmarrjen mbi 30 institucione, universitete dhe shtëpi botuese nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut
- Panairi do të mbahet në Tiranë më 23-25 prill 2024 nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës



U mbajt sot më 21 mars 2024 mbledhja e grupit të punës për organizimin e Panairit të 3-të Mbarëkombëtar të Librit Akademik dhe Shkencor, që do të zhvillohet këtë vit në Tiranë si nismë e përbashkët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave e Arteve të Kosovës.

Mbledhja u drejtua nga zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akademik Vasil Tole, njëkohësisht Kryetar i komitetit organizativ të Panairit të 3-të Mbarëkombëtar të Librit Akademik dhe Shkencor.

Grupi i punës prezantoi ecurinë e organizimit të këtij panairi dhe konstatoi se kanë konfirmuar pjesëmarrjen mbi 30 institucione të arsimit të lartë publik, institute dhe qendra shkencore nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia e Veriut.

Është plotësuar kalendari i promovimeve të librave dhe janë caktuar drejtuesit dhe organizatorët e këtyre promovimeve, përmes të cilave synojnë të bëjnë të njohura arritjet më cilësore në botimet akademike, shkencore dhe universitare dhe promovimin e figurës

dhe personalitetit të shkencëtarit e studiuesit shqiptar në hapësirën mbarëkombëtare.

Dy institucionet e larta të vendit, Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS) dhe Ministria e Ekonomisë e Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), si dhe Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit (QKLL) janë bashkëpunëtorë të këtij panairi.



Panairi do të mbahet në Tiranë më 23-25 prill 2024.

Tri ditët e panairit, përpos ekspozimit të librit akademik dhe shkencor në stenda të dedikuara do të shërbejnë si një hapësirë dhe mundësi diskutimi mbi tema të rëndësishme të dijeve shqiptare, kërkimit shkencor dhe të drejtës së autorit.

Pjesëmarrës në panair

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Institute dhe qendra shkencore publike, Shqipëri:

Instituti i Arkeologjisë

Instituti i Historisë

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

Instituti i Antropologjisë

Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike

Qendra e Studimit të Arteve

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë (Tiranë)

Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante

Institute dhe qendra shkencore publike, Kosovë:

Instituti i Historisë

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Maqedonia e

Veriut

Institucione të arsimit të lartë (publik):

Universiteti i Tiranës

Universiteti i Mjekësisë

Universiteti i Korçës Fan Noli

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuqi

Universiteti i Elbasanit Aleksandër Xhuvani

Universiteti i Durrësit Aleksandër Moisiu

Universiteti i Gjirokastrës Eqrem Çabej

Universiteti i Vlorës Ismail Qemali

Universiteti Politeknik i Tiranës

Universiteti i Prishtinës, Kosovë

Universitete publike në Maqedoninë e Veriut:

Universiteti Shtetëror i Tetovës

Universiteti i Shkupit Nënë Tereza

Universiteti jopublik, Maqedonia e Veriut

Universiteti i Europës Juglindore, Tetovë

Universitete jopublike, Shqipëri

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Universiteti "Luarasi"

Nga ente botuese jopublike:

Shtëpia botuese Toena

Shtëpia botuese Argeta LMG

Qendra e Botimeve për Diasporën

(Së shpejti do të publikohet edhe kalendari i promovimeve)

<https://facebook.com/events/s/panairi-mbarekombetar-i-librit/7129302573783378/>

Cilësia e ajrit si faktor themelor për jetëgjatësi, mirëqenie e shëndet publik

- Ekspertët të shqetësuar pas renditjes së Shqipërisë në shtatë vendet me ajrin më të ndotur në Europë sipas raportit për cilësinë e ajrit të hartuar nga IQAir, organizatë shkencore zvicerane

- Akad. asoc. Besnik Baraj sot në një bisedë televizive për këtë problematikë



Pas ligjërates së hapur për shkallën e ndotjes së ajrit në qytetin e Tiranës dhe në disa qytete të tjera, mbajtur në sallën "Aleks Buda" të Akademisë së Shkencave rreth dy muaj më parë, akad. asoc. Besnik Baraj sot ishte i ftuar për një bashkëbisedim televiziv për të vlerësuar gjendjen, nivelet dhe faktorët e ndotjes së lartë të ajrit në Tiranë, mbështetur në të dhëna të sistemuara e përpunuara pas matjeve profesionale prej tij për një kohë të gjatë në disa nyje kyçe të kryeqytetit, në stinë të nxehtë e të ftohtë; në ditë me intensitet të lartë të qarkullimit të automjeteve dhe në mjedise me përqendrim të njerëzve.

Këto të dhëna, të administruara nga akad. asoc. Besnik Baraj dhe njësia për pasuritë ujore pranë ASHSH që ai kryeson, përcjellin të njëjtin alarm si dhe ato të OBSH dhe të institucioneve të specializuara shkencore.

Në kontekst të shndërrimit të turizmit në prioritet zhvillimi dhe të politikës së dekarbonizimit që ndiqet nga Qeveria, ky shqetësim bëhet edhe më i madh.

Përmirësimi i cilësisë së ajrit në Tiranë, u theksua gjatë bashkëbisedimit, kërkon së pari të njihet gjendja, të bashkëpunohet me kapacitetet shkencore të vendit, të ketë transparencë, ku tërë faktorët politikë, socialë dhe komuniteti të investohen për një


shoqëri që mendon profilaktikisht për shëndetin dhe mirëqenien.

Ndiqni në linkun këtu poshtë regjistrimin e plotë të këtij bashkëbisedimi:

<https://youtu.be/JQF-sbTPo74?si=Px8lHyZLFQqsQOum>

"Tirana ein kurzer Traum" / "Tirana, një ëndërr e shkurtër", roman i Stefan Çapaliku, paraqitet në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Leipzig

- Veprimtaria u zhvillua sot, në një prej auditorëve të promovimit të librit sipas programit brenda mjediseve të panairit



Romani është përkthyer në kuadër të programit të njohur "Traduki". Përkthyesë është Zuzana Finger dhe ent botues "Transit Verlag".

Të pranishëm studiues, përkthyes, lexues të librit në gjermanisht, miq të autorit. Përrurimi i moderua nga znj. Shqipe Sylejmani.

Akad. asoc. Stefan Çapaliku, autor i librit, iu përgjigj interesimeve të të pranishmëve për çështje të lidhura me këtë vepër, me përkthimin dhe cilësinë e tij, me krijimtarinë e tij si romancier e dramaturg prej dekadash, me rëndësinë e përkthimeve në

gjuhët e fqinjëve dhe në gjuhët e mëdha për të njohur shpirtin e një populli dhe për të formuar empati të qëndrueshme për tjetrin.



Stefan Çapaliku është një nga autorët bashkëkohorë më të përkthyer në letërsi.

**Akad. Aurela Anastasi - ligjëratë e hapur për reformën në drejtësi
(Në 25-vjetorin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë - 1998)**

- Në Universitetin Ndërkombëtar të Ballkanit, Shkup



Akademike Aurela Anastasi mban leksion mbi çështje të identitetit të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të ndryshimeve kushtetuese, për reformën në drejtësi (2016), në Universitetin Ndërkombëtar të Ballkanit (IBU) me qendër në Shkup, Maqedoni e Veriut.

Njoftimi zyrtar në faqen e International Balkan University


Guest lectures conducted by prof. dr. Aurela Anastasi as part of the joint course in comparative constitutional law organized by IBU Faculty of Law, in partnership with Fairleigh Dickinson University.

On 4th and 18th March 2024, as part of the program of the joint course in comparative constitutional law, IBU Faculty of Law in partnership with Fairleigh Dickinson University, had the honor of inviting for an online guest lecture prof. dr. Aurela Anastasi, the professor of constitutional law at the University of Tirana.

Professor Anastasi is the author of several monographs, textbooks and scientific articles, human rights reports, and speeches in the field of constitutional law and gender equality in society.

She has been involved in research projects and working groups for drafting legal acts, such as the constitutional reform of the justice system in Albania, gender equality and protection from discrimination, the agreements between the Council of Ministers and

the religious communities in Albania and the reform for academic research institutions. She is also a defense attorney specialized in women rights.



Prof. dr. Aurela Anastasi contributed immensely on the program by providing two open online lectures on the respective days for the students of the Faculty of Law.

On 4th of March professor Anastasi analyzed the identity of the Constitution of the Republic of Albania by making an overview regarding of its history, the separation of powers and the characteristics of the bodies exercising these powers.

She analyzed the protection of the human rights and the notion of “The supranational identity” clearly related with the relationship between Albania and European Union foreseen as well under the Constitution.

On 18th of March, professor Anastasi presented the constitutional reform of the justice system in Albania, the significance of this reform, the establishment of the new institutions of justice, the vetting process and the results that it brought. Students of the Faculty of Law of both universities shared their interest by asking questions.

In the end, the Dean of the Faculty of Law assoc. prof. dr. Nikola Dacev, the main coordinators of the program prof. dr. Madelyn S. Ferrans and Asst. Leptosava Ognjanoska Stavrovska as well as the students of the Faculty of Law from both universities shared their deepest gratitude toward prof. dr. Aurela Anastasi for her contribution in the program, with the intention of having more collaborations in the future.

Dita e Autorëve Europeanë - The Day of European Authors

- Shkrimtari dhe studiuesi i letërsisë dr. Arian Leka paraqiti sot librin "Hartë memece për të mbyturit" në gjimnazin Sami Frashëri

- Arian Leka paraqiti veprën dhe bashkëbisedoi me gjimnazistët për diversitetin kulturor european përmes letërsisë dhe përkthimeve, rëndësinë e leximeve dhe "europeanizmin" si ide e kahershme dhe në perspektivat e tij kulturore në kushtet e një Europe që ndryshon.



Shkrimtari dhe studiuesi dr. Arian Leka, përgjegjës i Sektorit të botimeve enciklopedike (QBEA) në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, sot më 25 mars 2025, në kuadër të Ditës së Autorëve Europeanë, mbajti një veprimtari në sallën "Auditor" të gjimnazit "Sami Frashëri" në Tiranë, ku ishin pranishëm drejtoresha e këtij institucioni, znj. Majlinda Ziu, mësues dhe mbi 100 gjimnazistë, mes të cilëve edhe krijues nga rrethi letrar.

Në fillim të takimit, shkrimtari Arian Leka përshëndeti të pranishmit dhe bëri një përshkrim të shkurtër mbi domethënien dhe rëndësinë e Ditës së Autorit European, duke u ndalur jo vetëm në historinë e mëhershme të Shqipërisë, si një vend me kontribute në Europë dhe në Rilindjen Europiane, por edhe për përpjekjet për të ruajtur orientimin european pas viteve 1900 e në vijim.

25 Marsi 2024 vjen si një ngjarje historike për Europën, për shkrimtarët dhe për lexuesit e saj të rinj, - tha dr. Leka, - ndërsa kujtoi të pranishmit se "Dita e autorëve europeanë" do të kujtohet përmes takimeve që do të mbahen njëkohësisht në 40 vende të kontinentit.

Pas fjalës përshëndetëse dr. Leka paraqiti librin "Hartë memece për të mbyturit".

Paraqitja e librit nisi me leximin e fragmenteve të zgjedhura nga libri dhe me poemën "Auschwitz detar", duke veçuar prozat "Prej nga vjen Drita", "Më fort se sa fjalët" dhe disa poezi nga libri.

Poema "Auschwitz detar", që paraqitet si kulminacion i veprës, është një përfytyrim i pashoq mbi Mesdheun si një kamp përqendrimi nënujor dhe metropol alegorik i të ikurve e i të mbyturve në det. Kjo temë u bë sërish e afërt ngaqë në fjalorin e Europës pa kufij, u rikthyen fjalët kamp - tel me gjemba - mur - luftë - ata - ne... Libri dhe poema "Auschwitz detar" është përkthyer në anglisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht, italisht, anglisht, polonisht, greqisht, rumanisht, serbisht, boshnjakisht, kroatisht, sllovakisht, maqedonisht, sllovenisht në gjuhën malazeze etj.



Shkrimtari e paraqiti poemën "Auschwitz detar" si rast për të bashkëbiseduar mbi diversitetin kulturor europian, letërsinë, lirinë dhe rolin e shkrimtarit përballë luftës, në të cilën ai përdor gjuhën dhe fjalën si mjet, vendin e letërsisë në një botë të copëtuar nga konfliktet dhe lufta, që ndryshon shkrimin, leximin dhe këndvështrimet, duke sjellë kulturën e urrejtjes.

Letërsia, -theksoi Leka, -është një nga zonat e prekura nga lufta edhe kur lufta është larg. Por lufta, paradoksalisht dhe në mënyrë sarkastike, veç shkatërrimit dhe viktimave, lë pas edhe kryevepra letrare.

Teksa lexoi për nxënësit e gjimnazit "Sami Frashëri", Arian Leka theksoi se letërsia europiane ka hyrë përherë mes urrejtjes për të na paralajmëruar, për të qenë dëshmitar, për të mos harruar sa ndodh, sepse në atë çast, është të parashikojë, të paralajmërojë në kohë, të mbajë shënim dhe të shkruajë, si një mënyrë për ta kuptuar më thellë gjithë sa

ndodh. Por në një mënyre lufta është një mësues. Ne mësojmë nga lufta, jo vetëm nga lufta me armë, por edhe nga lufta vetjake dhe lufta në sferat publike. Prej tyre mësojmë si të kundërshtojmë, si të protestojmë, si të mos humbasim shpresën dhe si të rilindemi në një hapësirë të gjerë e të përbashkët dhe pa kufi, të frymëzuar nga kultura, nga ajo kulturë që promovon bashkimin, jo ndarjen, nga ajo kulturë që ngjizi ndërgjegjen kulturore europiane, nga ajo kulturë që lindi para se të krijoheshin shtetet kombëtare, para se të lindte urrejtja, duke shprehur mospëlqim dhe mospërkrahje për nacionalizmin, të veçimit me mure dhe ndarjes në kampe.



Lidhur me diversitetin kulturor europian, perspektivën e letërsisë europiane dhe "europianizmin", dr. Arian Leka u ndal në rastin Stefan Zweig dhe rastin Milan Kundera.

Ku takim u prit me shumë kënaqësi nga nxënësit e gjimnazit "Sami Frashëri", të cilët i drejtuan pyetje të shumta për idenë europiane, mbi krijimtarinë, për mënyrën e shkrimit, mbi të qenit qytetar europian, mbi "të harruarit nga Europa" dhe mesazhet që morën përmes leximit të fragmenteve nga vepra letrare e dr. Arian Lekës.

Vetë gjimnazistët përcollën gjatë diskutimeve të mëtejshme mesazhe shprese për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, duke e përfytyruar atë jo të idealizuar,

si vizion i rilindësve, por si realitet i prekshëm, që ka detyrimet e veta dhe shprehën idetë e tyre për zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës dhe traditave më të mira në vendin tonë, të cilat na kanë përfaqësuar me dinjitet në Europë dhe për të punuar për zhvillimin e mëtejshëm të vendit.

Në fund të këtij takimi drejtoresha e gjimnazit “Sami Frashëri”, znj. Majlinda Ziu, përgëzoi autorin Arian Leka dhe u shpreh se takimi i sotëm pati vlerë të dyfishtë për edukimin e gjimnazistëve për të folur në publik dhe qasjen e bashkëpunimeve individuale në kulturën letrare, filozofike dhe më gjerë, duke na bërë të vetëdijshëm mbi ato që mbeten si pritshmëri dhe ideale dhe realitetet e sotme, që jo gjithmonë u zgjidhën drejt dhe në kohën e duhur.

Shkrimtari Arian Leka falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe përfshirjen në diskutime, debate dhe ide dhe theksoi se Dita e Autorëve Europeanë (DoEA) është nismë e Komisionit European, që synon të rilidhë brezat e rinj me autorët, leximin e librave, për t'i ndihmuar ata të zbulojnë diversitetin e letërsisë europiane, duke theksuar se Europa i do librat!

Dr. Arian Leka është autor i shumë librave me poezi, prozë, ese dhe studime letrare mbi realizmin socialist në Shqipëri dhe traditën letrare shqiptare. Veprat e tij janë nderuar 6 herë me çmime kombëtare nga Ministria e Kulturës dhe Shoqata e Shkrimtarëve, si dhe me 3 çmime të tjera ndërkombëtare për letërsinë.

Krijimtaria e Arian Lekës, në prozë dhe poezi, është përkthyer në anglisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht, italisht, anglisht, polonisht, greqisht, rumanisht, serbisht, boshnjakisht, kroatisht, sllovakisht, maqedonisht, sllovenisht në gjuhën malazeze etj.

U zhvillua mbledhja e redaksisë së trashëgimisë e identitetit në kuadër të hartimit të Enciklopedisë shqiptare

Mbledhja u zhvillua sot më 25 mars 2024 nën drejtimin e zëvendëskryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Vasil Toles.

Ishin të pranishëm antarët e redaksisë prof. Afërdita Onuzi etnografe, prof. Pirro Misso etnomuzikolog dhe Artan Shkreli, arkitekt.

Mbledhja u zhvillua në kuadër të udhëzimeve të redaksisë qendrore dhe redaksive vendore, për të hartuar fjalësin dhe për të caktuar autorët e hartimit të zërave.

Anëtarët e redaksisë sipas fushave përkatëse dhanë sugjerime për fjalësin dhe bënë propozime për autorët e mundshëm të tyre, duke hedhur një hap para në plotësimin e detyrimeve për hartimin e një fjalësi të plotë dhe koherent, bazuar në studime të gjera shkencore.



Enciklopedia shqiptare, një ndër tri projektet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ka hyrë në fazën e saj më të vrullshme.

Brenda këtij viti do të hartohet fjalësi enciklopedik, duke përfshirë kategorizimin e artikujve enciklopedikë sipas rëndësisë e madhësisë së tyre, e duke u përzgjedhur njëherazi edhe autorët e artikujve.

Synimi është që puna për hartimin e artikujve enciklopedikë të fillojë brenda vitit 2024.

Ky projekt albanologjik me rëndësi kombëtare po realizohet në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

110-vjetori i Shqipërisë principatë (mars-shtator 1914)

- Përkujtohet roli i princit Wilhelm von Wied, në përpjekjet e tij për mëkëmbjen e vështirë të shtetit të ri shqiptar



Në kuadër të nismës së saj për përgatitjen dhe botimin e një historie tjetër të shqiptarëve dhe në përvjetorin jubilar të Shqipërisë-principatë, Akademia e Shkencave organizoi sot tryezën shkencore kushtuar periudhës gjashtëmujore të historisë së Shqipërisë nën kurorën e një sovрани europian, me princin e mandatuar prej Fuqive të Mëdha Wilhelm von Wied.

Akad. Gëzim Hoxha, kryetar i SSHSHA, përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se periudha në vëmendje të historianëve në tryezën e sotme përbën një hallkë të rëndësishme historike të rrugës së pavarësisimit të Shqipërisë, të orientimit të saj gjeopolitik, prej Shpalljes historike të Pavarësisë më 28 nëntor 1912, deri në konsolidimin e njohjen ndërshtetërore në vitin 1920. Duke falënderuar studiuesit për pjesëmarrjen në këtë veprimtari, akad. Hoxha theksoi se Akademia e Shkencave ka ndërmarrë dhe po realizon projektin “Histori e shqiptarëve” dhe se sundimi i Wied-it si princ përbën një sekuençë shumë interesante në këtë histori. Kohën gjatë së cilës Wied-i qëndroi në Shqipëri akad. Hoxha e vlerësoi si një periudhë me rëndësi historike, që karakterizohet nga përpjekje shumë të mundimshme për të arritur pavarësinë; përpjekje për shkëputje nga Orienti dhe shikimin nga Perëndimi; për përballimin e synimeve dhe përpjekjeve aneksuese të fqinjëve, kur vendi gjendej në situatë ekonomike, historike dhe politike

mbijetese.



Akad. Marenglen Verli mbajti kumtesën “Opinione të Wied-it për Shqipërinë dhe shqiptarët”. Ai u shpreh se se princ Wied-i ishte i zgjedhuri i gjashtë Fuqive të Mëdha për të drejtuar principatën shqiptare në kufijtë politikë të njohur prej tyre. Në zbatim të vendimit për Shqipërinë në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (29 korrik 1913), më 7 mars 1914 princ Wied-i dhe “Qeveria definitive” e krijuar prej tij, përveç problemeve të shumta të brendshme që duhej të zgjidhnin, kishin detyrimin madhor të ndërtonin shërbimin e jashtëm e të përcaktonin përparësitë politike në marrëdhëniet me botën. Ai foli më tej edhe për çështje të njohjes ndërkombëtare të kësaj qeverie, që u pranua nga Fuqitë e Mëdha si e para qeveri përfaqësuese e shtetit të pavarur shqiptar. Verli theksoi se princ Wied-i u kërkoi Fuqive të Mëdha njohje, bashkëpunim dhe mbështetje, për të kontribuar në konsolidimin jashtë vendit të pozitës së shtetit të ri, duke përmendur ndër të tjera dhe marrëdhëniet diplomatike të Shqipërisë me Serbinë, qeverinë bullgare e më gjerë.



Prof. Ksenofon Krisafi analizoi pozitat juridiko-ndërkombëtare të “principatës

shqiptare” të Wied-it në kontekstin e kohës, kur Shqipëria ende shihej si një plaçkë në duart e Fuqive të Mëdha. Ai u ndal te vështirësitë dhe mënyra sesi kjo principatë u pa nga studiuesit e huaj. Prania e princ Wied-it në Shqipëri është një realitet që nuk duhet të hiperbolizohet as të sfumohet, tha ai. Wied-i duhet vlerësuar duke e parë në kontekstin e zhvillimeve brenda dhe jashtë vendit, në kushtet e vështira që kishin të bënin me Shqipërinë e asaj kohe, me politikat aneksioniste të fqinjëve dhe me qëndrimet e paqarta dhe madje antishqiptare prej Fuqive të Mëdha. Wied-i erdhi të mbretëronte brenda kufijve të mikroshtetit që kishin pranuar Fuqitë e Mëdha, të cilat e përdorën Shqipërinë për të vendosur disa ekuilibre të caktuar në interes të tyre në Ballkan, prandaj e përgjysmuan si nga pikëpamja e territorit, ashtu edhe nga pikëpamja e numrit, tha prof. Krisafi.



Prof. Romeo Gurakuqi mbajti kumtesën “Pavarësia e parë e Shqipërisë dhe vendi i principatës së princit Wilhelm Wied në lindjen e shtetit modern”. Ai paraqiti përkufizimin, përmbajtjet dhe kronologjinë e dhjetëvjeçarit që fillon nga shpallja e Pavarësisë me 28 nëntor 1912 deri në rinjohjen ndërkombëtare të Shqipërisë më 9 nëntor 1921, në aspektin e ekzistencës shtetërore, politiko-institucionale dhe njohjes ndërkombëtare. Sipas prof. Gurakuqit, tri janë ndarjet e dekadës 1912-1921: 1. Pavarësimi i parë dhe njohja e parë ndërkombëtare e shtetit: 28 nëntor 1912 - 3 shtator 1914; 2. Shqipëria në luftën e madhe: dezintegrimi i shtetit nacional, kushtetues, laik dhe europianist; 5 shtator 1914 - 30 tetor 1918; 3. Pavarësimi i dytë dhe njohja e dytë ndërkombëtare: 25 dhjetor 1918 - 9 nëntor 1921. Secila periudhë u paraqit nga autori në planin e brendshëm, sipas veprimit për një Shqipëri nacionale, kushtetuese, laike dhe gjithëpërfshirëse nga njëra anë, dhe të së kundërtës së saj, Shqipërisë si zgjatim i ish-Perandorisë Osmane, për rrjedhojë, otomaniste, esadiste, të vogël dhe jo vitale. Periudha e principatës (mars-shtator 1914) nuk duhet të shkëputet nga i gjithë procesi i ngritjes dhe rënies së Shqipërisë, nga 28 nëntori 1912 drejt 3 shtatorit 1914, para Luftës së Parë

Botërore, - tha ndër të tjera prof. Gurakuqi. Principata e Shqipërisë nuk ishte sipërmarrje individuale dhe as një organizëm artificial i implantuar nga fuqitë imperialiste, por është pjesë integrale e procesit të shtetformimit, është materializim i vendimit të Fuqive të Mëdha mbi shtetin, kushtetutën e brendshme, pozicionin ndërkombëtar të tij.

Prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi paraqiti profilin e princ Wied-it në këndvështrimin e dokumentacionit arkivor gjerman dhe mënyrën sesi shihet qeverisja e tij dhe personazhet politikë nëpërmjet shtypit gjerman e më gjerë. Deri në momentin që do të zgjidhej nga Fuqitë e Mëdha, me propozim të Austro-Hungarisë dhe të Italisë, Wilhelm von Wied ishte kapiten i kavalerisë gjermane dhe shërbente në Potsdam, në një kazermë shumë të njohur, ku mblidheshin kryesisht aristokratët gjermanë të asaj kohe. Vinte nga një familje relativisht e njohur në historinë gjermane, por që me kalimin e viteve e kishte humbur shkëlqimin e saj dhe u ribë e njohur pikërisht në momentin që po përflitej për t'u zgjedhur si princ i Shqipërisë.



Arsyet pse do të zgjidhej princ Weid-i janë interesante. E parë është se ndërmjetësja kryesore në këtë zgjedhje ishte halla e tij, mbretëresha e Rumanisë, që vinte nga familja Wied dhe që ndikoi në këtë zgjedhje. Politikisht arsyet për zgjedhjen e tij ishin kryesisht pragmatiste. Vinte në krye të kurorës një person që nuk ishte i njohur nga fusha politike, nuk kishte ambicie dhe asnjë lloj ndikimi, - tha Kasmi, duke argumentuar më tej se Gjermania, si atëherë, por edhe më vonë, ishte neutrale sa u përket interesave me Shqipërinë. Një arsye tjetër për zgjedhjen princ lidhet me faktin se ai ishte protestant, nuk i përkiste asnjërës prej tri përkatësive kryesore fetare në Shqipëri dhe si i tillë mendohej se do të ishte i paanshëm. Austro-Hungaria dhe Italia mendonin se do ta kishin më lehtë në kontroll gjatë kohës që do të mbretëronte në Shqipëri. Zgjedhja u pranua dhe nga fuqitë e tjera mëdha, pavarësisht se ishin 20 kandidatura të tjera të mëdha që qarkullonin për këtë kurorë të re të rëndësishme. Weid-i e pranoi duke ngurruar dhe duke vënë si kusht kryesor një mbështetje financiare që do të merrte nga Fuqitë e Mëdha. Është një

person që hyn vrullshëm edhe në jetën politike gjermane, sepse në momentin kur u mor vendimi tërhoqi vëmendjen dhe në shtypin gjerman të kohës dhe në politikën gjermane dhe për më tepër në Shqipëri ku pritej me shumë interes. Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913 u vendos që Shqipëria të shpallej një principatë e pavarur dhe jo një mbretëri, tha në përfundim prof. Kasmi.

Akad. Aurela Anastasi dhe dr. Erind Mërkuri paraqitën kumtesën “Përpyjekjet për reformimin e sistemit të drejtësisë gjatë principatës së Shqipërisë dhe ndikimi vijues në reformat gjyqësore”, mbështetur në materiale të reja arkivore. Përmes kësaj kumtese autorët analizuan dispozitat e Statutit Organik të Shqipërisë (1914) në lidhje me organizimin gjyqësor, si dhe Kanunin për gjykatat e drejtësisë në Shqipëri (qershor 1914). Ky i fundit shfuqizonte “Kanunin e zhurisë” që ishte miratuar nga Qeveria e Vlorës në maj të vitit 1913. Kanuni i Principatës parashikonte një organizim gjyqësor të ri, si dhe kompetenca lëndore përkatëse, të cilat ndikuan në vijimësi në organizimin gjyqësor të vendit. Autorët treguan përmes dokumenteve të gjetura se ky Kanun u rishpall si një ligj i zbatueshëm më 1919, duke shërbyer për organizimin e gjykatave në Shqipëri pas Luftës I Botërore. Letër-gjykimet (vendimet e gjykatës) i gjejmë edhe në vijim, theksuan referuesit, së paku deri në organizimin gjyqësor të vitit 1921. Autorët arritën në konkluzione të rëndësishme që dëshmojnë nevojën për studime më të thelluara mbi historinë e të drejtës në Shqipëri.



Akad. Shaban Sinani mbajti kumtesën “Kronikë në letërsi - koloneli Thomson”. Sipas tij, personaliteti i kolonel Thomson-it, në vlerësimin e shqiptarëve, ka kaluar nëpër tri faza: 1. Faza e hyznizimit, ditirambit, monumentalizimit, kthimit në shëmbëlltyrë të albanofilisë dhe të flijimit për shqiptarët (periudha 1912-1939), së cilës i përket edhe poezia “Thomsoni e kuçedra” e Fan Nolit, fjalimi në frëngjisht i Faik Konicës në ceremoninë e përcjelljes (jo të varrimit, sepse koloneli u përcoll për t'u prehur në

vendlindje), poezitë e Asdrenit dhe vlerësimet e Fishtës (për të përmendur vetëm më të rëndësishmit); 2. Periudha e heshtjes, mënjanimit, qortimit, madje dhe e heqjes së gurit me shkrimin lëvdues: jo aq pse ajo shenjë kujtese ishte ngritur në periudhën e monarkisë; aq më pak për shkak të zbulimit të ndonjë të reje të rëndësishme kundër rolit të tij pozitiv; pjesërisht sepse qëndrimi zyrtar i asaj periudhe, duke përfshirë princin Wied, ishte krejtësisht kritik; 3. Periudha e ringritjes, pas viteve 1990, që është njëherësh edhe periudhë e rivlerësimit të Shqipërisë principatë gjatë gjysmë viti të sundimit të princit Wied. Nuk është një përsëritje e receptimit të parë, por një rikonfirmim i kujdesshëm. Pati ndikim edhe përsëritja e së njëjtës situatë në Kosovë, me qeverisjen ksenokratike në vitet e fillimit dhe më pas me praninë e misionëve diplomatike dhe të faktorit ushtarak ndërkombëtar. U ringrit monumenti i kolonelit Thomson në Durrës, por pati dhe qortime për krijimin e një "miti të rremë".



Akad. Sinani vuri në dukje se dy genë arsyet e veçanta pse ndryshoi qëndrimi ndaj kolonelit Thomson gjatë periudhës ideokratike: Së pari, sepse ajo që u quajt si "kryengritje e Shqipërisë së Mesme", që kishte në krye Haxhi Qamilin dhe Musa Qazimin, u shpall nga vetë E. Hoxha si lëvizje popullore përparimtare, sepse, siç u tha dhe u shkrua, populli intuitivisht kuptoi atë që Ismail Qemali nuk arriti ta kuptonte, që një Shqipëri nën mbrojtjen e Turqisë ishte më e sigurt se ajo "e mosvarmja". Veç shumë fakteve të njohura, që provojnë se për hir të vlerësimit pozitiv të "dumbabistëve", nuk mund të lartësohej figura e Thomson-it, historiani A. Hoxha ka vërejtur edhe një detaj nga fati i poezisë "Thomsoni dhe kuçedra" për këtë: kjo poezi midis viteve 1944-1987 nuk u botua ndonjëherë pikërisht se fryma e saj shkonte kundër pikëpamjes së E. Hoxhës për zhvillimet e vitit 1914. Në fakt, në "Albumin" e Nolit (1958) kjo poezi u përfshi, por me

një strofë mangut. Arsyeja pse A. Zogu rezervoi një farë respekti formal ndaj kolonelit Thomson mund të ketë lidhje me faktin që Thomsoni i shërbeu Shqipërisë në një periudhë kur, sido që principatë, nënshtet, kishte rëndësi për të si precedent për të përligjur rikthimin tek kurora e trashëgueshme, tashmë si mbret, në kohën kur edhe Turqia sulltanore po kthehej në republikë. E pashpjegueshme është pse edhe ndonjë prej ministrave të qeverisë së Ismail Qemalit, jo vetëm iu bashkua “Pleqësisë esadiste të Durrësit”, por qenë shprehur gjithashtu se "kryengritja e Shqipërisë së Mesme" (“Ehli Kijami”, siç e quanin drejtuesit e saj), ishte një lëvizje popullore pozitive për pavarësinë e Shqipërisë; një përlijje e tërthortë e vrasjes së kolonelit.

Akad. Vasil Tole mbajti një kumtesë origjinale, që pasqyron veçanërisht aspektin kulturor të qeverisjes së princ Wied-it: “Princ Wied-i, mbreti me himn dhe me marsh muzikor”. Akad. Tole tha se princ Wied-i dhe princesha Sofia ishin në aspektin kulturor e intelektual përfaqësuesit më emblematikë europianë në Shqipërinë që sapo kishte dalë nga Perandoria Otomane. Me gjak fisnik, të shkolluar e zotërues të gjuhëve, të pasionuar pas arteve e muzikës, ata reflektuan me sjelljen e tyre, në fund të fundit me atë që ishin në të vërtetë, modelin më ideal të drejtuesve për qeverisjen e Shqipërisë (që ata e quanin “Atdheu i ri”), ndoshta jo më pragmatikët, por të duhurit. Në takimin që princ Wied-i kishte pasur me perandorin gjerman para ardhjes në Shqipëri, i kishte pohuar se ai e shikonte këtë detyrë si një sfidë dhe se ishte përzgjedhur të ishte realizuesi i një misioni kulturor për një vend tepër të pacivilizuar. Edhe gruaja e Wied-it ishte shumë entuziaste për këtë projekt dhe mezi priste të vinte në Shqipëri e të fillonte punën për civilizimin e vendit.



"Muzika si inteligjencë emocionale" e Eno Koços

- Lectio magistralis me Eno Koçon, muzikolog, profesor, dirigjent e anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave, me moderimin e akad. Stefan Çapalikut

Një artist i talentuar e mbjell vetë kohë pas kohe me punë e vepra farën e suksesit. Asgjë nuk lind nga hiçi. Ndaj, Eno Koço ka besuar dhe beson se muzika është shprehëse e denjë e inteligjencës emocionale.

Dhe ishte sot rasti për ta thënë.

Në orën 11.00 në sallën "Aleks Buda" në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Qendra e Studimit të Arteve pranë ASHSH organizoi një lectio magistralis me titullin "Muzika si inteligjencë emocionale" me Eno Koçon, muzikolog, profesor, dirigjent e anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave.



Ishin të pranishëm Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, zëvendëskryetari, akad. Vasil Tole, anëtarë të Kryesisë së Akademisë së Shkencave, artistë e instrumentistë të njohur dhe studentë të muzikës.

Veprimtarinë e moderoi akad. asoc. Stefan Çapaliku, drejtor i Qendrës së Studimit të Arteve.

Eno Koço, bir i muzikantëve Kristo Koço dhe Tefta Tashko rrëfeu udhëtimin e tij në rrugën e muzikës. Nisi në moshën 7- vjeçare të studiojë violinë në Liceun Artistik të Tiranës, më vonë në Leningrad, dhe pastaj u diplomua në Institutin e Lartë të Arteve të Tiranës, më 1966-n. Pas përfundimit të studimeve për dirigjim më 1977-n, emërohet dirigjent i Orkestrës Simfonike të RTVSH. Më pas drejtoi Orkestrën Simfonike të Kajros në Egjipt (1986) dhe u atashua pranë Orkestrës RAI dhe Operës Regio të Torinos (1989).

Eno Koço rrëfeu për jetën midis Anglisë dhe Shqipërisë, që nga viti 1992, me një veprimtari të pasur si dirigjent, muzikolog dhe profesor.

Akad. Stefan Çapaliku e pyeti akad. Eno Koçon për lidhjen me muzikën, a lindi ajo si dashuri prindërore e munguar.

Eno Koço, prindërit e të cilit u ndanë nga jeta kur ai ishte 5 vjeç, rrëfeu se lidhja e rrugëtimit të tij në fushën e muzikës është ndikuar nga miqtë e prindërve dhe të afërmit, të cilin e regjistruan për të studiuar violinë, ku ai më pas ndjeu se nuk kishte aq shumë talent për të luajtur në këtë instrument dhe nisi një tjetër rrugëtim të madh në botën e muzikës, duke u bërë një nga dirigjentët më të shquar shqiptarë.



Eno Koço shpjegoi se u bë artist nga dashuria e thellë për muzikën, por nga ana tjetër dashuria e munguar prindërore i ka ardhur e shpërblyer nga intelektualë të shquar të kohës së prindërve të tij, si Mitrush Kuteli, Lasgush Poradeci, Aleks Buda, Gaqo Tashko, e të tjerë, të cilët vlerësonin kontributin e Kristo Koços dhe Tefta Tashkos në muzikën shqiptare dhe ndikuan në ndërgjegjen e artistit të ri për ta përfaqësuar me dinjitet këtë muzikë. Madje dashuria për muzikën është trashëguar tek fëmijët dhe nipërit e mbesat.

Eno Koço pohoi se njësoj si prindërit e tij, të cilët i dhanë zë muzikës tradicionale shqiptare me regjistrimin në studiot më të famshme europiane, është i lidhur me traditën; një lloj anakronizmi që nuk rrjedh aq nga dëshira për t'u kthyer pas në kohë, por pikërisht nga akumulimi i përvojës së tij muzikore, përjetimi i veprave muzikore, duke e përcaktuar në fund të fjalës muzikën si inteligjencë shpirtërore, pavarësisht nga vendi apo koha kur ajo krijohet.

Akad. Stefan Çapaliku bashkëbisedoi gjatë kësaj veprimtarie edhe për veprat artistike të Eno Koços në fushën e muzikologjisë.

U diskutuan botimet shqip dhe anglisht në fushën e muzikologjisë siç janë traktati

“Orkestrimi”, në bashkëpunim me Gjon Simonin, dhe librat “Tefta Tashko Koço dhe koha e saj”, “Kënga lirike qytetare shqiptare në vitet 1930”, “Kënga karakteristike korçare”, “The Albanian Urban Lyric Song in the 1930s”, e të tjera.

Më tej rrëfimi rrodhi në vitet e fundit të karrierës së tij.

Eno Koço pas stabilizimit në Angli, paralelisht me orkestrat anglo-irlandeze, ka mbajtur lidhje të përhershme me orkestrat dhe koret e Shqipërisë, ka dirigjuar në Orkestrën Kombëtare të Tiranës, ka mbajtur dhe mban komunikime shkencore në universitetet e Europës, duke afirmuar vlerat muzikore shqiptare, dhe ka promovuar muzikën e kompozitorëve britanikë në Tiranë, duke i afruar artistët dhe publikun shqiptar me vlerat e larta të muzikës botërore.

Në fund të bisedës me akad. Çapalikul, të pranishmit i bënë pyetje dhe diskutuan me Eno Koçon për çështje të muzikës shqiptare dhe asaj botërore, si dhe për lidhjet e muzikës me poezinë, e më gjerë.



Eno Koço mban gradën doktor në filozofi (fituar në Universitetin e Leeds-it, 1998), me temën “Kënga lirike qytetare shqiptare në vitet 1930” dhe titullin profesor i asociuar dhënë nga Akademia e Arteve të Tiranës (2005).

Kritika profesionale ka analizuar me hollësi veprimtarinë interpretative dhe studimore të Eno Koços, e pasqyruar në mediat e Shqipërisë, Anglisë dhe Amerikës. Libri i tij “Kënga lirike qytetare në vitet 1930” jepet për referencë në 102 universitete të botës, kryesisht të SHBA.

Në fushën e diskografisë kontributet e tij shënohen me emetimin fillimisht të 10 CD-ve dhe së fundi edhe 18 CD-ve të tjera, në të cilat pasqyrohet kultura muzikore shqiptare nëpërmjet regjistrimeve me OSRSH gjatë viteve 1978–2018. CD-të janë prodhuar në Shqipëri, Angli dhe Rusi. Eno Koço paraqitet në edicionet “Fjalori enciklopedik shqiptar”, “Who’s Who in the World”, IBC, Cambridge (Qendra Biografike

Ndërkombëtare), ABI (Instituti Biografik Amerikan).



Bisedën e plotë e ndiqni në këtë link:

<https://www.youtube.com/watch?v=L26370-YW-I>

Botime të reja

"Kulturë e shkrimit shqip me alfabet greqisht"



Profesor Bardhyl Demiraj, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave, boton nën këtë titull studimet e tij për shkrimet e dorëshkrimet me tekste shqip shkruar me alfabetin e greqishtes.

Në vëmendjen e autorit janë shkrime të njohura e të panjohura në gjuhën shqipe me shkronja të greqishtes duke filluar nga dorëshkrimi shqip i Bibliotekës Ambrosiana të Milanos; dorëshkrimi shqip i Manastirit të Trinisë së Shenjtë në ishullin Halki;

mbishkrimet shqip dhe arumanisht në Manastirin e Ardenicës; Fjalori trigjuhësh i Kavaliotit dhe tekstet shqip e arumanisht në Kodikun e Kostë Cepit-Vithkuqarit.



Fragmentet e shqipes së shkruar nëpër dorëshkrime heteroglore, prej shekullit XV deri në shek. XIX, autori i ka kërkuar në biblioteka e arkiva, i ka vënë në kronologji, si dhe ka bërë përshkrimin arkeografik e bibliografik. Në të gjitha rastet paraprin historiku i dorëshkrimit në kontekstin kulturor-fetar, çështje të autorësisë, të burimit të tekstit nga gjuhë të tjera (greqisht, latinisht etj.); të rendit gjuhësor dhe të përkatësisë dialektore; të paleografisë dhe grafematikës, si dhe të ilustrimeve (figurative, muzikore); të liturgjisë (në rastin e shkrimeve ungjillore); të përdorueshmërisë (rasti i fjalorëve); të vijueshmërisë së traditës shkrimore përmes shkronjave greqishte; të pranëgjendjes (biglosisë, triglosisë) së shkrimeve në shqip, greqisht e arumanisht; të shkrimit shqip si romantizëm gjuhësor e kulturë iluministe.

Autori ka realizuar transkriptimin dhe tejskrimin e teksteve (disa herë alternative ndaj transkripteve të mëhershme), duke stabilizuar kodin grafematik, si dhe duke bërë vlerësimin gjuhësor e hermeneutik. Nuk mungojnë të dhënat për autorët (Kostë Cepi-Vithkuqari, Nektar Tërpo, Teodor Kavalioti); për dukuritë sunduese të kohës; për autoritetin e kishës në historinë e shkrimeve shqip. Disa nga shkrimet shoqërohen e riprodhime diplomatike-anastatike të origjinalit ose riprodhime të fac-simileve. Me shumë rëndësi është studimi i fjalësit shqip dhe konkordancave. Studiuesi ndjek metodën e filologjisë kritike, shoqëruar me gjenetikë tekstore, gjithnjë me praninë e të dhënave të përgjithshme historiografike dhe kulturologjike.

"Fjalë pa nota", libër i ri me artikuj e studime nga Vasil S. Tole, botim i
Akademisë së Shkencave

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

Vasil S. Tole

Fjalë pa nota

(muzikë, folklor, art, trashëgimi)

Tiranë, 2023

- Krijime të larmishme në lloje e tipologji; të lidhura me historinë e muzikës shqiptare dhe protagonistët e saj (themeluesit e operas, simfonisë, baletit, koncertit orkestral, këngës dhe gjinive të tjera); me brezin e dytë të shkollës shqiptare të muzikës (kompozimit, ekzekutimit, interpretimit); me zhvillimet bashkëkohore në muzikën e sotme

Libri përmban pesë kapituj: "Muzikë, art dhe kulturë"; "Muzikë, art, kulturë dhe

shkencë", "Trashëgimi"; "Nderim artistëve dhe studiuesve"; "Për botimet muzikore, libra dhe CD".

Autori nderimin e parë ua kushton profesorëve dhe mjeshtrave që kanë lënë gjurmë në formimin e tij, para së gjithash atyre të shkollës shkodrane (Çesk Zadeja, Tish Daija, Prenk Jakova, Pjetër Gaci); figurave të rëndësishme të krijimtarisë muzikore gjatë viteve 1930 e më pas; kompozitorëve e instrumentistëve të formuar në shkollën shqiptare; si dhe studiuesve të mëhershëm e të sotëm të kësaj trashëgimie, kolegë të tij, formues të brezave të rinj të artistëve dhe studiuesve. Një libër ku tek autori njeriu i kërkimit dhe njeriu i krijimit nuk mund të ndahen.



Vend më vete zënë studimet që lidhen me nismat e autorit për promovimin ndërkombëtar të trashëgimisë shqiptare përmes programeve e listave të UNESCO-s (eposi heroik dhe lahuta, isopolifonia, përvojat e mira si FFK).

Në një kapitull tjetër janë përfshirë recensionet, oponencat, hyrjet e parathëniet për libra të kolegëve, fjalë të mbajtura në përurime dhe në ceremoni, përshëndetje, diskutime. Ndërthuren e alternohen paraqitja e rezultateve të kërkimit shkencor, të krijuesit në muzikë, me publicistikën shkencore dhe ligjërimin për një lexues të gjerë.


Libri paraqet interesat e shumanshëm të autorit po aq sa dhe kontributet në detyrat

që ka kryer e kryen, si drejtues, anëtar komisionesh e bordesh krijimtarie, anëtar jurish, pjesëmarrës në skuadra shkencore, me rol vetjak në nisma kulturore, me pozicione zyrtare për çështje të ligjshmërisë në fusha të muzikologjisë, folklorit, trashëgimisë kulturore. Kjo shpjegon faktin e ndërlidhjes së një pjese të artikujve me kalendarët kulturorë, me përvjetorë e jubilenj, me jetën skenike bashkëkohëse, me dukuritë e reja në muzikë, me botimet dhe diskutimet, me kronikën e kohës.

Libri është i dobishëm për të gjithë ata që janë të interesuar për historinë e muzikës shqiptare, periodizimin dhe protagonistët, infrastrukturën e veprimtarisë së individëve dhe institucioneve që veprojnë në këtë fushë, njerëzit që kanë dominuar skenat, jehonën e artit të tyre në shtyp; duke marrë vlerat e një arkivi selektiv të kujtesës muzikore.



"Wilhelm zu Wied dhe Shqipëria: mars-shtator 1914"



- Një libër për Shqipërinë gjatë periudhës prej një gjysmë viti si principatë ksenokratike, me autor historianin Marenglen Kasmi

- Botim i sapodalë nga shtypi, i Akademisë së Shkencave - së shpejti një tryezë shkencore e organizuar prej saj për këtë periudhë

- Studim i mbështetur në burime të arkivave federale gjermane në Berlin të këshilluara nga autori gjatë qëndrimi studimor disamujor në Institutin e Historisë Ushtarake të Potsdamit

- E para vepër me burime të plota parësore dhe me një studim të thelluar historiografik për

Shqipërinë principatë, siç u njoh në vitin 1913

"Përmbajtja e dokumenteve që pata në duar në dy dosjet për Shqipërinë nën Princin Wied ishte befasuese, shkruan autori në studimin hyrës. Në to gjendeshin artikuj të gazetave gjermane të kohës, ku shkruhej vetëm për Shqipërinë. Madje, arkivistët, gjatë përpunimit të dokumentacionit, ishin kujdesur t'i radhisnin artikujt kronologjikisht, ditë pas dite.

Bëhet fjalë për disa qindra artikuj të madhësive të ndryshme. Gazetarët gjermanë shkruanin nga Durrësi e Vlora për situatën në Shqipëri në vitet 1913-1914, kur shqiptarët ishin në pritje të princit Wilhelm zu Wied, që Fuqitë e Mëdha u kishin caktuar në krye të shtetit të tyre të ri".



Kjo ngjarje ishte mjaft intriguese për lexuesit gjermanë. Një princ gjerman, ndonëse paksa i rënë nga vakti, po dërgohej si sundimtar në një vend krejt të padëgjuar, si Shqipëria. Kështu që, të gjitha gazetave gjermane u kujdesën t'i dërgonin gazetarët e tyre "në këtë vend të panjohur e të pazhvilluar". Nga ana tjetër, njoftimet që vinin prej Shqipërisë ishin të rëndësishme edhe për politikën gjermane të kohës. Nuk duhet harruar që bëhet fjalë për një periudhë kur shtypi orientonte ende politikëbërjen, paçka se është

e vështirë të vlerësohet masa e ndikimit të tij në këtë proces.

Vlera historike e këtij dokumentacioni është shumë e madhe. Në të gjenden vlerësime të situatës së përgjithshme të Shqipërisë pas Shpalljes së Pavarësisë; për problemet politike, ekonomike, sociale e kulturore që kalonte vendi, raportet e tij me vendet fqinje. Më tej, në to raportohet në kohë reale mbi ngjarje të rëndësishme duke u pasqyruar këndvështrimi i personazheve historike, si Ismail Qemali, Esad pashë Toptani, Turhan pasha etj. Sigurisht që në qendër të vëmendjes qëndronte princ Wied-i.

Deri tani, si dokumentacion të kësaj natyre për historinë e Shqipërisë në fillimshkullin XX njihet vetëm "korrespondenca shqiptare" e Leo Freundlich, një publicist austriak, i cili, duke filluar prej muajit korrik 1913 e deri në gusht të vitit pasardhës, mbledhte çdo ditë artikujt e shtypit që flisnin për Shqipërinë.



Shtypi gjerman jo vetëm që e plotëson dokumentimin e kësaj periudhe, por vjen në një formë edhe më të plotë. Ai mbulon me njoftime një periudhë kohore plot dyvjeçare, nëntor 1913-nëntor 1915, ndërkohë që "korrespondenca shqiptare" e Freundlich ka pasqyruar një periudhë prej diçka më shumë se një viti, korrik 1913 - gusht 1914.

Meqenëse qeveria gjermane nuk kishte interesa të drejtpërdrejta në Shqipëri, shtypi gjerman ishte në gjendje të vepronte më i pavarur e të shkruante më i pandikuar, çka ndoshta nuk mund të thuhet për shtypin austro-hungarez apo edhe atë italian, duke ditur interesat e këtyre vendeve në Shqipëri e më gjerë në Ballkan.

Këto shkrime të shtypit gjerman të kohës përbëjnë dokumentimin më të plotë për

historinë e Shqipërisë në vitet 1913-1915. "Për të provuar besueshmërinë e këtyre informacioneve, duke iu referuar ngjarjeve kryesore të ndodhura në këtë periudhë, si arrestimi i Esad pashës nga princ Wied-i, kryengritja e Shqipërisë së Mesme etj., i kemi krahasuar ato edhe me burimet arkivore të arkivit politik të diplomacisë në Berlin, shkruan autori, dhe përputhshmëria e informacionit është mjaft e madhe".

Vëllimi është përgatitur në kuadër të 110-vjetorit të ardhjes së princ Wied-it në Shqipëri, duke u përqendruar në burimet arkivore gjermane për këtë periudhë, kryesisht në këtë dokumentacion të ri.

Në kreun e parë gjendet studimi hyrës për periudhën e Wied-it, që autori e ka quajtur "Ksenokracia e një princi gjerman në Shqipëri". Në të trajtohen arsyet e zgjedhjes së Wied-it si sundimtar i Shqipërisë, marrëdhëniet e tij me Esad pashën, kryengritja e Shqipërisë së Mesme, shkaqet e dështimit të qeverisjes së Wied-it në Shqipëri e deri te problemet e Wied-it me drejtësinë pas Luftës së Parë Botërore etj.


Në kreun e dytë, që është edhe pjesa më e rëndësishme e këtij botimi, jepen artikujt e shtypit gjerman të kohës: rreth 50 artikuj që trajtojnë periudhën kohore janar - maj 1914. Metodologjia e ndjekur për zgjedhjen e tyre është bazuar në rëndësinë e ngjarjeve, duke ndjekur kronologjinë e zhvillimit të tyre.

Risjellja e refleksioneve të princ Wied-it për Shqipërinë në kreun e katërt të këtij botimi e ndihmon lexuesin të krijojë një tablo më të plotë historike për këtë periudhë. Me këto refleksione, lexuesi shqiptar është njohur edhe më parë, por kryesisht me përkthime nga gjuha angleze. E veçanta e këtij botimi është se ato sillen për herë të parë të plota dhe të përkthyer nga origjinali në gjuhën gjermane, shtypur nga një manuskript.

Në kapitullin e fundit botohen për herë të parë në gjuhën shqipe kujtimet e sekretarit të dytë në shërbimin diplomatik gjerman, Rudolf Nadolny, mandati diplomatik i të cilit rezultoi një përfaqësim jetëshkurtër, me emrin "Agjencia diplomatike dhe Konsullata e Përgjithshme për Shqipërinë". Agjencia e filloi menjëherë aktivitetin e saj dhe provizorisht ajo u drejtua nga Nadolny. Kur Wied-i mbërriti në Shqipëri, Nadolny ishte i vetmi përfaqësues i shërbimit diplomatik gjerman që ndodhej pranë tij. Kujtimet e Nadolny-t hedhin një dritë mjaft interesante mbi ngjarjet e ndodhura. Krahasimi që u ka bërë autori kujtimeve të tij me raportet zyrtare që ai dërgonte nga Durrësi në Berlin përgjatë vitit 1914 i klasifikojnë ato pa hezitim si një burim i vlefshëm dhe i besueshëm historik.

Libri është botuar me mbështetjen e Fondacionit "Fan Noli".

"Shqipëria në dokumentet amerikane", vëll. I (viti 1945), përmbledhje dokumentesh përgatitur nga Marenglen Verli, Arbër Hadri e Ibrahim Gashi



Tre studiuesit kanë përzgjedhur nga burimet e shumta amerikane për Shqipërinë menjëherë pas mbarimit të Luftës II Botërore 112 dokumente, të gjitha për personalitete dhe ngjarje historike të vitit 1945.

Dokumentet janë botuar në gjuhën e burimit dhe të përkthyer në shqip.

Përgatitësit kanë bërë renditjen sipas kronologjisë, titullimin e dokumentit sipas rregullave klasike, pajisjen me shënjime historike e kulturore.

Burimet paraprihen nga një regjistër analitik i tyre.

Libri ka treguesin emëror, lehtësues për përdorim praktik nga historianët e rinj.

Botimi do të vazhdojë me vëllime të tjera.

"Studime ndërdisiplinare në albanologji", nga Roland Zisi



Libri përmban 17 studime, kryesisht në fushën e studimeve letrare, me karakter historiografik-interpretues, disa prej tyre me karakter krahasues. Përparësi kanë studimet për autorë shqiptarë, por zënë vend edhe shkrimtarë të njohur joshqiptarë (përveç Albert Camus, një grupim i shkrimtarëve frëngjishtshkrues si autori magrebin Tahar ben Jelloun dhe të tjerë si Yasmina Khadra, Salim Bachi etj.).

Paraqesin interes disa çështje specifike të hermeneutikës, që lidhen me letërsinë shqipe, sidomos me tre shekujt e parë të saj, si bilinguizmi (prania e një gjuhe të dytë "sigurie kanonike", autopërkthimet etj.). Në këtë kontekst profili i kolegut të tij Nonda Varfi në pjesën e veprimtarisë si përkthyes është "i privilegjuar" me dy artikuj.

Autori synon ta lexojë letërsinë shqipe "nga majat", dhe këtu çmohen studimet për Naim Frashërin dhe "utopinë e tij atdhetare-romantike"; Dritëro Agolli me "utopinë tjetër", ideologjike; Ismail Kadare me simbolikën e shenjave perandorake në veprën

letrare të "ciklit oriental".



Lidhjet mbiadriatike të letërsisë shqipe, kontaktet pararilindëse të arbëreshëve me tokën e të parëve, misionarët basilianë si zhvillim ekumenik kulturor dhe fetar, janë disa prej interesimeve parësore të autorit.


Bashkëpërkimet ndërbalkanike në letërsi e kulturë trajtohen jo si afëri rastësore, por si rregullsi të krijuara nga fqinjësia e gjatë dhe empatia.

Duket në këtë libër përvoja e gjatë e autorit si studiues i letërsisë romantike të shekullit XIX dhe i dy periudhave të mëvonshme. Risi në këto studime është qasja antropologjike ndaj letërsisë, leximi i saj me kodet e metodës së antropologjisë kulturore.

Libri u shërben programeve të mësimdhënies universitare dhe bashkësisë së studiuesve të letërsisë.



Promovohet në Prishtinë libri me dokumente "Shqipëria në dokumentet amerikane - viti 1945" (vëllimi I)



Përgatitur nga Marenglen Verli, Arbër Hadri dhe Ibrahim Gashi

Veprimtaria u organizua dhe u zhvillua në Institutin e Historisë "Ali Hadri" të Prishtinës

Znj. Teuta Peli, drejtore e Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, tha se botimi i librit "Shqipëria në dokumentet amerikane - 1945" përbën një kontribut me rëndësi për historiografinë shqiptare. "Botimi i këtij libri është edhe një dëshmi se bashkëpunimi mes institucioneve tona (Kosovë-Shqipëri) është në zhvillim gjithnjë e më

i frytshëm" - tha ajo.

Ky libër dy gjuhësh: shqip dhe anglisht, me bashkautorë Marenglen Verli, Arbër Hadri dhe Ibrahim Gashi, përmban dokumente arkivore amerikane të pahulumtuara më herët lidhur me Shqipërinë, pas Luftës së Dytë Botërore (LDB).



Bashkëpërgatitësit e vëllimit pohuan se përmes këtij botimi ofrojnë për studiuesit dokumente arkivore origjinale të panjohura në pjesën më të madhe. Historiani Marenglen Verli, bashkëpërgatitës i librit, tha gjatë fjalës së tij se ky botim përmban dokumente të cilat pasqyrojnë interesimin e Shteteve të Bashkuara për zhvillimet në Shqipëri pas mbarimit të Luftës. "Botimi i këtyre dokumenteve ka rëndësi për të njohur interesimin amerikan për çështjen e shqiptare, si në aspektin historik, ashtu dhe në atë ekonomik e social", pohoi ai.

Ibrahim Gashi, gjithashtu bashkëpërgatitës i vëllimit, foli rreth rrethanave gjeopolitike në të cilat u gjendën Shqipëria dhe shqiptarët pas LDB dhe rreth relacioneve të diplomatëve amerikanë rreth situatës në atë kohë. "Askush më mirë se diplomatët amerikanë nuk e pasqyruan aq qartë synimin e ish-Bashkimit Sovjetik për të shtrirë ndikimin e tij në shumë vendet europiane" - tha ai.


Në vijim Arbër Hadri tha se botimi librit me dokumente "Shqipëria në

dokumentet amerikane - 1945" është me rëndësi të veçantë për historinë e shqiptarëve për trajtimin e ngjarjeve që kanë përcaktuar rrjedhat politike e shoqërore në harkun kohor të pas LDB. Kjo periudhë (1945-1948) dhe qëndrimi amerikan ndaj shqiptarëve, i cili ka qenë i një rëndësi të veçantë, ndriçohet përmes serisë së dokumenteve 'Shqipëria në dokumentet amerikane - 1945" - tha ai. Botimi i serisë së dokumenteve amerikane, sipas Hadrit, hap një tjetër perspektivë të shqyrtimit të marrëdhënieve të Shteteve të Bashkuara, aleatëve me Shqipërinë në suaza të historiografisë botërore.

Kolana do të vazhdojë me vëllime të tjera.

Nekrologji

Ndahet nga jeta dijetari austriak Heiner Eichner, indoeuropeist dhe albanolog



Me hidhërim të thellë Akademia e Shkencave e Shqipërisë mësoi se gjuhëtari Heiner Eichner, indoeuropeist e albanolog, u nda nga jeta në moshën 84-vjeçare; një humbje e madhe për familjen e tij, për kolegët tanë në Akademinë e Shkencave të Austrisë ku kaloi një pjesë të jetës së tij shkencore, për bashkësinë e dijetarëve indoeuropeistë-albanologë. ASHSH u shpreh ngushëllimet e saj.

Profesor Heiner Eichner është një emër i mirënjohur në fushë të gjuhësisë së përgjithshme dhe të asaj indoeuropiane. Ai e ushtroi veprimtarinë e tij studimore pranë Institutit të Gjuhësisë të Universitetit të Vjenës. Ai ishte anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave të Austrisë.

Interesat studimore të Heiner Eichner shtriheshin në çështje të njohjes së nënsistemeve themelore të gjuhëve i.e., në aspekte të njohjes më të thelluar të hetitishës dhe idiomave të tjera me përkatësi i.e. të vendit të shqipes në rrethin e familjes gjuhësore i.e.


H. Eichner ka qenë mentor në procesin e formimit të disa studiuesve të rinj, të interesuar dhe për studimet gjermanistike e ato albanologjike. Është autor i mjaft studimeve tematike mbi afritë dhe përkimet mes gjuhëve i.e., por dhe mbi aspekte më specifike të studimit të tyre. Ka qenë drejtues njësisish të rëndësishme kërkimore pranë Akademisë së Shkencave të Austrisë, përfshirë Institutin e Iranistikës.

H. Eichner është marrë dhe me përgatitjen për botim të disertacionit të Eqrem Çabejt mbi arbëreshët (së bashku me O. E. Pfeiffer dhe J. Matzinger). Ka bashkëpunuar gjithashtu në përgatitjen e veprës së Norbert Joklit “Gjurmime linguistike-historike në fushë të shqipes”, në serinë e botimeve të veçanta (Prishtinë, 2018), botuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës.

Ndër kontributet e viteve të fundit përmendim dhe një studim të thelluar e mjaft të vyer në të cilin evidenton arritjet e studimeve albanologjike në kuadër të gjuhësisë indoeuropiane në rrethe gjermanishtfolëse (botuar në gjuhën shqipe në vëllimin me titull “Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht”, ASHAK, Prishtinë, 2018), në të cilin evidentohen një sërë arritjesh në fushë të gjurmimeve historike e krahasuese mbi gjuhën shqipe dhe marrëdhëniet e saj me gjuhët ballkanike, por dhe të gjurmimit të teksteve më të vjetra të dëshmimit shkrimor të saj.

Ndahet nga jeta Jorgo Papingji

Komisioni i Përhershëm i Artit pranë Akademisë së Shkencave me rastin e ndarjes nga jeta të poetit Jorgo Papingji i shpreh ngushëllimet më të thella familjes dhe komunitetit artistik në vend



Humbja e Jorgo Papingjit, poetit dhe autorit të dhjetra këngëve të muzikës së lehtë dhe për fëmijë të sjell natyrshëm një ndjenjë trishtimi. Kjo pasi, Jorgo në vazhden e poetëve më të mirë shqiptarë i thuri vargje dashurisë, jetës, himnizoi të bukurën duke krijuar një botë që nuk plaket e vdes e që do të jetojë edhe pas largimit të tij fizik nga jeta”.

Papingji u angazhua që kënga shqiptare të shoqëronte njeriun shqiptar gjatë gjithë jetës.

Mik e bashkëpunëtor i kompozitorëve më të njohur shqiptarë në fushën e këngës, ai do të kujtohet si poeti që krijoi modelin e autorit të teksteve me vlerë dhe si krijuesi që ndikoi më së shumti në origjinalitetin e tematikave të këngës shqiptare pas viteve 1990.

Ai ishte i preokupuar për cilësinë e muzikës sonë të lehtë dhe u angazhua që kënga shqiptare të shoqëronte njeriun shqiptar gjatë gjithë jetës.

U nda nga jeta në Ditën Botërore të Poezisë, si për ta lidhur emrin e tij përjetësisht me të!

I paharruar miku dhe artisti ynë Jorgo Papingji”.

In memoriam

Kujtojmë Artan Boriçi, në trevjetorin e ndarjes nga jeta

Sot, në trevjetorin e ndarjes nga jeta të anëtarit të Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Artan Boriçi, në nderim të kujtimit dhe të veprës shkencore që ai la, botojmë këtë artikull të tij - nga më të fundmit - duke falënderuar familjen për dhënien e pëlqimit për botim

- Universi është hologramë, gravitacioni informacion dhe energjia e errët forcë entropike
Akad. Artan Boriçi, CERN, Zvicër



- Teza "Verlinde"* është një nga risitë shkencore dhe zhvillim shumë i rëndësishëm në fizikën teorike bashkëkohëse dhe të ardhmërisë së saj. Pas përpjekjeve të shumta që shkencëtarët bënë gjatë shekullit XX për të bashkuar gravitetin me mekanikën kuantike, në vitin e fundit të dhjetëvjeçarit të parë të shekullit XXI vjen teza e teoricienit Erik Verlinde, sipas së cilës graviteti nuk është forcë themelore, por rrjedhojë e kontabilizimit të informacionit në ekrane holografike.

Ky përfundim, i parashtruar në një artikull me formula të thjeshta, që të kujtojnë artikujt e Ajnshtajnit të vitit 1905 mbi teorinë e relativitetit, si për nga thjeshtësia, ashtu edhe për idetë përmbysëse, është objekt bërë diskutimi i qarqeve shkencore në Europë, përtej oqeanit dhe më gjerë**.

Dr. Erik Verlinde e paraqiti tezën e tij edhe në konferencën e kordave "Geneziss" e organizuar në Shkollën Federale Politeknike të Lozanës (Zvicër), më 26 nëntor 2010. Konferenca u la hapësirë të pakufizuar pyetjeve dhe komenteve të të pranishmëve, të cilët debatuan gjatë me dr. Verlinden.

I. Parimi holografik nuk është i ri (t Hooft 1993) dhe as entropia e vrimave të zeza (Hoking 1971). Por ajo që Verlinde vëren është se, duke përdorur parimin holografik (shih shtojcën A: Vrimat e zeza dhe parimi holografik), mund të derivohet forca gravitacionale. Verlinde pohon se risia e teorisë së tij është origjina entropike e gravitetit. Në këtë mënyrë ai shpjegon origjinën e parimit të njëvlefshmërisë së gravitetit me inercinë: dukuri të njëjta, që rrjedhin prej së njëjtës forcë entropike, duke këmbëngulur: “për mua graviteti nuk ekziston si forcë themelore”***. Për më tepër, edhe forcat e tjera nuk janë themelore, por të derivueshme prej kryqëzimit të gjendjeve kuantike të makrobotës.

Në rast se kjo teori është e verifikueshme, atëherë, së pari, duhen vrojtuar efektet entropike të daljes prej barazpeshës termike në pjesë të ndryshme të Universit dhe së dyti, teoria duhet të ketë fuqi parashikuese. Në fakt, autorë të tjerë, përpara disa kohësh, parimin holografik e kanë përdorur për të shpjeguar origjinën e energjisë së errët.

Me llogaritje elementare mund të nxirret se konstanta kozmologjike ka vlerën e parashikuar prej vlerësimeve të mbështetura në sfondin kozmik të mikrovalëve. Në këtë mënyrë zgjidhet dilema e energjisë së errët: Universi zgjerohet në mënyrë osmotike duke shtyrë horizontin e vet, përtej të cilit hapësira nuk është formuar ende. Energjia e errët rezulton të jetë një “super vrimë e zezë”, e cila “tërheq” dhe zgjeron Universin për një arsye të thjeshtë: zmadhimin e entropisë së vet.



Edhe sikur teoria e Verlindes të jetë e vërtetë, ajo mbetet, ashtu si edhe është, një teori makroskopike. Me gjithë dekurajimin e madh që u bëhet teorive mikroskopike të gravitetit, do të jetë shumë e vështirë të ndalohen përpjekjet për t'u thelluar në teorinë e kordave, që gravitetin e

përmban si forcë themelore të unifikuar me forcat e tjera (shih shtojcën B: Teoria e kordave dhe unifikimi i forcave).

Një ndër eksperimentet më të mëdha të të gjitha kohërave, "goditësi i madh i hadroneve ("Large Hadron Collider"), pritet të ngacmojë shkallë energjetike të panjohura më parë. Një gjë është shumë e qartë: nëse LHC arrin të prodhojë vrima të zeza, atëherë do të jetë shumë e vështirë të hedhësh poshtë teorinë e kordave. Në të kundërt, graviteti do të vazhdojë të mbetet jashtë teorive mikroskopike dhe origjina e masës së leptoneve (elektronet, myonet, tauonet) do të mbetet një mister i përjetshëm.

II. Shtojca A : Teoria e kordave dhe unifikimi i forcave

Ngritja e parimit holografik në pedestalin e parimeve themelore nuk do të ishte e mundur pa rolin e jashtëzakonshëm që ka luajtur teoria e kordave. Kjo teori bashkon të gjitha forcat, ato gravitacionale, elektromagnetike, bërthamore dhe ato të rrezatimeve radioaktive. Por e le enigmatike origjinën e kordave si shkallë lirie. Ajo e sheh gravitonin si një kordë të mbyllur, që lëviz edhe përtej hapësirës së dukshme me tri përmasa; ndërsa grimcat e tjera elementare janë produktet e lëkundjes së kordave të hapura.

Një nga rezultatet më spektakolare të teorisë së kordave janë ekranet holografike mbi të cilat mbështeten kordat e hapura. Sidoqoftë, kjo teori, e quajtur edhe si teoria e shekullit XXI, që ka qenë në gjendje të shpjegojë më së miri edhe vrimat e zeza, mund të bëhet e panevojshme në prani të forcës entropike.

Deri me sot vetëm teoria kuantike e fushës ka mundur të bashkojë të gjitha forcat përveç gravitetit. Ajo është një godinë tepër e ndërlikuar, brenda së cilës bashkëtojnë teoria speciale e relativitetit dhe teoria kuantike. Ajnshtajni ka refuzuar gjithnjë teorinë kuantike dhe besonte në gjeometrizimin e fizikës. Si për ironi të fatit, teoria e gravitetit e Ajnshajnit ka qenë e pamundur të kuantizohet, për shkak të jolinearitetit thelbësor të saj.

III. Shtojca B: Vrimat e zeza dhe parimi holografik

Fakti se vrima e zezë përpin rrezatimet dhe trupat që i afrohen asaj çon në uljen e entropisë së Universit dhe si rrjedhim bie në kundërshtim me parimin e dytë të termodinamikës. Bekenshtajn arriti të shpjegojë më 1973 këtë paradoks, duke përfunduar se informacioni për gjendjen vëllimore të vrimës së zezë ruhet në sipërfaqen e saj. Në këtë rast sipërfaqja e vrimës së zezë shërben si hologramë për të ruajtur informacionin.

Kur një trup gjendet shumë pranë vrimës së zezë në distanca një gjatësi vale të Komptonit, $\lambda = \hbar/mc$, (ku $\hbar = h/2\pi$ është konstanta e reduktuar e Plankut, m masa që i shtohet vrimës së zezë dhe c shpejtësia e dritës), atëherë ai mund të quhet pjesë e vrimës së zezë. Ky supozim zgjidh paradoksin, ngaqë në këtë rast kemi rritje të entropisë së vrimës së zezë sipas formulës: $\Delta S = k \Delta x/\lambda$, ku k është konstanta e Bolcmanit.

Prej termodinamikës dihet se forca entropike, si p.sh. ajo e osmozës etj., jepet me anë të barzimit: $F = T\Delta S/\Delta x$. Mirëpo sipas Njutonit forca e rëndesës është $F = GmM/R^2$, ku G konstanta gravitacionale e Njutonit, M masa e vrimës së zezë, R rrezja e vrimës së zezë. Duke shfrytëzuar barazimet e mësipërme (detyrë për të gjithë lexuesit që kanë mbaruar shkollën 9-veçare!) del se $GM/R^2 = kT c/\hbar$. Nga termodinamika dimë se energjia e vrimës së zezë për shkallë lirie është: $E/N = kT/2$, ku N është numri i shkallëve të lirisë ose njësisive të informacionit që nevojiten për të

përshkruar vrimën e zezë. Nga relativiteti dihet se $E=Mc^2$. Duke zëvendësuar marrim përfundimisht: $4\pi R^2/N = Gh/c^3$.

Meqë ana e djathtë përbëhet prej madhësish konstante, del se numri i njësisve të informacionit për të përshkruar vrimën e zezë është në përpjestim të drejtë me sipërfaqen e vrimës së zezë. Kjo do të thotë se informacioni për gjendjen vëllimore të vrimës së zezë ruhet në sipërfaqen e saj. Në këtë rast sipërfaqja e vrimës së zezë shërben si hologramë për të ruajtur informacionin. Ky është përfundimi i njohur i Bekenshtajnit.

* Dr. Erik Petër Verlinde është një nga shkencëtarët, teoricien që i është përkushtuar teorisë së kordave. Ka lindur më 21 janar 1962 në Woudenberg. Prej shumë vitesh punon në Institutin e Fizikës Teorike të Universitetit Amsterdam të Hollandës.

** Verlinde për here të parë e parashtrroi tezën tij më 8 dhjetor 2009 në një konferencë shkencore, organizuar nga Instituti holandez Spinoza; më 6 janar 2010 detë e kësaj teze i pasqyroi në media nën titullin "Në origjina të gravitetit dhe ligjet e Njutonit" dhe më pas në një intervistë, dhënë gazetës "De Volskrant". Gjatë ditëve të qëndrimit në Nju Jork, kur i ishte përkushtuar takimeve të organizuara me fizikanë e teoricienë të kësaj fushe, gazeta "New York Times" e 12 korrikut 2010 në rubriken "Lajme shkencore" tërhoqte vëmendjen e qarqeve shkencore me një shkrim me idenë: Dr. Enrik Verlinde thotë: "Për mua graviteti nuk ekziston", çka u parapriu 261 komenteve.

*** Gazeta "New York Times", 12 korrik 2010.